

NEWS SOT

E Enjte 11 Maj 2017

Petrit Vasili kundër Edi Ramës: Kërcënimet ndaj opozitës, nuk ndihmojnë dialogun, politika nuk është lojë shahu

Faqe 8



6 kongresmenë amerikanë vizitë blic në Tiranë, ja prapaskenat e misionit, nga monitorimi i Donald Lu te zbatimi i reformës në drejtësi

Faqe 2-3



Merkel dërgon në Tiranë të besuarin e saj, Lammel ultimatum Bashës të ndalë bojkotin, tenton të bindë aleatët e PD të futen në zgjedhje

Shtetet e Ballkanit në krizë politike, Fatos Klosi: Po përdoret skenar i qëllimshëm, ja çfarë pritet të ndodhë

Situata në rajonin e Ballkanit është në një krizë totale, që rrezikon të tensionohet akoma edhe më shumë. Ballkani është futur në një hulli të pakthyeshme, nga e cila mund të përfitojnë shtete si

Rusia, e cila prej kohësh kërkon të ushtrojë ndikimin e saj mbi këtë rajon. Demokracitë e brishta, ende të pakonsoliduara të vendeve të Ballkanit, që pasohen me kriza të ndryshme poli-

tike, rrezikojnë që të bëhen terren i butë për vendet armike. Shqipëria ndodhet në një krizë politike, pasi opozita nuk pranon të hyjë në zgjedhje edhe pas presionit ndërkombëtar... **Faqe 10**

Zbulohen detajet e protestës së 13 majit, Basha heq çadrën para Kryeministrit, synohet që tubimi të zgjasë më shumë se një ditë

Zbardhen detajet e protestës së 13 majit, thirrur nga Partia Demokratike dhe aleatët e saj. Kryeopozitari Lulzim Basha e ka deklaruar se nuk do ketë zgjedhje të përgjithshme të dielën e 18 qershorit dhe opsioni i vetëm që i ka mbetur atij, me anë... **Faqe 6**

Opozita dërgon në Kolegj Zgjedhor listën e kandidatëve, Kume: Ja si bllokohen zgjedhjet nëse pranohet kërkesa

Opozita e bashkuar së bashku me Partinë Demokratike i janë drejtuar Kolegjit Zgjedhor me një kërkesë për shfuqizimin e vendimit të KQZ për regjistrimin e listave shumë emërore të kandidatëve për deputetë. Duke iu referuar Kodit zgjedhor, pikërisht nenit 67 të tij, partitë e opozitës... **Faqe 5**

Nis rivaliteti PS-LSI në bazë, Rama urdhër deputetëve të sigurojnë sa më shumë vota nga PD, zbardhen detajet e fushatës elektorale

Zbardhen detajet e fushatës së Partisë Socialiste dhe udhëzimet që duhet të ndjekin kandidatët për deputetë për 18 qershorin. Ashtu si në zgjedhjet parlamentare të 2013, edhe në këtë fushatë elektorale do të ketë tur takimesh me autobus. Në aktivitet dhe takimet elektorale që do të... **Faqe 7**

Kreu i PD sulmon ndërkombëtarët: Janë të korruptuar, u blenë nga Edi Rama

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka sulmuar ditën e djeshme shumë ashpër ndërkombëtarët. Pas kundërshtimeve të ditëve të fundit nga një sërë eksponentësh të lartë ndërkombëtarë, Basha ka shpërthyer dje me një lumë akuzash të forta, duke akuzuar trupin diplomatik si të blerë prej qeverisë. Në vijim të retorikës... **Faqe 4**

KOMENT & ANALIZE

F.16-17

Nga Pandeli BARDHI

Budallait dhe të çmendurit i hapet rrugë!

...Kjo është rruga më e mundshme për këta personazhe të cilëve u ka rënë në pjesë kjo fatkeqësi pa



Nga Besi BEKTESI



"Fashistoidët" e qendrës së Tiranës në delir!

E gjithë politika në skaner për pasurinë, verifikim deri te krushqitë, ILDKP ndryshon procedurat e deklarimit

Shtohet ankthi në radhët e politikanëve dhe zyrtarëve të lartë. Në zbatim të ndryshimeve në ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, ILDKP ka ndryshuar formularët që duhet të plotësohen nga zyrtarët. Sipas një vendimi të publikuar në Fletoren Zyrtare, çdo zyrtar... **Faqe 9**

Miratohen rregullat për përfitimin e statusit të naftëtarit, ja si do të aplikojnë 5 mijë naftëtarët përfitues

Këshilli i Ministrave miratoi dje procedurat që duhet të ndiqen nga afro 5 mijë naftëtarë që do të pajisen me statusin e naftëtarit. Me datë 2 shkurt 2017, Kuvendi miratoi ligjin "Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit", i cili ka hyrë në fuqi më datë 9 mars 2017... **Faqe 12**

SIGMA INTERALBANIAN
VIENNA INSURANCE GROUP

politike

Instituti amerikan: Partitë që s'hyjnë në zgjedhje shkojnë drejt shkatërrimit

Analiza ndërkombëtare e publikuar nga Instituti prestigjioz i "Brookings" në SHBA, tregon se në 96% të rasteve, partitë që kanë zgjedhur të bojkotojnë zgjedhjet në vendin e tyre, janë shpërbërë ose kanë humbur peshën e tyre politike pas zgjedhjeve. Në të gjithë rastet kur zgjedhjet janë mbajtur, SHBA ka njohur rezultatin, edhe kur në disa raste pjesëmarrja në zgjedhje ka qenë prej vetëm 10%. Analiza me titullin "Threaten but Participate, Ehy Election Boycotts are a Bad Idea" (Kërcëno por merr pjesë, Përse bojkoti i zgjedhjeve është një vendim i

gabuar), ka analizuar me detaje 171 bojkotet e ndodhura në të gjithë vendet e botës, në periudhën 1990-2009. Por përfundimet e saj duket se vlejné dhe për PD, e cila bojkotoi zgjedhjet. "Një studim i hollësishëm i 171 bojkoteve të ndodhura në periudhën 1990-2009, tregon qartësisht se me përjashtim të vetëm disa rasteve, bojkoti i zgjedhjeve ka pasur pasoja katastrofike mbi partinë bojkotuese. Në vetëm pak raste pala bojkotuese ka arritur të marrë mbështetje ndërkombëtare dhe pothuajse gjithmonë, bojkoti ka fuqizuar palën tjetër", thuhet në këtë studim. Rastet

që bëjnë përjashtim, në të cilat opinioni ndërkombëtar ka mbështetur palën bojkotuese, janë regjistruar në vende si Bangladeshi, Tajlanda apo Peruja, ku regjime autoritare realisht e kishin bërë pothuajse të pamundur konkurrimin e opozitës në zgjedhje. "Rreth 10% e zgjedhjeve në të gjithë botën janë bojkotuar nga parti të opozitës, por institucionet ndërkombëtare dhe SHBA-të kanë njohur, e madje edhe kanë përgëzuar zgjedhje në të cilat pjesëmarrja popullore ka qenë vetëm 10%", thuhet në raportin e "Brookings". Në fund të këtij raporti, sqarohet

se në 4% të rasteve kur bojkoti si mënyrë ka pasur sukses, ai ka ndodhur në vende ku opozita kishte një mbështetje të gjerë popullore dhe garanci pothuajse të plotë për fitoren në zgjedhje, por bojkoti u zgjodh si metodë elektorale, për të masivizuar lëvizjet opozitare e për të vendosur kushte, që do të garantonin një transparencë më të madhe të zgjedhjeve. Në Shqipëri, opinioni ndërkombëtar, përfshi OSBE/ODIHR dhe SHBA kanë bërë të qartë në më shumë se një rast se do të njohin rezultatin e zgjedhjeve, pavarësisht pjesëmarrjes në to të PD-së ose jo.

■ Ndërkombëtarët ultimatume të njëpasnjëshme ndaj Bashës

Merkel dërgon në Tiranë të besuarin e saj, Lammel ultimatium Bashës të ndalë bojkotin, tenton të bindë aleatët e PD të futen në zgjedhje

Andi KOROveshi

Kancelarja gjermane Angela Merkel shton presionet ndaj Partisë Demokratike për t'u futur në zgjedhje. Pas dështimit të McAllister, kancelarja ka dërguar në Tiranë një tjetër deputet të saj, me qëllim zgjidhjen e krizës politike. Prej dy ditësh në Tiranë ndodhet deputeti i CDU, Andreas Lammel, i cili ka zhvilluar takime intensive me partitë opozitare. Ai ka takuar edhe kryepozitarin Lulzim Basha, të cilin sipas burimeve, i ka kërkuar të heqë dorë nga kushti i qeverisë teknike dhe t'i japë fund bojkotit. Njëkohësisht ai i ka propozuar Bashës të hartojë një draft paketë për të arritur dakordësinë me Partinë Socialiste. Zyrtari gjerman ka zhvilluar takime të ndara dhe me aleatët e Lulzim Bashës. Ai ka pasur biseda me përfaqësues të LZHK, PR, PAA, me të cilët ka diskutuar mbi situatën politike. Sipas burimeve, në takimet me aleatët ai fillimisht ka dëgjuar propozimet e tyre, ku krerët e partive kanë ngritur si shqetësim drogën, krimin dhe cenimin e zgjedhjeve. Ndërsa Lammel në fjalën e tij ka deklaruar hapur se bojkoti nuk ndihmon askënd. Ai ka kërkuar që të shihet mundësia e futjes në zgjedhje, ndërsa e ka thënë hapur se nuk mund të kërkohej gjëra të pamundura, siç është qeveria teknike. Vizita e tij u mbajt e fshehtë dhe vetëm dje u bë publike, ndërsa shihet si një tentativë e radhës e Angela Merkel për të nxjerrë Lulzim Bashën nga çadra. Lammel njihet si një prej deputetëve pranë saj dhe misioni i tij në Tiranë dëshmon qartë se marrëdhëniet mes Bashës dhe Berlinit nuk janë të qëndrueshme. I vetmi që foli publikisht mbi këto takime ishte kreu i Partisë Agrare Ambientaliste, Agron Duka. Sipas njoftimit të PAA, zyrtari gjerman ka ndarë të njëjtin shqetësim me opozitën sa i takon drogës dhe krimin, por nuk është pajtuar me bojkotin. "Ju mund të organizoni protesta, nuk është kjo çështja. Është një e drejtë e garantuar me kushtetutë. Mund të protestohet çdo ditë ose dy herë në ditë. Por për Partinë Demokratike nuk është mirë që të bojkotohet ose bllokohet procesi i integritetit. Që të mos prishim rrugën pozitive të Shqipërisë që ka bërë vitet e fundit nga tensionimi i proceseve politike. Por çfarë nuk kam kuptuar këto ditë është çështja ose pyetja për kanabizimin, pse kjo situatë ka dalë jashtë kontrollit? Për fermerët

MAJA KOÇIJANÇIÇ KRITIKA OPOZITËS

"Shqipëria është një nga partneret tona kyçe në Ballkanin Perëndimor, vend kandidat që ka marrë rekomandimin për hapjen e negociatave të kushtëzuar me zbatimin e reformës së gjyqësorit. Pra, jemi në një

moment kritik Ne po flasim për reforma që janë të rëndësishme për rrugën europiane të Shqipërisë. Debatimi duhet të zhvillohet në Parlament", deklaroi zëdhënësjja e KE Maja Koçijançic pak ditë më parë.

KUKAN: PO PËRPIQEMI TË BINDIM BASHËN



Eurodeputeti Eduart Kukan, raportues për Shqipërinë në PPE, në një intervistë dhënë pak ditë më parë tha: "Po përpiqemi t'i mbushim mendjen kryetarit të Partisë Demokratike se vetëm me dialog e tryeza bisedimesh, mund të arrihen zgjidhjet politike. E nuk heqim dorë nga kjo". Propozimet e kryeministrit Rama, ai i quajti "lëshime serioze ndaj opozitës". Sipas tij, çdo bojkot i zgjedhjeve dhe çdo bojkot i parlamentit, nuk është standard evropian.

e kuptoj që është interesante apo atraktive, por çfarë bën shteti dhe si mund të dilet nga situatë", është shprehur Lammel.

Ndërkombëtarët kundër Bashës

Faktori ndërkombëtar vijon të jetë i shqetësuar për situatën politike në Shqipëri, në kushtet kur opozita e ka bërë të qartë tashmë vendimin për të mos marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit, në rast se kryeministri Rama nuk pranon kushtin për t'i hapur rrugën krijimit të një qeverie teknike pa të në krye. Pas dështimit të paketës bashkëpunuese McAllister, nuk kanë munguar deklaratat e eurodeputetëve të BE kundër PD. Eurodeputeti Knut Fleckenstein dhe senatori amerikan John Mcain i kanë dhënë ditën e martë një ultima-

Ju mund të organizoni protesta, nuk është kjo çështja. Është një e drejtë e garantuar me kushtetutë. Mund të protestohet çdo ditë ose dy herë në ditë. Por për Partinë Demokratike nuk është mirë që të bojkotohet ose bllokohet procesi i integritetit. Që të mos prishim rrugën pozitive të Shqipërisë që ka bërë vitet e fundit nga tensionimi i proceseve politike...



tum të prerë opozitës dhe kreut të saj Lulzim Basha për të marrë pjesë në zgjedhjet e 18 qershorit. "Pata një bisedë konstruktive me senatorin John Mcain në Uashington. Qëndrimi ynë sa i takon situatës në Shqipëri është i qartë. Ne i kërkojmë Partisë Demokratike të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme", ka shkruar Fleckenstein në profilin e tij në Tëet-

ter të martën. Pas ndërhyrjes së eurodeputetëve të Bashkimit Evropian, e cila nuk ka qenë rezultate për ta çuar Lulzim Bashën drejt zgjedhjeve dhe daljes nga çadra, duket se kësaj here është angazhuar edhe faktori ndërkombëtar amerikan. Figura të ndryshme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë bërë apel për zgjidhje të situatës politike.

Bojaxhiu akuza administratës për pjesëmarrje në fushatë

Kryetari i Partisë Sfidë për Shqipërinë, Gjergj Bojaxhi, ka akuzuar administratën publike se është përfshirë në fushatën zgjedhore. Sipas Bojaxhiut, fenomeni është shqetësues, ndërsa propozimi i Sfidës është mospolitizimi i administratës. "Zyrtarët e administratës janë kthyer në varreza bosh pasi punonjësit e administratës janë pjesë e sistemeve dhe strukturave partiake, që do të thotë tashmë ka filluar fushata dhe ne si qytetarë për taksat që paguajmë nuk po marrim më shërbime. Është kjo akuza që kreu i "Sfidë për Shqipërinë" ka për të gjithë administratën. Bojaxhi ka prezantuar edhe nismën e tij për të shmangur këtë fenomen. Ky sistem ndërpritet duke ndërprerë pjesëmarrjen dhe punësimin e militantëve në strukturat e administratës dhe burokracinë shqiptare. Pas çdo rrotacioni pushteti nuk kanë qenë të pakta akuzat për punësimin e militantëve në administratën shtetërore", është shprehur Gjergj Bojaxhi.

Qeveria miraton marrëveshjen ndërkufitare me Greqinë

Qeveria ka miratuar dje në parim marrëveshjen e financimit nga ana e Republikës së Francës të programit të Komisionit Evropian, Interreg V-B Mesdhe (MED), 2014-2020. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pa prituri të publikohet në fletoren zyrtare. Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2014-2020 do të mbështesë bashkëpunimin rajonal ndërmjet rajoneve greke dhe shqiptare në periudhën e ardhshme programore. Objektivi i përgjithshëm i programit është të "rrisë standardin e jetesës së popullsisë duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm lokal në zonën ndërkufitare". Programi do të fokusohet në "Promovimi i mjedisit, transportit të qëndrueshëm dhe infrastrukturës publike" me qëllim për të rritur kapacitetin e infrastrukturës ndërkufitare në transport, ujë dhe menaxhimin e mbeturinave; Rritja e efektivitetit të mbrojtjes së mjedisit dhe efikasitetit energjetik; si dhe për të përmirësuar efektivitetin e parandalimit të rrezikut dhe menaxhimin e katastrofave me fokus zjarret në pyje.

Zyrtarët amerikanë mbi 1 orë në selinë e PD, Lulzim Basha raporton mbi situatën politike

Gjatë pasdites së djeshme, gjashtë kongresmenët amerikanë që mbërritën në Tiranë, zhvilluan një takim intensive me kreun e PD, Lulzim Basha. Takimi u zhvillua rreth orës 17.00 dhe zgjati rreth një orë e 20 minuta. Vetë Partia Demokratike nuk dha asnjë informacion mbi atë se çfarë u diskutua, por mësohet se në qendër të bisedës ka qenë bojkoti i zgjedhjeve dhe situata politike. Burimet thanë se më shumë ka qenë Basha ai

i cili ka folur, duke renditur arsytet që e çuan PD në këtë vendim. Sipas tij, vendi është mbërthyer nga krimi dhe droga dhe këto para do të përdoren në zgjedhje për të blerë vota. Por mësohet se kongresmenët nuk kanë dhënë një deklaratë të qartë sa i takon fatit të PD, ndonëse e kanë bërë të qartë se vetingu duhet të zbatohet sa më shpejt. Edhe në takime me zyrtarët e tjerë, ata kanë deklaruar se reforma në drejtësi është shumë e rëndë-

sishme. Vizita e tyre pritet të përdoret nga PD, pasi demokratët kanë tentuar gjithmonë të afrohen me administratën e Trump. Madje Basha e Mediu kanë zhvilluar një sërë takimesh intensive në SHBA, me qëllim që të marrin mbështetjen e tyre. Ndërkohë një shqetësim që kanë ngritur demokratët është dhe Soros. Edhe pse Basha ka pasur takime me të. Kohët e fundit e ka sulmuar ashpër. Por ajo që vihet re është se PD i ka përkeqësuar

marrëdhëniet me ndërkombëtarët. Asnjë zyrtar i huaj nuk e ka mbështetur bojkotin e zgjedhjeve. Madje dhe personalitetet më të larta të BE e SHBA kanë thënë hapur se nuk mund të ketë bojkot të zgjedhjeve. Madje ambasada e SHBA, por dhe Gjermania e kanë thënë hapur se do i njohin zgjedhjet edhe nëse PD i bojkoton ato. Mbetet të shihet se sa e frytshme do jetë vizita e 6 kongresmenëve, pasi PD vijon të jetë e bindur për të mos u futur në zgjedhje.

Kongresmenët tur takimesh në Ballkan

6 kongresmenë amerikanë vizitë blic në Tiranë, ja prapaskenat e misionit, nga monitorimi i Donald Lu te zbatimi i reformës në drejtësi

Kliti TOPALLI

Vendimi për të mos u futur në zgjedhjet e 18 qershorit, duket se do të sjellë pasoja shumë të mëdha për liderin demokrat, Lulzim Basha. Dje ka skaduar afati i vënë nga kryeministri Edi Rama dhe zyrtarisht PD është jashtë zgjedhjeve. Por të dielën u dhanë sinjalet e para se garda e vjetër nuk e mbështet vendimin e Bashës, pasi pati përplasje të forta mes tij dhe Majlinda Bregut. Por deputetja demokrate për herë të parë ka paralajmëruar dhe fundin e Lulzim Bashës. Në mbledhje grupi, por dhe para mediave, ajo tha se pas 18 qershorit duhet të nisë rindërtimi i PD. Kjo mund të merret si një sinjal i qartë ndaj Bashës dhe do kërkohej largimi i tij. Por ajo që e vë më shumë në vështirësi Bashën është se më 23 korrik atij i skadon afati si kryetar i Partisë Demokratike. Mandatin e kryetarit, ai e mori më 23 korrik të vitit 2013 dhe sipas përcaktimeve në statut, PD duhet të futet në zgjedhje për kryetarin dhe të gjitha strukturat e tjera drejtuese. Sipas burimeve, pritet që pas korrikut të thirret Kuvendi Kombëtar i PD, ku të bëhen zgjedhje për një sërë strukturash, pasi shumë anëtarëve u skadon mandati. Së pari, janë deputetët. Neni 34 i statutit tregon se ata janë anëtarë automatikisht të Kuvendit Kombëtar, por e humbin të drejtën kur u mbaron mandati i deputetit. Kjo do të thotë se pas 18 qershorit, ata nuk mund të jenë dot anëtarë në strukturat drejtuese, pasi e njëjta gjë vlen dhe për Këshillin Kombëtar. Po ashtu e humbin mandatin dhe një sërë krerësh degësh, pasi aty thuhet se mandati është 4 vjeçar. Por ajo që është më e rëndësishmja, është se Kuvendi Kombëtar ka kompetencë për të shkarkuar dhe kryetarin dhe mbledhja e tij mund ta vinte në vështirësi të shumta Bashën. Pra, duket se muaji korrik do të jetë vendimtar për liderin demokrat, i cili duhet që të bindë deputetët dhe anëtarët e Kuvendit që ta votojnë për një tjetër mandat. Por mosfutja e PD në zgjedhje pritet të sjellë përplasje të shumta dhe Basha me shumë gjasë mund të zëvendësohet. Duket se kjo është mundësi e artë për kritikët e tij, të cilët do të kërkojnë që ai të largohet, pasi bojkoti i zgjedhjeve është vendim shumë i ashpër. Pra skadimi i mandatit të Bashës, do jetë skenari për të kërkuar largimin e tij.

Kandidatët potencialë

Lulzim Basha ka arritur të mbledhë pas vetes një sërë deputetë, por nuk ia ka arritur të fitojë simpatinë e të vjetërve, shumica e të cilëve ishin në qeverinë dhe administratën e Sali Berishës. Por si për koicidencë, mandati i Bashës mbaron në të njëjtën ditë kur Bujar

BUSHATI PRET KONGRESMENËT

Ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati, priti dje në takim delegacionin e Kongresit Amerikan të kryesuar nga Kryetari i Komitetit mbi Çështjet e Drejtësisë, Bob Goodlatte. "Ministri iu përgjigj interesit të anëtarëve të Kongresit amerikan dhe informoi gjerësisht mbi ecurinë e procesit të reformave në vend duke u ndalur në mënyrë të veçantë në rëndësinë e reformës në drejtësi si një nga aspektet më thelbësore për forcimin e shtetit ligjor në vend dhe avancimin në plotësimin

e përparësive në kuadër të integritimit European. Ai shpjegoi ritmin e ecurisë së zbatimit të reformës e cila, theksoi ai, është ngadalësuar aktualisht për shkak të bojkotit të Kuvendit nga opozita. Bushati bëri gjithashtu një panoramë të situatës dhe zhvillimeve në rajon, evidentoi rolin dhe kontributin e Shqipërisë në luftën kundër terrorizmit, masat e marra nga qeveria në bashkëpunim me vende dhe organizata partnere në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar", njoftoi ministria.



JA ÇFARË SHKRUAJNË MEDIAT AMERIKANE

Portali "The American Spectator" ka dhënë detaje nga misioni i kongresmenëve. "Kryetari i gjyqësorit, republikani republikani Bob Goodlatte (R-VA), po drejton një delegacion prej 15 anëtarësh në një mision urgjent në Greqi, Bosnjë, Shqipëri, Maqedoni, Kosovë dhe Itali, për të parë nëse pushteti i Obamës vijon

të dëmtojë qytetarët, institucionet dhe stabilitetin rajonal. Delegacioni nisi misionin e tij të shtunën dhe do ketë një mision dhjetëditor, me rastin e pushimeve në Kongres", ka deklaruar ai. Sipas portalit, prej komisioneve janë republikanë, ndërsa synimi i tyre është të kontrollojnë punën e njerëzve të emëruar nga Barack Obama.

Nishani do të dorëzojë mandatin e tij si president. Kjo do të thotë se kur të bëhen zgjedhjet në PD, ai do të jetë i lirë. Është përfolur shumë se ai mund të jetë rivali i Lulzim Bashës. Sa ishte President, Nishani ishte shumë aktiv duke kritikuar ashpër qeverinë. Madje pati periudha që i lëshoi kritik më shumë se vetë Basha. Kjo ka bërë

të përflitet si një emër që mund të rikthehet në PD dhe mund të rivalizojë Bashën. Por nga ana tjetër edhe Jozefina Topalli cilësohet si një ndër kundërshtarët e betuara të Bashës, dhe nuk përjashtohet si kandidatë. Ndërkohë, të dielën, Majlinda Bregu dha një sinjal se pas 18 qershorit do jetë ajo që do kërkojë me patjetër rindërtimin e PD.

Ja kush janë kongresmenët që vizituan Tiranën

1-BOB GOODLATTE

Përfaqëson Distriktin e gjashtë të Virxhinias në Dhomën e Përfaqësuesve. Në Kongresin e 113 ai u zgjodh kryetar i Komitetit të Ligjeve. Ai ka qenë anëtar aktiv i Komisionit të Drejtësisë duke shërbyer në funksione të ndryshme, kryetar në komisionin e pronësisë intelektuale, në komisionin e konkurrencës anëtar i task forcës në sistemin gjyqësor. Goodlatte është po ashtu pjesëtar edhe në funksione të tjera përfshirë anëtar i lartë i Komitetit të Bujqësisë.

2-STEVE KING

King ka shërbyer për 6 vite në Senatin e Iowa. Ai ka qenë anëtar në Komisionin e drejtësisë komisionin e biznesit, komisionin e tregtisë. Ai punoi në senatin e Iowa duke arritur të eliminonte taksën e trashëgimisë, të zbatojë testin e drogës në vendin e punës, të përforcojë të drejtat prindërore si dhe të kalonte ligjin i cili zyrtarizonte anglishten si gjuhën zyrtare në Iowa.

3-KONGRESMENI DAVE TROTT

Përfaqëson distriktin e 11 të Miçigan në Kongres. Ai vlerësohet si një person lider i inovacionit i aftë të zgjidh shumë probleme, dhe të krijojë vende pune. Trot ka luajtur një rol të rëndësishëm për të ndihmuar shtetin e tij. Në kongres ai ka luftuar për të krijuar më shumë mundësi punësimi për shtetin që përfaqëson. Dave Trot është pjesë e komisionit të punëve të jashtme anëtar i komisionit të Drejtësisë.

4-MATT GAETZ

Është anëtar i kongresit dhe shërben në komisionin e Buxhetit, forcave të armatosur dhe pjesë e komisionit të drejtësisë. Detyra e tij në kongres fokusohet në sigurinë kombëtare, reformën e taksave dhe respektimit të principeve kushtetuese. Ai ka shërbyer si kryetar i nënkomisjonit të Drejtësisë kriminale ku ai autorizoi dhe kaloi ligje të forta kundër dhunës seksuale ndërsa lehtësoi që pacientët në Florida të marrin si medikament kanabisin.

5-DEFAZIO

U zgjodh për herë të parë në Kongres në 1986 dhe është një nga përfaqësuesit më jetëgjatë të Oregon në Dhomën e Përfaqësuesve. Ai njihet si një person i pasionuar pas ligjit. Në 1987. Ai ka shërbyer si anëtar i komisionit të transportit dhe infrastrukturës ku u shqua për luftën e tij për të krijuar vende pune dhe për të ofruar siguri, dhe efikasë ekonomike.

6-DAVID N. CICILLINE

Përfaqëson Ishullin Rode në dhomën e përfaqësuesve. Si pjesëtar i komisionit të drejtësisë ai ka punuar për të mbrojtur pronën intelektuale dhe inovacionin, si dhe ka ndihmuar biznesin dhe ka mbështetur krijimin e vendeve të reja të punës.

politike

Ambasadori italian: Zbatoni reformat, po ju monitorojmë

Ambasadori italian, Alberto Cutillo, ditën e djeshme gjatë një konference, deklaroi se zbatimi i standardeve evropiane në zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit dhe zbatimi faktik i reformës në drejtësi, do të jenë pika kyçe sa i takon hapjes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Nga ana tjetër, gjatë fjalës së tij, Cutillo bëri me dije se për shkak të krizës politike Shqipëria është nën vëzhgim, ndërsa shtoi se Italia ashtu dhe vendet e tjera të BE-së janë duke vëzhguar edhe sjelljen e

politikanëve shqiptarë. "Shqipëria është një vend kandidat për në Bashkimin Evropian, por që nuk janë hapur ende negociatat, ftesë që mund të nisët në fund të këtij viti nëse zgjedhjet do të zhvillohen në mënyrë të rregullt si dhe nëse mbi të gjitha reforma në drejtësi, do të nisët realisht të përkthehet në fakte. Ne e shpresonin që në këtë verë, por për shkak të klimës politike nuk ishte e mundur të përktheheshin në aktet e para ligjore. Por ne shpresojmë që reformat të realizohet pas zgjedhjeve. Jemi në një moment të rëndë-

sishëm. Në datën 18 qershor janë parashikuar zgjedhjet parlamentare. Shqipëria është një vend në monitorim, jo vetëm prej Italisë por dhe prej Bashkimit Evropian, sepse është një vend kandidat për të qenë pjesë e BE. Ndaj dhe vëmendja është në atë çfarë po ndodh, për të parë dhe maturitetin e politikës, që do të vlerësohet në procesin e anëtarësimit", nënvizoi ai. Ndërkohë, ai theksoi se rezultatet e reformës në drejtësi dhe lufta ndaj korrupsionit, janë tejet të rëndësishme për zhvillimin e vendit. Sipas tij, qytetarët kanë nevojë për

një drejtësi autentike. "Shqipëria po zhvillon reformat e rëndësishme që janë me rëndësi kombëtare në radhë të parë, por dhe që i kërkon Bashkimi Evropian, për të bërë progres në disa çështje që janë të rëndësishme por më të rëndësishme janë reforma në drejtësi lufta ndaj korrupsionit dhe kriminalitetit. Shqipëria në korrik ka miratuar ndryshimet në Kushtetutë, që në themel ka reformën në Drejtësi. Besoj se për bizneset dhe qytetarët drejtësia është shumë e rëndësishme për besueshmërinë e një vendi", shtoi ai.

■ Lulzim Basha: Më 13 Maj, protestë për Republikën e Re

Kreu i PD sulmon ndërkombëtarët: Janë të korruptuar, u blenë nga Rama

Rigels SELIMAN

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka sulmuar ditën e djeshme shumë ashpër ndërkombëtarët. Pas kundërshtimeve të ditëve të fundit nga një sërë eksponentësh të lartë ndërkombëtarë, Basha ka shpërthyer dje me një lumë akuzash të forta, duke akuzuar trupin diplomatik si të blerë prej qeverisë. Në vijim të retorikës së tij, shefi i opozitës nga "çadra e lirisë", intimidoi diplomatët e huaj në Tiranë që përfaqësojnë BE, duke i akuzuar këta të fundit se për interesa të tyre, kanë fshehur për katër vite drogën dhe krimin në Shqipëri. Sipas Bashës, diplomatët nuk e kanë bërë për interesa të BE, por për interesa të tyre, si njerëz të korruptuar. "Zyrtarët e huaj të korruptuar në Tiranë nuk kanë raportuar drogën dhe kriminelët. Droga, krimi, korrupsioni, realiteti i përditshëm i shqiptarëve ishte fshirë nga mediat e kapura nga qeveria, ishte fshirë nga raportet e zyrtarëve të korruptuar ndërkombëtarë në Tiranë, të cilët nuk raportonin drogën, nuk raportonin kriminelët. Ata sot janë bashkëfajtorë me Ramën, nuk dalin dot nga rrethi vicioz ku e kanë futur veten e tyre sepse kanë mohuar krimin dhe janë bërë njësh me Edi Ramën për xhepat e tyre. Janë bërë njësh me Ramën jo për interesin e Bashkimit Evropian, aleatëve strategjikë, por për xhepat e tyre të korruptuar", deklaroi ai. Nga ana tjetër, lideri demokrat, teksa ishte duke bërë llogaritë në lidhje me afatin 50-ditor përpara datës së zgjedhjeve, nuk kurseu as kritikën plot ironi për ndërkombëtarët, duke i etiketuar këta të fundit si "serumet" që mbajnë gjallë qeverinë "Rama". Sipas tij, të gjithë dinë të numërojnë nga njëshi deri tek 50, përveçse ndërkombëtarëve dhe falangave sorosiane. "Të gjithë dini të numëroni deri në 50. Edi Rama dhe serumet që e mbajnë në këmbë 'Made in Albania' apo kudo që bëhen, apo 'Made in Soros'. Ata nuk e thonë një fjalë për skadimin e datës ligjore zyrtare për zgjedhjet. Nuk e thonë, duan ta anashkalojnë dhe shpresojnë që me presione ndaj Kolegjit Zgjedhor do t'i thonë shqiptarëve, që një edhe një nuk bëjnë dy, por bëjnë një. Se 17+31+2 nuk bëjnë 50, por bëjnë 51", nënvizoi ai. Akuzat e Bashës u lëshuan në një ditë ku Tirana është

BASHA: RAMA PO PËRDOR KRIMINELËT PËR KAPJEN E ZGJEDHJEVE

Dje, lideri demokrat, Lulzim Basha akuzoi kryeministrin Edi Rama si të lidhur me krimin e organizuar. Sipas tij, Rama po përdor kriminelët për kapjen e zgjedhjeve. "Demokraci do të thotë vendimarrje e kontroll nga pakica e zgjedhur legjitime. Por kupola e Republikës së Vjetër ka tjetër projekt. U sollën kriminelët në institucione. Një nga një institucionet u

kapën nga kriminelët, që Rama nuk i gjeti, por i solli në PS si vegla për kapjen e shtetit, jo për të mirën e qytetarëve, por vetëm për pushtetin e vetes dhe çetës së tij bandite. Ja pse Rama e ka jetike kapjen e zgjedhjeve të ardhshme. Kjo është vepra e Rilindjes së kimit. Ne nuk pranojmë të jemi fasadë, një parlament monist, rikthim 27 vite më parë", deklaroi Basha.

Rama: Çadra e PD, bunker i fundit i frikës nga drejtësia



Kryeministri Edi Rama, dje përmes një postimi në rrjetet sociale uroi Ditën Kombëtare të Drejtësisë, ndërsa e shoqëroi postimin e tij me një foto të çadrës nga ku PD po zhvillon protestën e saj prej tre muajsh, duke e cilësuar atë si "bunker i fundit i frikës nga drejtësia". "Ju uroj gëzuar Ditën Kombëtare të Drejtësisë me këtë kartolinë të bunkerit të fundit të frikës nga drejtësia, ku janë ngujuar politikanë që për të bllokuar Vettingun dhe zbatimin e Reformës në Drejtësi, janë gati të na rindajnë për së gjalli nga Europa e të na kthejnë 20 vite pas, në vitin e mbrapshtë '97. Në këtë 104 vjetor të hedhjes së themelit të sistemit të drejtësisë shqiptare nga Qeveria e Ismail Qemalit më 10 maj 1913, shqiptarët janë më afër aspiratës së tyre shekullore për një Shqipëri me drejtësi, shtet e mirëqenie", reagoi ai.

vizituar nga një grup kongresmenësh amerikanë dhe pak ditë parë vizitës së lajmëruar nga zv/ndihmës sekretarin amerikan të Shtetit, Hoyt Brian Yee në Shqipëri.

Basha: Qeveri teknike ose mosbindje civile

Ndërkohë, shefi i opozitës, Lulzim Basha, lëshoi edhe një herë ultimatumin për krijimin e një qeverie tekni-

Pas dy takimeve shterpë nuk kam asnjë dyshim se Edi Rama nuk do t'i bindet zërit të arsyes, as forcës së argumentit por vetëm imponimit të shqiptarëve të bashkuar e të vendosur për të mbyllur kapitullin e drogës dhe kimit. Ndaj në datë 13 Maj, ora 12:00 në mes të Tiranës së bashku do të bashkohemi...



ke sa më parë. Sipas tij, në rast se nuk do ketë konsensus sa i takon kërkesës për një qeveri teknike, republika e vjetër siç e quan Basha, qeverinë "Rama", do të falimentojë përmes mosbindjes civile, e cila do të jetë demokratike. "Unë e shpresoj dhe jam i gatshëm që të marr përgjegjësitë e mia me dialog për ta çuar drejt zgjedhjes politike, e shpresoj dhe i lutem Zotit që kjo të ndodhë. Por në veçanti pas dy takimeve shterpë nuk kam asnjë dyshim se Edi Rama nuk do t'i bindet

zërit të arsyes, as forcës së argumentit por vetëm imponimit të shqiptarëve të bashkuar e të vendosur për të mbyllur kapitullin e drogës dhe kimit. Ndaj në datë 13 Maj, ora 12:00 në mes të Tiranës së bashku do të bashkohemi. Fundi i pashmangshëm do të jetë procesi i një konsensusi ose do të jetë nisja, fillimi i lëvizjes popullore për mos njohjen dhe rrëzimin e çdo institucioni të Republikës së Vjetër përmes mosbindjes civile, paqësore dhe demokratike", shtoi Basha.

Presidenti serb uron Metën: Në të ardhmen marrëdhënie më të mira

Presidenti i Republikës së Serbisë, Tomislav Nikolic, ka uruar dje Kryetarin e Kuvendit, Ilir Meta me rastin e zgjedhjes në postin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Me anë të një telegrami, Nikolic, shprehu besimin e tij se marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimi midis Republikës Serbe dhe Republikës së Shqipërisë do të jenë edhe më të mira në të ardhmen. "Shkëlqesia Juaj! Me rastin e zgjedhjes suaj si President i Republikës së Shqipërisë, po ju shpreh urimet e mia më të mira për sukses në kryerjen e detyrave tuaja me përgjegjshmëri. Unë shpresoj se marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimi midis Republikës Serbe dhe Republikës së Shqipërisë do të jenë edhe më të mira në të ardhmen. Kjo është një çështje me rëndësi thelbësore për paqen, zhvillimin e vendeve tona, dhe të rajonit ku jetojmë. Shkëlqesi, ju lutem pranoni konsideratën time më të lartë. Tomislav Nikolic, President i Republikës së Serbisë", uroi ai.

Sekretari i OSBE: Mbështesim Shqipërinë në procesin e reformave

Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së, Lamberto Zannier, ka uruar dje Ilir Metën me rastin e zgjedhjes së tij si President i Republikës. Përmes një telegrami, Zannier vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer që OSBE ka pasur me Kuvendin e Shqipërisë nën drejtimin Kryetarit Meta, ndërsa shtoi se OSBE mbetet e angazhuar të bashkëpunojë dhe do të mbështesë Shqipërinë në procesin e reformave. "Shkëlqesia Juaj! Ju lutem pranoni urimet e mia të ngrohta për zgjedhjen tuaj President i Republikës së Shqipërisë. Ju merrni këtë detyrë në një moment të rëndësishëm për rajonin e për gjithë Europën, dhe përfitoj nga rasti t'ju uroj sa më shumë sukses. E vlerësoj bashkëpunimin e shkëlqyer që ne kemi pasur me Kuvendin e Shqipërisë nën drejtimin tuaj. Përmes institucioneve të saj dhe Prezencës në Shqipëri, OSBE mbetet e angazhuar të bashkëpunojë ngushtë me autoritetet kombëtare dhe për të mbështetur vendin tuaj, në procesin e reformave", uroi ai.

Kandidatët e 18 qershorit, nga shoferë e teknikë pulti, në parukierë e radistë

Nuk kanë fund çudirat me kandidatët për deputetë në zgjedhjet e 18 qershorit. Pak ditë më parë gazeta nxori detaje nga CV e kandidatëve, ku shumica kanë mbaruar studimet në universitete publike, por dje ka në dale detaje të reja. Instituti i Studimeve Politike denoncon përmes fakteve një skandal të vërtetë të atyre që mund të jenë deputetë e ardhshëm të Kuvendit pasi 3 prej tyre e kanë të sigurt si rrjedhojë e renditjes në listë. Vihet re se mes tyre ka edhe me shtatë klasë shkollë, e jo vetëm pa përvojë politike por vijne edhe nga profesione si shoferë maunesh, parukierë e teknikë. "Janë vetëm disa prej mbi 2000

kandidatëve që janë regjistruar në zgjedhje. Janë rreth 10 raste nga disa parti (PDIU, ADK, PSD, PK, Sfidat, LSI e PS), por të paktën në tri raste kemi të bëjmë me vende të sigurta në listën e kandidimit dhe të zgjedhjes deputet (PS& PDIU). Lexoni deklaratimet e tyre: – njëri tregon se ka punuar gjysmën e jetës shofer, tjetri se është sponsor historik i partisë (në asnjë nga deklaratimet vjetore të PS në KQZ nuk figuron emri i tij si sponsor...!), tjetri është biznesmen, me shkollë të mesme, thotë se ka pasur poste në firmën e tij private dhe kërkon mandat të dytë parlamentar", shkruan Instituti i Studimeve Politike. Ironia e Institutit të Studimeve

Politike i quan thesare profesionet e mëparshme të kandidatëve për deputetë si radis, shofer kamioni, parukierë teknik pulti, dhe të tjerë pa asnjë përvojë pune dhe pa profesion fare. "Shikojini më tej edhe ca modele të tjera me CV, të evidentuara nga stafi i Institutit të Studimeve Politike, në përpjekjet për monitorimin e prurjeve të reja parlamentare. Në to gjenden "thesare": – një radist, dy shoferë të tjerë, me dallimin se njëri është shofer mauneje ndërkombëtare, një punonjës i pastrimit, një punonjës në sallon bukurie, një teknik pulti, dy pa profesion dhe pa përvojë pune në jetë, dhe së fundi, edhe një kandidat me arsim

7 vjeçar bazë!! Shumica e tyre thonë se nuk kanë përvojë politike, por të gjithë janë regjistruar për të shkuar jo në tregun elektrik në Tiranë, por në nivelin më të lartë të politikës, në parlament, – aty ku bëhet politikë, ku miratohen ligje, zgjidhet Presidenti dhe mund të ndryshohet Kushtetuta! Në listat e partive numri i tyre shkon më shumë se 30% e listës së kandidimit, madje shumë prej tyre i gjen edhe në krye të listës në qarqe", thuhet në deklaratën e institucionit. Instituti i Studimeve Politike bën apel që mos të lejohemi që të drejtohem nga këta lloj deputetësh të cilët në legjislaturën e ardhshme do të kenë shumë në dorën e tyre.

■ Zgjedhjet e 18 qershorit në duart e Kolegjit Zgjedhor

Opozita dërgon në Kolegji Zgjedhor listën e kandidatëve, Kume: Ja si bllokohen zgjedhjet nëse pranohet kërkesa

Andi KOROveshi

Opozita e bashkuar së bashku me Partinë Demokratike i janë drejtuar Kolegjit Zgjedhor me një kërkesë për shfuqizimin e vendimit të KQZ për regjistrimin e listave shumë emërore të kandidatëve për deputetë. Duke iu referuar Kodit Zgjedhor, pikërisht nenit 67 të tij, partitë e opozitës kundërshtojnë vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e listave të kandidatëve pasi janë depozituar në KQZ jashtë afatit ligjor. Opozita i kërkon Kolegjit Zgjedhor gjykimin e kësaj çështje në themel dhe të vendosë çregjistrimin e listave shumë emërore të kandidatëve për deputetë të partive që kanë depozituar këto lista me datën 29 prill. Për opozitën afati final i regjistrimit të listave të kandidatëve është me datën 28 prill, e që sipas saj kjo datë përkon me 50 ditë para datës 18 qershor kur është dekretuar data e zgjedhjeve nga presidenti. Kolegji Zgjedhor do të marrë në dorë fatin e zgjedhjeve të 18 qershorit. Prej disa ditësh në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka pasur debate të forta mes anëtarëve, për sa i takon afateve për listat e kandidatëve dhe përmbajtjes së fletës së votimit. Ashtu siç ka deklaruar edhe në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ditën e hënë, përfaqësuesi ligjor i Partisë Demokratike, Ivi Kaso, është shprehur se do i qëndrojë deklaratës për t'u drejtuar Kolegjit Zgjedhor, dhe kjo tashmë është bërë fakt. Kaso është shprehur se i qëndron deklaratave të tij edhe se tani nuk ka rrugë tjetër përveç Kolegjit Zgjedhor, i cili do të vendos se çfarë duhet bërë.

Kume: Nëse Kolegji thotë po, rifillon procesi zgjedhor

Ish-kreu i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kristaq Kume, në një prononcim të dhënë për gazetën "Sot", është shprehur se rast kërkesa e Partisë Demokratike së bashku me opozitën e bashkuar pranohet atëherë nuk do të ketë zgjedhje më 18 qershor. Kume theksoi se s'ka sens që të ketë zgjedhje sepse qytetarët nuk mund të votojnë vetëm subjektin zgjedhor i cili nuk ka një listë shumëemërore kandidatësh të cilët garojnë për zgjedhjet parlamen-

KOLEGJI ZGJEDHOR, HALLKA E FUNDIT E LEGJITIMIT TË ZGJEDHJEVE

Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor është hallka e fundit për të shpallur fituesin në zgjedhje. Kjo është një arsye e fortë që edhe tetë anëtarët e Kolegjit të jenë persona me integritet të lartë në të gjitha drejtimet. Në rast se Komisioni

Qendror i Zgjedhjeve nuk arrin të shpallë rezultatin për arsye të ndryshme, fjala bie mungesë votash, atëherë çështja i kalon Kolegjit Zgjedhor për ekspertizë. Vendimi që merr ky institucion është hallka e fundit dhe i paapelueshëm.

PD KUNDËR KQZ PËR PRANIMIN E LISTAVE

Deputeti demokrat Oerd Bylykbashi ka nënvizuar më 29 prill se KQZ shkeli afatet. "Në 28 prill në mesnatë ka përfunduar afati i regjistrimit të listave, çdo regjistrim do ishte shkelje ligji. Kodi Zgjedhor është shumë i qartë: listat regjistrohen jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve! Dita e 50 është data 29 në orën 00:00. Çdo regjistrim që bëhet sot, do të ishte i paligjshëm. Nëse e bën KQZ dhe askush tjetër nuk ka asnjë mundësi ligjore për të ndryshuar Kodin Zgjedhor, për të ndryshuar rregullat dhe nëse e bën do të jetë haptazi jo vetëm në një paligjshmëri por në një veprim të njëanshëm partizan që nuk është aspak çudi sepse deri më sot ka treguar qartazi qëndrimin e tij, por do ishte paligjshëm i hapur. Nga dita e sotme KQZ e askush nuk regjistron dot më lista ose më saktë, nga mbrëmë në mesnatë, ka përfunduar ligjërisht afati", tha Bylykbashi më 29 prill.

tare. "Nëse Kolegji Zgjedhor rrënon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pra pranon kërkesën e Partisë Demokratike për të rrëzuar pranimin e listave të kandidatëve të 18 qershorit, atëherë nuk do të kemi zgjedhje më 18 qershor. Edhe fill pas kësaj procesi zgjedhor duhet të fillojë nga e para. Kjo është diçka që nuk e përmban Kodi Zgjedhor, por në gjykimin tim interpretohet në të tillë mënyrë. Sepse qytetarët s'mund të votojnë vetëm subjektin zgjedhor kur ai subjekt nuk ka një listë shumëemërore kandidatësh të cilët do të garojnë në zgjedhje", është shpre-

Nëse Kolegji Zgjedhor rrënon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pra pranon kërkesën e Partisë Demokratike për të rrëzuar pranimin e listave të kandidatëve të 18 qershorit, atëherë nuk do të kemi zgjedhje më 18 qershor. Edhe fill pas kësaj procesi zgjedhor duhet të fillojë nga e para. Kjo është diçka që nuk e përmban Kodi Zgjedhor, por në gjykimin tim interpretohet në të tillë mënyrë...



hur ish-kreu i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kristaq Kume. Ai edhe më parë ka deklaruar se, nëse nuk arrihet dialogu politik mes Edi Ramës dhe Lulzim Bashës për daljen nga kriza, do të ishte e udhës që të shty-

hej data e zgjedhjeve, pasi vendi nuk mund të shkojë në zgjedhje pa opozitën. Ai është shprehur se nuk ka më kohë për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, ndërsa komisioni i posaçëm dëshmoi mungesë vullneti.

Ndocaj zyrtarizon koalicionin me PD

Kryetari i Partisë Bashkimi Demokratian Shqiptar, Eduart Ndocaj njëkohësisht dhe deputet i Parlamentit, zyrtarizoi koalicionin me opozitën me pjesëmarrjen në çadër: "Zyrtarisht jemi në koalicion me qytetarët dhe sigurisht me Partinë Demokratike", tha Ndocaj. Sipas Ndocajt, do të jetë në shërbim të qytetarëve dhe në dobi të tyre, ku nga çadra nuk ngurroi të akuzojë dhe qeverinë: "Do jemi një zë në dobi të qytetarëve dhe në shërbim të qytetarëve. Kjo qeveri e ka kompletuar misionin e saj. Ka ardhur koha për zgjedhje të lira dhe të ndershme, ka 25 vite që mohohet vota e emigrantëve. PS e kishte në program votën e emigrantëve dhe na tradhtoi, siç na tradhtoi në 2015 dhe 2017 tani. Nuk duhet një ligj për këtë por mjafton vullneti. Ishim të regjistruar në KQZ por nuk prezantuar kandidatët sepse nuk mund të futemi në zgjedhje, sepse listat e zgjedhësve nuk janë të ligjshme", tha deputeti Ndocaj.

Blushi: LIBRA, 1000 euro për çdo bebe

Kreu i LIBRA Ben Blushi nëpërmjet një statusi në Facebook ka ngritur problemin sipas të cilit, Shqipëria po plaket dhe se popullsia e saj po tkurret. Në këtë kuadër, ai ka prezantuar një nga pikat e programit të tij elektoral ku premtim se partia e tij, LIBRA do të paguajë deri në 1000 euro çdo familje për lindjen e një bebeje. Sipas tij, të shtosh Kombin është një detyrim që shoqëria duhet ta shpërblejë. Në status, kreu i LIBRA ka publikuar disa shifra ku ka bërë krahasime me numrin e lindjeve nga viti 1990 e deri në 2013, sipas të cilëve kemi 3000 fëmijë më pak se një vit më parë. "LIBRA do ndjekë një politikë të qartë kundër shpopullimit të vendit duke hapur punë për të rinjtë, duke inkurajuar kthimin si investitorë të emigrantëve në Shqipëri si dhe duke nxitur lindjet. LIBRA do paguajë deri në 1000 euro çdo familje për lindjen e një bebeje duke besuar se të shtosh Kombin sot është detyrim që shoqëria duhet ta shpërblejë", thekson Blushi

politike

Fatmir Xhafaj mesazh PD: Nuk do të lejojmë prishje të zgjedhjeve, policia ka marrë masa

Kur vetëm pak ditë na ndajnë nga protesta e opozitës në Tiranë, ditën e djeshme nga Shkodra, ministri i Brendshëm ka bërë një koment të shkurtër në lidhje me tubimin e opozitës. I pyetur nga gazetarët nëse do ketë trazira në protestën e opozitës e paralajmëruar në 13 maj, Xhafaj deklaroi se “kjo mbetet për t’u parë”. Nga ana tjetër, gjatë fjalës së tij, ai ritheksoi se Policia nuk do të përfshihet në fushatën zgjedhore por vetëm do të garantojë

që procesi i votimit do shkojë mirë. “Zgjedhjet e 18 Qershorit janë absolutisht të garantuara, sepse zgjedhjet në përgjithësi i garanton Kushtetuta dhe ligji. Dhe Policia është në funksion të respektimit dhe garantimit të Kushtetutës e të Ligjit. Dhe Policia vetëm bën detyrën që i ngarkon ligji”, u shpreh Xhafaj. Por sa i takon, ndryshimeve të fundit që prekën Policinë, Xhafaj ka mohuar akuzat e bëra se ndryshimet kanë pasur prapavijë politike. Sipas tij, ato ish-

in të nevojshme pasi i japin një tjetër ritëm punës së bërë. “Si mendoni ju, është më mirë që të ndryshojnë drejtuesit, apo të qëndrojnë në të njëjtin vend? Sepse çdo lloj rifreskimi, çdo lloj lëvizjeje, bën mirë për t’i dhënë ritëm të ri punës, ritëm të ri çështjeve e prioritetëve. Në kohë të ndryshme ka prioritet të ndryshme. Dhe natyrisht Kanabisi është një prioritet. Dhe në Shkodër, për hir të së vërtetës, është një prioritet i rëndësishëm për shkak se, në vite, zona të cak-

tuara mund t’i konsideroj edhe si Lazarati me kanabisin. Në vite të tëra, ndërkohë që flitej për Lazaratin, shpeshherë harronim që kishim dhe një Lazarat këtu në Shkodër. Por unë besoj që me punën e bërë në gjithë këto vite, me punën që po bëhet, me ndërgjegjësimin qytetar në radhë të parë, me vullnetin që është duke treguar Qeveria dhe gjithë strukturat e saj, ky fenomen do të vijë drejt shuarjes”, deklaroi Xhafaj, ndër të tjera në fjalën e tij.

■ Krerët e degëve mobilizojnë qytetarët për protestën

Zbulohen detajet e protestës së 13 majit, Basha heq çadrën para Kryeministrit, synohet që tubimi të zgjasë më shumë se një ditë

Rigels SELIMAN

Zbardhen detajet e protestës së 13 majit, thirrur nga Partia Demokratike dhe aleatët e saj. Kryepozitari Lulzim Basha e ka deklaruar se nuk do ketë zgjedhje të përgjithshme të dielën e 18 qershorit dhe opsioni i vetëm që i ka mbetur atij, me anë të së cilës synon të ndalojë mbarëvajtjen e procesit, është ajo e protestës. Sipas burimeve të gazetës, më 13 maj pritet që të hiqet çadra e vendosur para selisë së Kryeministrit, vend nga i cili shefi i opozitës do të deklarojë fillimin e mosbindjes civile, me qëllim që të arrihet qeveria teknike. Basha e ka deklaruar se çadra do qëndrojë deri në arritjen e qëllimit, por duket se skenarët kanë ndryshuar. Fillimisht, çadra do të largohet për të liru sheshin para Kryeministrit, por në varësi të njerëzve që do të marrin pjesë do shihet dhe ecuria e saj. Sipas informacioneve, synimi që protesta të zgjasë më shumë se një ditë dhe nëse kjo arrihet, çadra mund të mos ngrihet më, pasi do vijojnë protesta edhe në rrethe. Por gjithçka sa i takon përmblidhjes së planeve të hartuara nga kreu i Partisë Demokratike, është e lidhur ngushtë me sasinë apo numrin e madh të pjesëmarrësve që do jenë prezent në atë protestë. Protesta e caktuar nga PD, do të nisë në orën 12:00 me orën lokale, me disa fjalime të deputetëve dhe anëtarëve më të lartë të PD-së, ndërsa do synohet që gjithë Bulevardi Dëshmorët e Kombit dhe jo vetëm do të mbahet i bllokuar gjatë gjithë natës, ndoshta edhe përtej. Megjithatë edhe pse aludohet se protesta mund të karakterizohet nga skena jo demokratike, ai i cili ka dhënë garanci se protesta do zhvillohet paqësore është vetë kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha.

Udhëzim i Bashës për krerët e degëve

Vlen të nënvizojmë se gjatë gjithë këtyre ditëve, pas shpalljes së lajmit se në 13 maj do të organizohet protesta me e madhe e Partisë Demokratike, lideri demokrat, Lulzim Basha, ka pasur kontakte të vazhdueshme me krerët e degëve të PD-së në rrethe, duke u kërkuar këtyre të fundit që të mblidhin sa më shumë njerëz për të qenë të pranishëm atë ditë. Lideri i demokratëve, Lulzim Basha, ua ka besuar organizimin e protestës deputetëve besnikë pranë tij, ndërsa krerët e degëve në rrethe së bashku me deputetët

BASHA: NË 18 QERSHOR NUK DO LEJOJMË ZGJEDHJE

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, deklaroi pak ditë më parë se më 18 qershor nuk do të lejojë që të ketë votim monist. Nga çadra e protestës, ai u shpreh se Edi Rama ka shkatërruar çdo zgjedhje që ai kishte në dorë, dhe se këtë gjë ka në plan të bëjë edhe më 18 qershor: “Kjo është historia e 4 viteve që shkuan dhe që mbyllet përfundimisht më 18 qershor. Votim monist më 18 qershor, nuk

do të ketë. Votim pa opozitën, nuk do të ketë. Parlament të diktuar nga krimi dhe droga, nuk do të ketë. Më 13 maj nisim marshimin për ta institucionalizuar, për ta bërë realitet ligjor, kushtetues, kombëtar, Republikën e re të qytetarëve shqiptarë. Ne njohim e do të njohim vetëm këtë republikë të re. Bëhuni pjesë e konsensusit, ose përballuni me popullin”, është shprehur ai, pak ditë më parë.

Kreshnik Spahiu: Në 13 maj të rrethojmë Kryeministrinë



“Unë i kam kërkuar të paktën lidhshmit të opozitës që të rrethohet Kryeministria dhe Edi Rama të mos lejohet të hyjë në zyrë, populli nuk duhet të lejojë Edi Ramën deri sa të gjejë gjuhën e kompromisit. Sepse ne nuk mund të lëmë 4 vjet një Shqipëri të destabilizuar, më mirë 4 ditë. Do shtrihemi përtokë dhe le të kalojë mbi trupat tonë. Nëse Partia Demokratike do të zgjedhë një strategji paqësore si kjo apo më të fortë mbetet për tu parë dhe do të jetë surprizë për të shtunën. Por protesta e të shtunës nuk do të jetë si protestat e tjera, gjithmonë do të ketë kreativitet. Ashtu siç protesta e 18 shkurtit krijoi çadrën edhe protesta e 13 maj do të prodhojë diçka surprizë që do ta detyrojë Edi Ramën për të gjetur rrugën e dialogut, për ta çuar Shqipërinë në qeveri teknike”, deklaroi Kreshnik Spahiu, pak ditë më parë.

e zonave kanë nisur mblidhjet me strukturat dhe anëtarësinë e PD, ku i kanë udhëzuar që të mblidhin sa më shumë militantë, simpatizantë të partisë, por edhe të pakënaqur ndaj qeverisë aktuale, për të protestuar në 13 maj. Sipas udhëzimeve të Lulzim Bashës, protesta

Më 13 maj pritet që të hiqet çadra e vendosur para selisë së Kryeministrit, vend nga i cili shefi i opozitës do të deklarojë fillimin e mosbindjes civile, me qëllim që të arrihet qeveria teknike. Basha e ka deklaruar se çadra do qëndrojë deri në arritjen e qëllimit, por duket se skenarët kanë ndryshuar...



e së shtunës duhet të jetë madhështore për të trembur Partinë Socialiste dhe kryeministrin Edi Rama për zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit. Meqenëse kryeministri Rama ua prishi planet demokratëve për trazirat që do të bënin në Kavajë, PD do të angazhohet për një organizim madhështor në 13 maj, për t’i treguar qeverisë të kundërtën, se ata nuk tërhiqen nga kërkesa e tyre për qeveri teknike, pa Ramën kryeministër. Krerët e degëve së bashku me deputetët e zonave, në bazë të direktivave të krye-

tarit Basha, po udhëzojnë njerëzit e tyre që gjatë këtyre ditëve të mbetura që të angazhohen sa më shumë në terren në terren dhe të sjellin me listë sa më shumë njerëz në bulevardin e Tiranës. Pra zhvillimi i protestës më të madhe të organizuar në Shqipëri, e cila do të ndodhë më 13 maj, është një nevojë e cila Basha ka lidhur shpresat e tij, duke e katapultuar këtë të fundit tek kauza, siç është ajo për qeveri teknike. Por se fare do të ndodhë dhe si do të shkojë, le të presim 13 majin!

Vasili bën thirrje për reflektim të shumanshëm

Kreu i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Petrit Vasili, ditën e djeshme, deklaroi se ai dhe partia të cilën drejton, po bën të gjitha përpjekjet për rikthimin e opozitës në proces. Por sipas tij, kjo nisim nuk u vlerësua nga PD. “Kemi vënë në dispozicion gjithçka që ne mund të investojmë në politikë përfshi dhe investimin politik të drejtpërdrejt duke nisur nga pozicionet më të larta shtetërore. Jam referuar vetes në radhë të parë, në dispozicion të zgjidhjes politike. Reflektimet duhet të jenë të shumanshme dhe nga të gjithë aktorët për të kuptuar jo të tashmen por e nesërmja e vendit”, nënvizoi ai. Nga ana tjetër, Vasili theksoi se konflikti politik ka penguar çdo gjë në vend, duke shtuar se duhet një zgjidhje sa më e shpejtë, siç është zbatimi i reformës në drejtësi. “Reforma në drejtësi është pjesë e një ngërçi politik të përgjithshëm. Përjetimet e një krize politike e cila jo vetëm pengon reformën në drejtësi, ndikon në zhvillimin ekonomik”, u shpreh Vasili.

Fushata zgjedhore, socialistët kërkojnë fitoren në Lezhë

Partia Socialiste prezantoi ditën e djeshme, ekipin e kandidatëve për deputet në Qarkun e Lezhës që do garojnë për zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit. Në vijim të fjalës së saj, ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla kërkoj votëbesimin e qytetarëve në zgjedhjet e 18 qershorit për të vijuar me një mandat të dytë të qeverisë Rama. Sipas saj, vetëm qeveria Rama, mund të bëjë më shumë për Lezhën. “Ka ende varfëri, kemi shumë probleme me shkollat, spitalet, rrugët por ajo që është më e rëndësishme kemi më shumë punë nëse kthehemi pas. Ndaj bashkë jemi të vendosur për të mbajtur premtimet dhe angazhimet për të bërë më shumë për Lezhën që duam”, deklaroi ajo. Ndërsa, Pjerin Ndreu theksoi se me apo pa PD në zgjedhje, fitorja e PS, do të jetë plebishitare jo vetëm në Lezhë por në të gjithë vendin. “Ne, skuadra jonë me datën 18 qershor do të arrijmë një fitore të pashembullt edhe në qoftë se PD-ja do të ishte këtu edhe nëse PD-ja nuk do të ishte këtu”, shtoi ai.

politike

www.sot.com.al

LSI në fushatë elektorale, kandidatët për deputetë takime në Tiranë: Synojmë të jemi forcë e parë

Lëvizja Socialiste për Integrim vijon fushatën elektorale për zgjedhjet e 18 qershorit. Kandidatët për deputetë të Lëvizjes Socialiste për Integrim në qarkun e Tiranës zhvilluan një takim me të rinjtë e Njesisë Administrative nr. 2 të kryeqytetit, ku u diskutua për programin e LSI për rininë dhe arsimin. Në fjalimet e tyre, kandidatët për deputetë kanë paralajmëruar se LSI do dalë forcë e parë pas 18 qershorit. Kryetarja e Lëvizjes Rinore për Integrim, Floida Kërpaçi u

shpreh në fjalën e saj se LSI-ja është partia politike, që ka një program real për arsimin cilësor dhe për punë të mirëpaguara. "LSI do të dalë forcë e parë, sepse ka një program real që do të sjellë një arsim cilësor për të gjithë ne të rinjtë, që do të sjellë një punë të mirëpaguar për ne, për familjet tona dhe për të përballuar kështu kostot e jetesës, rritjen e mirëqenies dhe mbi të gjitha do të sjellë një shans për një jetë më të mirë për vendin tonë", u shpreh kryetarja e LSI-së. Kandidatja për de-

putete e LSI-së, Kejdi Mehmetaj u shpreh se LSI ka një program konkret i cili mbështet fuqishëm të rinjtë në arsimin dhe në punësim. "Plani ynë është i qartë, është konkret: edukim cilësor për familjet të shëndetshme, punë të mirëpaguara dhe dinjitoze për të rinjtë dhe të gjithë shqiptarët dhe më shumë mirëqenie. Por asnjëra nga këto nuk bëhet në qoftë se ajo që na udhëheq është kokëfortësia apo arroganca. Prandaj ne sot japim modelin e vetëm atë të thjeshtësisë për të ecur

përpara", u shpreh Kejdi Mehmetaj. Në fjalën e tij përshëndetëse përpara të rinjtë, Ilir Meta shprehu besimin se të rinjtë shqiptar janë ata që duhet të mbështeten më shumë për shkak se të rinjtë sakrifikojnë gjithçka për idealet e tyre. "Të rinjtë kanë ato ëndrra të cilat i bëjnë të sakrifikojnë gjithçka për të ardhmen e tyre dhe të vendit të tyre dhe kanë atë idealizëm pa të cilin një vend nuk mund të ndryshojë dhe nuk mund të ketë progres shoqëror", tha Meta.

PS fushatë si në 2013, tur takimesh me autobus

Nis rivaliteti PS-LSI në bazë, Rama urdhër deputetëve të sigurojnë sa më shumë vota nga PD, zbardhen detajet e fushatës

Enaida JAÇAJ

Zbardhen detajet e fushatës së Partisë Socialiste dhe udhëzimet që duhet të ndjekin kandidatët për deputetë për 18 qershorin. Ashtu si në zgjedhjet parlamentare të 2013, edhe në këtë fushatë elektorale do të ketë tur takimesh me autobus. Në aktivitetet dhe takimet elektorale që do të zhvillohen në të gjithë vendin në kuadër të fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit, kryeministri Edi Rama së bashku me kandidatët në zonat e caktuara do të lëvizin me autobus dhe jo me makinat e shtetit. Ky është urdhri i kryeministrit Rama që ua ka dhënë deputetëve aktualë që janë kandidatë për 18 qershorin, që të mos shpenzojnë paratë e buxhetit të shtetit për takimet elektorale. Partia Socialiste ka vënë në dispozicion një autobus, me të cilin do të lëvizin kryeministri Rama dhe deputetët, ndërsa deputetët aktualë dhe kandidatët e rinj për deputetë që do të zhvillojnë takime me qytetarët në zonat e tyre do të përdorin makinat e tyre personale. Ndërkaq, zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit do të jenë një betejë e madhe për PS dhe LSI. Dy partitë e mëdha të koalicionit qeverisës po luftojnë për të siguruar votat e Partisë Demokratike në 18 qershor. Nga njëra anë LSI u bën thirrje votuesve të djathtë që janë të pakënaqur me kryeministrin Edi Rama të votojnë LSI në 18 qershor, ndërsa kreu i qeverisë u ka vënë detyrë deputetëve që të dalin në terren dhe të sigurojnë sa më shumë vota nga demokratët. Rama është trembur nga lëvizjet e LSI, e cila synon të marrë pushtetin, dhe ka hedhur në terren të vetët që t'u bëjnë premtime qytetarëve që votojnë PD, në mënyrë që votat e tyre të mos shkojnë te aleati më i madh i PS në koalicion. Kryeministri ka paralajmëruar se PS do të jetë forcë e parë dhe me diferencë të madhe krahasuar me zgjedhjet parlamentare të 2013, duke i bërë të qartë LSI se do të jetë në opozitë. Kjo është beteja më e madhe sot për sot, mes PS dhe LSI.

Deputetët në terren

Kryeministri Rama ka nxjerrë një dokument ku udhëzon deputetët se si të sillen në fushatë për të mbledhur sa më shumë vota. Rama kërkon angazhim të thellë dhe fjalimet e fushatës duhet të përqendrohen

RAMA: PS DO TË JETË FORCË E PARË

Kreu i qeverisë, Edi Rama, paralajmëroi dy ditë më parë, se PS në këto zgjedhje do dalë forcë e parë, dhe madje do ketë shumicën më të madhe parlamentare në këto 27 vite. "Ne do të jemi jo vetëm forca e parë e këtyre zgjedhjeve, por do kemi një shumicë parlamentare më të madhe se kurrë ndonjëherë në 27 vjet dhe kjo është një peshë përgjegjësie kolosale, të cilën duhet të fil-

lojmë ta ndjejmë që tani, në çdo qelizë të qenies tonë politike. E duhet t'ua bëjmë të qartë shqiptarëve se nuk vijmë tek ta për vete, por për t'u bërë bashkë, si fuqia e një ndryshimi po aq të madh, sa përgjegjësia e rëndë që do të marrim në 18 qershor", u shpreh Rama. Kryeministri theksoi se në katër vitet që do të vijmë, do të ndërtohet Shqipëria që ne duam të gjithë.

Kryeministri: Vendi, me opozitë të re

Kryeministri Edi Rama, deklaroi në Kongresin e së martës se pas 18 qershorit, vendi do të ketë opozitë të re. Duket se kryeministri ka konfirmuar atë që ka paralajmëruar gazeta më herët, se pritet që të jetë LSI ajo që do zëvendësojë PD. Kreu i qeverisë paralajmëroi PD se vendi nuk do mbetet pa opozitë, ndërsa i dha një sinjal të qartë LSI, e cila pretendon të marrë pushtetin, se do të mbetet opozitë pas zgjedhjeve parlamentare. "Do të jetë Parlamenti i parë pa Saliun, por jo pa opozitë. Saliu e gjeti vetë rrugën e ikjes pa kthim nga ajo sallë, ku cenoi çdo normë edukate. Shkeli çdo porosi të Kanunit, shau dhe shpifi pa fund, e rrëmbeu PD nga duart e studentëve në 1990, e çoi në humnerë në 1997, e ringriti dhe tani e mbyti me duart e tij", deklaroi Rama.

te rritja e punësimit dhe këmbëngulja e PS për vetingun. "Filloni me çka kemi bërë deri më sot: ndërtimin e shtetit-pagesën e taksave dhe faturave, reformën në polici, ligjin e vetingut. Pranoni se ka ende shumë për të bërë, për të krijuar edhe më shumë vende të reja pune. Krijoni kontrast me PD dhe vini theksin te ajo çfarë rrezikojmë në këto zgjedhje: nëse do të ecim përpara me PS drejt ndërtimit të shtetit, punësimit dhe mirëqenies, apo nëse do të kthehemi pas me PD duke e zhytur vendin në kaos dhe rrënim si në '97. Bëni

Ashtu si në zgjedhjet parlamentare të 2013, edhe në këtë fushatë elektorale do të ketë tur takimesh me autobusë. Në aktivitetet dhe takimet elektorale që do të zhvillohen në të gjithë vendin në kuadër të fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit, kryeministri Edi Rama së bashku me kandidatët në zonat e caktuara do të lëvizin me autobusë dhe jo me makinat e shtetit...



premtimin kyç të fushatës: Ne do të luftojmë për punësimin po aq fuqishëm sa ç'luftuam edhe për drejtësinë", thuhet në dokument. Fushata do të mbështetet edhe në kontrastin me PD. "PS ndërtoi shtet-PD ka rrënuar shtetin; PS do vetingun-PD kundër

vetingut; udhëheqje e qëndrueshme dhe hapje për dialog-agresivitet dhe ekstremizëm; betejë për mbajtjen e premtimeve-premtime boshe të dështuara; rezultate reale në Tiranë-dështimi i premtimeve të Bashës si kryebashkiak", thuhet në dokumentin e PS.

Balla në Elbasan: PD nuk është partia e atyre që e kanë votuar

Koordinatori i fushatës për Qarkun e Elbasanit, Taulant Balla, zhvilloi takime me qytetarët për t'i njohur ata me alternativën qeverisëse të Partisë Socialiste për 4 vitet e ardhshme. Gjatë takimeve në familjet në lagjen "Çlirim" të Elbasanit, deputeti socialist theksoi rëndësinë e zgjedhjeve të 18 qershorit për të garantuar të ardhmen e Shqipërisë që duam. Deputeti Balla ftoi edhe qytetarët me bindje të djathta të votojnë majtas, pasi siç tha Partia Demokratike, nuk është më partia e tyre, që ditën që bojkoti kuvendin për të mos votuar vetingun. "Gjëja më qesharake ishte që një parti politike e cila gëzohej se nuk ishin zhvilluar zgjedhjet lokale në një bashki tek e cila kishin 2 vjet që kërkohin të ikte kryetari i bashkisë. Tani që Kryeministri i Shqipërisë e shkarkoi kryetarin e bashkisë hajde konkurro", tha Balla. Ai tha se komisionet e vetingut do të votohen nga qeveria e re e kryeministrit Rama, në seancën e parë të parlamentit të ri. "Tashmë 18 qershor është i sigurtë, fletët e votimit kanë shkruar të printohen dhe komisionet e vetingut do t'i votojmë në ditën e parë të seancës kur do të betohet qeveria e Edi Ramës", tha Balla.

Gjylameti: Ne luftojmë për Shqipërinë, ata e rrënojnë

Kandidatja e Partisë Socialiste për Tiranën, Blerina Gjylameti, ka reaguar në një postim të sajën në Facebook, duke shpjeguar pse nuk jemi njësoj si të tjerët dhe se ne ndërtojmë ata rrënojnë, duke anatuar kështu PD-në. "Pikërisht pse nuk jemi njësoj, ne luftojmë për Shqipërinë që Duam në Europën ku duam të hyjmë, me shtet dhe me dinjitet, ndërsa ata duan të na kthejnë prapa, në rrëmujën dhe rrëmetin e kohëve të zymta. Pikërisht pse nuk jemi njësoj, ne, sot kemi në qeveri 50% burra, 50% gra. Ata, edhe dy gra që kanë e u kanë dalë kundër, i kanë shpallur armike, vetëm e vetëm se nuk kanë çadër në vend të gjuhës. Ne ndërtojmë, ata rrënojnë. Ne punojmë, ata bërtasin. Ne flasim, ata me libër shtëpie! Ne luftojmë për Shqipërinë, ata luftojnë vetëm për veten e tyre", shkruan Gjylameti.

politike

Ministri i Drejtësisë: Uroj të ketë zgjedhje më 18 qershor

Petrit Vasili kundër Ramës: Të ndalen kërcënimet ndaj opozitës, nuk po ndihmohet dialogu, politika s'është lojë shahu

Ministri i Drejtësisë, Petrit Vasili ka dalë kundër deklaratave të bëra nga kryeministri Edi Rama dhe eksponentë të Partisë Socialiste, në drejtim të PD. Rama në çdo deklaratë të tij ka akuzuar PD se ka frikë nga vetingu, ndërsa në shumë raste ka deklaruar se PD po vetëasgjësohet. Mirëpo Petrit Vasili i cilëson të gabuara të tilla deklarata. Gjatë një interviste për EniVasilin në "News 24", ai tha se deklarata ultimative, apo akuzat nuk e ndihmojnë dialogun, por e dëmtojnë atë.

-Vetëpërbajtja e çoi Ilir Metën në Presidencë?

Jo! Vetëpërbajtja i dha Ilir Metës dimensionin e një kryetari shteti, i cili ka mundësinë të shikojë në sy të gjithë shqiptarët dhe të mos ketë frikë të shikojë gjysmën apo të adhurohet nga gjysma tjetër. Presidenti i të gjithë shqiptarëve duhet të jetë i tillë.

-Ju po praktikoheni për postin e Kryeministrit pasi synimi juaj është për të dalë forcë e parë...

Jo, unë jam praktikuar që t'u flas shqiptarëve me shumë modesti. Të kuptoj vazhdimisht çdo ditë një konstatim, që nuk e gjej në qendrën e Tiranës, por përpiqem ta gjej edhe në fshatrat mjaft të varfra të vendit. Pra, me modesti të vazhdoj të kem bindjen që vendi ka nevojë për shumë punë dhe ne kemi bërë pak dhe duhet të bëjmë shumë më tepër. Vendi ka nevojë për shumë thjeshtësi, pasi ka një pafundësi halle të cilat kërkojnë përgjigje imediate. Mijëra e mijëra të rinj kërkojnë një zgjidhje të jashtëzakonshme dhe të shpejtë për papunësinë e tyre dhe këto probleme të gjitha zgjidhen vetëm me përlulësi dhe modesti, këtë dhe me vetëpërbajtje pse jo, por me punë të madhe. Jashtë këtyre parametereve, jashtë këtyre standardeve politike, besoj se jemi në standardet e vetëkënaqjes, të aventurës dhe të atij që nuk i bëhet vonë se çfarë halle kanë të tjerët. Ky standard nuk është standardi ynë.

-Megjithatë fushata ka filluar z. Vasili e keni marrë drejtimin e LSI-së në një moment jo dhe aq të thjeshtë politik, përkundrazi. Le ta fillojmë me një konsideratë të përgjithshme, ndoshta dhe me një batutë nëse ju vjen? Çfarë e konsideroni këtë moment politik?

Për t'u shprehur në një fjali, nuk do të doja që Shqipëria të përjetonte një moment politik të tillë. Pasi në 27 vjet pluralizëm të diskutojmë faktin që a do të kemi zgjedhje normale dhe a do kemi pjesëmarrje të opozitës, jo thjeshtë opozitën, duke patur parasysh njerëzit, por opozitën si institucion. Pasi sistemi në të cilin jetojmë është një sistem i ngritur mbi dy krahë të politikës, mbi mazhorancën dhe opozitën, që sigurojnë balancën dhe kontrollin e pushteteve. Qoftë dhe mazhoranca dhe opozita të gjithë biem dakord që nuk e përcaktojmë ne, por e përcaktojnë votat e qytetarëve. Ajo votë përcakton vendin e gjithsecilit. Dhe sigurisht të mendosh



që në Shqipëri të bëhen zgjedhjet pa opozitën, ka qenë jashtë imagjinatës time politike.

-Edi Rama thotë që ka një krizë të lidhshme të Partisë Demokratike, jo një krizë politike. Ju jeni dakord me këtë?

Problemi është ky: përtej të gjithë frazave dhe batutave apo të gjitha konsideratave, që mund të jenë konsiderata të ditës dhe që e kanë jetëgjatësinë e tyre mbas edhe 24-orësh, ne duhet të bëjmë çdo gjë që në zgjedhje ta kemi opozitën, jo si e mirë e mazhorancës, por si e mirë e sistemit që shqiptarët ngritën mbas viteve 1990.

-Ju do vazhdoni sepse duket sikur ju të LSI, mbas Presidencës jeni dorëhequr nga negociata, përpjekjet?

Ka disa objektiva që shkon përtej 24-orëve, përtej javës. Janë objektiva afatgjata. Ne kemi një prioritet mbi të gjitha prioritetet. Ju e kuptoni fare mirë. A do të kemi negociata të shpejta për anëtarësimin e Shqipërisë, në BE, me zgjedhje që bëhen në mënyrë të njëanshme, pa opozitën. Unë po e them nuk do të jenë të shpejta. Do të jenë shumë të largëta dhe të vonshme.

-Ambasadorja Gjermane tha se do ti njohim zgjedhjet. Ndërkombëtarët duket sikur nuk janë aq të shqetësuar për këtë çështje?

Unë po them a do të kemi negociata të shpejta apo jo? Nuk po them a u njohën zgjedhjet e radhës. Zgjedhjet e radhës janë njohur dhe në vitin 1996. Besoj ju i kujtoni se rekordet i kemi të qarta. Nuk po vazhdoj më me konsiderata të tjera. I mirënjohuri Aurel Plasari ka vënë në dispozicion para pak javësh mënyrën sesi janë njohur zgjedhjet e vitit 1945, në Shqipëri, që nuk kishte opozitë. Pra, mendojmë për objektiva afatgjata ku Shqipëria projektohet të shkojë. Kemi objektiv tjetër. Kemi investuar disa vite për reformën në drejtësi. A mund të kemi besueshmëri të zbatimit të reformës në drejtësi, në zgjedhje të

njëanshme pa opozitën? Dy objektiva madhore integrimi në njërinë anë dhe reforma në drejtësi në anën tjetër. Dy objektiva ku janë investuar mijëra e mijëra energji politike, orë punë, nerva, orientim i të gjithë opinionit publik në një drejtim të caktuar, a janë të garantuar? Unë them që janë seriozisht të rrezikuara. Përsa i takon në planin konkret.

-Këto janë dy objektiva kryesor LSI u përpoq, Ilir Meta gjithashtu deri në moment të fundit thirrret një tryezë, e cila më pas dështoi...

Ne bëmë gjithçka, do më lejoni ta them këtë gjë, LSI dhe Ilir Meta bënë gjithçka për këtë gjë. Ju e dini shumë mirë, që ne, në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë, të sinqertë, një afirmim politik që unë kemi porositur edhe sot nga Shkodra, ku unë pata mundësinë të merrja pjesë në një inaugurim të Gjykatës së Apelit në Shkodër, një strukturë shumë bashkëkohore. Kemi vënë në dispozicion të gjitha mandatet tona politike. Ilir Meta si Kryetar i Kuvendit, në funksion të këtij objekti madhor në të pasur zgjedhje të lira, të ndershme dhe të njohura, të gjithëpranuara dhe ku marrin pjesë të palët.

-Ju i kishit kusht zgjedhjet me opozitën? A vazhdoni t'i keni?

Ne nuk kemi bojkotuar kurrë në historinë tonë politike, as në rrethanat më të vështira për ne. Ju i kujtoni rrethanat e vitit 2009. Kanë qenë rrethanat më penalizuese që mund të ekzistojnë në politikë. Të njëanshme, të pranuar botërisht edhe nga aktorët në proces, edhe në momentin që miratohet reforma zgjedhore. Të kthemi edhe te çështja e këtij kompromisi. Unë mendoj që Opozita nga njëra anë ka gabuar rëndë në momentin kur ajo nuk reflektoi thëllë për paketën e McAllisterit. Në vlerësimin tim kishte elementët e një kompromisi politik dinjitoz, një kompromis pa humbës dhe fitues, një kompromis që rivendoste besimin politik. Sepse këtu, në radhë të parë, është

E kam mbështetur tërheqjen nga Kavaja.

Të jem i sinqertë, e kemi sugjeruar edhe më parë. Pasi, në radhë të parë, tërheqja nga Kavaja ishte një çtensionim i situatës, pasi parashikohej të ishte një situatë e tensionuar që nuk do të prodhonte zgjedhje, por do të prodhonte një problem dhe një tension publik të radhës...

të lëkundur dhe është tronditur thëllë besimi mes klasës politike, mes mazhorancës dhe opozitës dhe ky mosbesim i thëllë ka prurë këtë situatë kaq të madhe. Njëkohësisht, vazhdoj ta mendoj, që ky ishte një gabim. Por, vazhdoj të kem të njëjtën bindje që ne akoma mund të bëjmë diçka dhe duhet të bëjmë gjithçka që Opozita të përfshihet në zgjedhje. Por, ne nuk duhet ta provokojmë Opozitën, as me retorika kërcënuese dhe as shantazhuese.

Për çfarë e keni fjalën?

Retorika të të gjitha formave të cilat janë në rekordet tuaja. "Ç'do t'i ndodhi asaj", "ç'lidhje ka me Vettingun", "si do të këputen tokat", "si do të vetëasgjësohet" etj.

Për retorikat e Kryeministrit e keni fjalën?

Një retorikë e cila, si e tillë, vetëm e minon kompromisin, vetëm e bën të pamundur dhe, sigurisht, është e qartë që edhe opozita duhet të jetë më e hapur drejt një kompromisi, të mos jetë e mbyllur, të kuptojë që rruga drejt kompromisit është një rrugë e një lëshimi reciprok. Por thashë, në mënyrë të veçantë, mazhoranca duhet të jetë e kujdesshme. Pse? Në analizë të fundit, sistemi politik, Shqipëria, e ardhmja e vendit kërkon zgjedhje ku të marrë pjesë mazhoranca dhe opozita, pasi zgjedhjet e njëanshme janë momenti kur demokracia vihet thëllësisht në rrezik, ndodh një udhëkryq ku rruga e saj e mëtejshme është e paparashikuar, me risqe që mund të dalin jashtë kontrollit të politikës dhe për fat të keq historia të tilla Shqipëria i ka provuar një herë. Vetëm historive të provuara në mënyrë të dhimbshme një herë nuk duhet t'u rikthehemi pas për asnjë arsye.

-Ju keni përshëndetur tërheqjen e kryeministrit, tërheqjen e PS me kandidatit e saj nga Kavaja. Ia sugjeroni mazhorancës të njëjtin skenar për 18 qershorin?

E kam mbështetur tërheqjen

nga Kavaja. Të jem i sinqertë, e kemi sugjeruar edhe më parë. Pasi, në radhë të parë, tërheqja nga Kavaja ishte një çtensionim i situatës, pasi parashikohej të ishte një situatë e tensionuar që nuk do të prodhonte zgjedhje, por do të prodhonte një problem dhe një tension publik të radhës. Do të shtonte pasigurinë publike, do të ulte kualitetin, do t'i prishte paraprakisht edhe zgjedhjet e 18 qershorit. Pra, do të ishte një kontribut negativ edhe në procesin zgjedhor. E kam konsideruar një hap në të mirë të çtensionimit të situatës, që edhe më parë mund të merrej, pasi rruga në të cilin ne duhet të ecim ishte një rrugë që prodhonte kompromisin, rrugë e cila e ndërtonte kompromisin me gjithë sakrificat që ky kompromis kërkon. Dhe nuk kemi pse trembemi nga sakrificat në emër të një të mirë madhore, që është stabiliteti dhe siguria e vendit. Pasi të jemi objektiv vendi po përjeton një pasiguri absurde, qytetarët shqiptarë në njërin anë, por edhe ekonomia në anën tjetër, po përjetojnë një pasiguri të cilën po e vuajnë.

-Pra, nuk është më kusht hyrja ose jo e opozitës në zgjedhje për pjesëmarrja e LSI-së në zgjedhjet e 18 qershorit?

LSI ka milituar dhe milon që opozita të jetë pjesë e sistemit. Besoj që e ka mbështetur dhe e ka ndihmuar me shumë se çdo aktor tjetër politik me veprimin, me ofertën politike. Kam parasysh vënien në dispozicion të të gjitha mandateve të LSI-së në të gjitha nivelet, duke ofruar çdo sakrificë në të mirë të kësaj gjëje dhe mbi të gjitha me konstruktivitetin më të lartë. As retorika jonë, as gjuha jonë, nuk ka qenë as armiqësore, as provokative as kërcënuese ndaj opozitës.

Por ka qenë deri diku flirtuese. Ka zëra që thonë se opozita është në atë çadër edhe falë një lloj garancie që ka marrë më parë nga ana e LSI-së për kauzën e saj...

Po flasim gjithmonë për citimin e një analize serioze politike. Pjesa e asaj që ne kemi dispozicion në funksion të kompromisit, është në sytë e publikut. Përsa i takon një meskiniteti të kujtdo apo të një njëanshmërie të kujtdo, është pronar çdo meskin i meskinitetit të tij. Ne kemi në tavolinën e politikës vetëm një sinqeritet maksimal, madje edhe në rastin e çështjes së Presidentit. Ju e patë që Presidenti mori 87 vota në raundin e katërt, që mund t'i merrte që në raundin e parë nëse ne do të kishim një projekt të tillë dhe nuk kishim pse të humbnim kohë dhe mund të vazhdonim punët e tjera në politikë. Por edhe aty investuam maksimalisht për këtë çështje. Përse? Sepse e mira e ardhshme e Shqipërisë kërkon zgjedhje ku marrin pjesë edhe mazhoranca edhe opozita.

-Eksponentë të PS e kanë cilësuar tërheqjen në Kavajë si lojë shahu. Ju si e gjykonin?

Për mua politika nuk është lojë shahu. Ka që e shohin ashtu. Për mua nuk është e tillë.

politike

www.sot.com.al

Spartak Ngjela: Yee do nxjerrë PD nga çadra, kush ka abuzuar nuk i shpëton dot reformës në drejtësi

Avokat Spartak Ngjela ka folur dje mbi vizitën në Tiranë të z/ndihmës sekretarit amerikan të shtetit, Hoyt Brian Yee. Sipas tij, vizita e tij është një mesazh shumë i qartë për Lulzim Bashën dhe Partinë Demokratike. "E kuptoni ju që një Sali dhe një Lulzim nuk kanë fare peshë në llogarinë e politikës amerikane! Hoyt Brian Lee ishte ai që shkatërroi barbarinë e presidentit Ivanov në Shkup, dhe tani pas takimit, në Maqedoni, po shkon gjithçka drejt për shqiptarët. Amerikanët nuk

bisedojnë me barbarët e çadrave: kanë vetëm gjuhën e forcës ndaj tyre. Dhe kështu do të ndodhë edhe të hënën në Tiranë: gjithçka do të shkojë drejt për shqiptarët edhe në Tiranë: njëlloj si në Shkup", tha ai. Sipas Ngjelës, të korruptuarit e shtetit shqiptar janë të trembur dhe të bashkuar. Avokati deklaroi se ata do ndëshkohen nga reforma. "Të gjithë ata që zhurmojnë me fjalime të një gjuhe të paformuar si mendim, në Çadrën Sali, janë ata që kanë drejtuar dikur shtetin dhe tani janë të kapur dhe

pritur të ndëshkohen nga Reforma; por janë të trembur. A do të shkojnë në krim? E kanë të pamundur - janë përballë politikës aktive amerikane. Këta abuzues menduan se mund të sundonin me lojë gënjeshtresh, dhe vjedhjeje përgjithmonë në një vend të shpërfillur nga morali qytetar perëndimor në shekuj. Kanë njëzet vjet që gënjejnë mbi vuaqtjen dhe çoroditjen e shqiptarëve, këta të kapur që s'heqin dorë nga krimi", tha ai. Ngjela deklaroi se drejtuesit e PD nuk kanë shpëtim, ndërsa shtoi se edhe bojkoti nuk

do japë rezultat. "Të korruptuarit e Tiranës janë në shok mendor: nuk shpëtojnë dot, as me bojkot dhe as me protestë: janë të papranueshëm nga politika e lartë perëndimore, se janë të korruptuar dhe me psikologji barbare kundrejt popullit të vet. Janë të eliminuar. Koha nuk i pranon më, dhe do të shpronësohen që të gjithë; dhe me të drejtë. Ka gjithmonë një rregull strikt në historinë e shtetit modern: po nuk u ndëshkuan të korruptuarit, kurrë nuk vendoset moraliteti", tha ai.

■ ILDKP prezanton formularët e rinj për deklarimin e pasurisë

E gjithë politika në skaner për pasurinë, verifikim deri te krushqitë, ILDKP ndryshon procedurat e deklarimit

Kliti TOPALLI

Shtohet ankthi në radhët e politikanëve dhe zyrtarëve të lartë. Në zbatim të ndryshimeve në ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, ILDKP ka ndryshuar formularët që duhet të plotësohen nga zyrtarët. Sipas një vendimi të publikuar në Fletoren Zyrtare, çdo zyrtar duhet të deklarojë pasurinë para emërimit në detyrë, deklarim vjetor dhe pas largimit nga detyra. Por ajo që bie në sy është se këtë herë në skaner do kalojnë dhe krushqitë. Deri më tani deklarimet bëheshin vetëm për brenda familjes, pra bashkëshort, bashkëshorte dhe fëmijët. Në raste të caktuara dhe prindërit e deklaruesit, kur ishin pjesë e familjes së tij. Por sipas formularëve të rinj, politikanët do të duhet që të deklarojnë të ardhurat e babait, nënës, babait të bashkëshortit/es; bashkëjetuesit/es; nënës së bashkëshortit/es; bashkëjetuesit/es; të birit; bijës i/e ndarë nga prindërit; bashkëjetuesit/ bashkëjetueses. Pra duket se tani rrethi i verifikimeve do të zgjerohet. Ndërkohë sipas informacioneve, ILDKP ka nisur verifikimin e deklarimeve të bërë për vitin 2016 nga zyrtarët e lartë. Më 31 mars ishte afati i fundit dhe sipas burimeve aktualisht të gjitha deklaratat po skanohen dhe kontrollohen. Në rastet kur do shihet se ka pasuri që ngjall dyshime, atëherë do të ketë verifikime të repta nga ILDKP. Nga ana tjetër, aktualisht po punohet edhe për zbatimin e vetingut. Edhe pse politika ariti që të bllokohet zbatimin e ligjit, ILDKP po vijon me kontrollin e deklaratave në mënyrë që në vjeshtë kurt të ngrihen organet e vetingut gjithçka të jetë gati. Por duke filluar nga viti tjetër, duket se veting do ketë dhe për politikanët, të cilët do duhet të deklarojnë dhe pasuritë e të afërmeve të tyre.

Ndryshimet në ligj

Pak ditë më parë ndryshoi ligji për deklarimin e pasurisë. Në ligj janë bërë një sërë ndryshimesh të rëndësishme sidomos për njerëzit e drejtësisë. Janë futur disa dispozita ku përveç subjektit dhe familjarëve, duhet që të deklarohet dhe pasuria e kushërinjve. "Mbarin detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të interesave private: c) kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civil

DORËZIMI I DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATE

1. Të gjitha subjektet e ligjit dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarim, detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre, personalisht, në formë fizike, të mbyllur në zarf në strukturat përkatëse të institucioneve, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj për të gjithë llojet e deklarimit, ose me mjete të komunikimit elektronik të vëna në dispozicion nga Inspektorati i Lartë.
2. Nëse dorëzimi bëhet personalisht në strukturat përkatëse të institucioneve, pasqyrohet në një proces-verbal, që përfshin të dhënat për identifikimin e dek-

laratës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga nëpunësi dhe marrësi.

3. Deklarata e dërguar me mjete të komunikimit elektronik, vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e legjislacionit për nënshkrimin dhe dokumentin elektronik.
4. Subjektet të cilët nuk janë zyrtarë në momentin e dorëzimit të deklaratës, e dorëzojnë atë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas përcaktimeve të këtij neni, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj

Ndryshimet në nenin 17

Shkronja a) riformulohet: "Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme". Gjithashtu, në vazhdim të shtesës që u bë në nenin 34 të ligjit, lidhur me sanksionet ndaj punonjësve të ILDKPKI për publikimin e paautorizuar të të dhënave, në këtë nen shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

"d) Për shkelje të detyrimit të parashikuar në nenin 34, pika 3, të këtij ligji, personi përgjegjës dënohet me gjobë nga "200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë."

gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe familjarët e të afërmeve të tyre sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; d) kandidatët për prokuror, oficer hetimi, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit si dhe familjarët e afërme të tyre sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; e) kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; f) si dhe çdo person tjetër që ka detyrimin të deklarimit para kandidimit, sipas legjislacionit në fuqi.

nenin 34, pika 3, të këtij ligji, personi përgjegjës dënohet me gjobë nga "200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë", thuhet aty. Në nenin 1 të projektligjit janë bërë disa shtesa edhe të disa kategorive të tjera që duhet të deklarojnë, në përputhje me ligjet e reja të reformës në drejtësi.

Konkretisht kanë detyrim për të bërë deklarimin periodik të pasurisë edhe nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe personeli administrativ i Prokurorisë së Posaçme. Kjo shtesë është reflektuar në shkronjën "e" të nenit 3 të ligjit.

Zyrtarët që duhet të deklarojnë pasuritë

a) kandidatët që shprehin interesin për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon qeverisjen e sistemit të drejtësisë;

b) kandidatët që shprehin interesin për Inspektor të Lartë të Drejtësisë si dhe kandidatët jomagjistatë për pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon qeverisjen e sistemit të drejtësisë;

c) kandidatët për praninë në formimin fillestar të Shkollës së Magistraturës, si dhe i diplomuari që kandidon për t'u emëruar magjistrat, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

e) kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civil gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe familjarët e afërme të tyre sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

d) kandidatët për prokuror, oficer hetimi, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit si dhe familjarët e afërme të tyre sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

dh) kandidatët të cilët sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve kërkojnë ngritje në detyrë në shkallë më të larta ose të specializuara;

e) kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

e) Kandidatët për kryetarë të gjykatës ose prokurorive të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

f) si dhe çdo person tjetër që ka detyrimin të deklarimit para kandidimit, sipas legjislacionit në fuqi.

politike

Romana Vlahutin mbledh të gjithë krerët e ambasadave, diskutojnë për situatën në vend

Ambasadorja e Bashkimit Europian, Romana Vlahutin, ka mbledhur në zyrën e saj ambasadoret e BE në vendin tonë, në kuadër të krizës politike në vend. Faktori ndërkombëtar në vendin tonë është vënë përsëri në lëvizje për situatën politike në Shqipëri, për shkak të mos pjesëmarrje së opozitës në zgjedhjet e 18 qershorit. Ky takim vjen edhe pas mbërritjes së 7 kongresmenëve amerikanë për të negociuar që PD dhe opozita të bëhen pjesë e zgjedhjeve të 18

qershorit. Zyrtarët e lartë të BE janë shumë në lëvizje ditët e fundit për të bindur opozitën të futet në zgjedhje, por deri më tani Lulzim Basha e ka ndarë mendjen të çojë PD në humnerë. Lulzim Basha vijon të mbetet partizan i qeverisë teknike, kërkon të marrë pushtetin në tavolinë edhe pse PS në 2013 mori 1 milion vota për të larguar Sali Berishën. Tashmë, afatet ligjore për regjistrimin e partive politike për zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit dhe për ngritjen në

Kuvend të komisioneve të vetingut ka përfunduar. Por Bashkimi Europian i ka bërë thirrje më herët PD që t'i japë fund bojkotit të institucioneve dhe të marrë pjesë edhe në zgjedhje. Ka qenë zëdhënësja e Komisionit Europian, Maja Koçijanciq, e cila ka deklaruar se debati politik duhet të zhvillohet në Kuvend. "Që kur nisi bojkoti i opozitës ne shprehëm keqardhje, sepse besojmë se debati politik nuk duhet të mbahet jashtë, por brenda Parlamentit. Nga pikëpamja jonë bash-

këpunimi mes opozitës dhe qeverisë dhe dialogu mes tyre janë thelbësore edhe për ambiciet e vendit, që aspiron të anëtarësohet në Bashkimin Europian. Sigurisht që përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme janë një pjesë e rëndësishme e këtij procesi dhe ne e kemi ndjekur nga afër situatën. Ju thatë se sot është afati i fundit për regjistrimin, për ne është shumë e rëndësishme që të shohim të mbahen zgjedhje të lira, të ndershme dhe të përgatitura mirë", ka thënë ajo më herët.

■ Ish-kreu i SHISH komenton krizën politike në rajon

Shtetet e Ballkanit në krizë politike, Fatos Klosi: Skenar i qëllimshëm, ja çfarë pritet të ndodhë

Eneida JAJAJ

Situata në rajonin e Ballkanit është në një krizë totale, që rrezikon të tensionohet akoma edhe më shumë. Ballkani është futur në një hulli të pakthyeshme, nga e cila mund të përfitojnë shtete si Rusia, e cila prej kohësh kërkon të ushtrojë ndikimin e saj mbi këtë rajon. Demokracitë e brishta, ende të pakonsoliduara të vendeve të Ballkanit, që pasohen me kriza të ndryshme politike, rrezikojnë që të bëhen terren i butë për vendet armike. Shqipëria ndodhet në një krizë politike, pasi opozita nuk pranon të hyjë në zgjedhje edhe pas presionit ndërkombëtar; një situatë e tillë është edhe në Kosovë, ku koalicioni u prish dhe vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme; ndërkohë, situata akoma më e rëndë paraqitet në Maqedoni, e cila përveç krizës politike ka edhe krizën etnike. Gjithashtu, edhe Greqia dhe Mali i Zi gjenden në krizë, duke bërë që i gjithë rajoni të përfshihet në një situatë të zjarrtë, e cila kërkon pa diskutim zgjidhje. Ish-kreu i Shërbimit Informativ Shtetëror, Fatos Klosi, në një prononcim për gazetën "Sot", komenton situatën aktuale tensionuese në Ballkan. Ish-kreu i SHISH e ka një shpjegim për krizën në rajon. Fatos Klosi deklaroi se kjo situatë është e qëllimshme, në mënyrë që Europa të ndihmojë vendet me demokraci të brishtë dhe më pas të hapen negociatat për integrimin e tyre në Bashkimin Europian. "Mbase në këtë rast gjen vend shprehja e diktatorit të madh Mao Ce Dun: "Turbullo, turbullo që të kthjellohet". Kjo situatë tensionuese si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni po bëhet që Europa të interesohet më shumë për Ballkanin. Kjo po bëhet në mënyrë të qëllimshme që Europa të ndihmojë demokracitë e reja, të cilët nuk po e gjejnë me sa duket rrugën e demokracisë së vërtetë", deklaroi Klosi.

Kriza në Ballkan

Fatos Klosi u shpreh se Europa nuk mund të integrojë vende që ende nuk kanë zgjidhur problemet e tyre. Në mënyrë që këto vende të konsolidojnë demokracinë e tyre sa më parë, sipas Klosit, krijojnë sebepe që Europa t'i ndihmojë, dhe më pas

Mbase në këtë rast gjen vend shprehja e diktatorit të madh Mao Ce Dun: "Turbullo, turbullo që të kthjellohet". Kjo situatë tensionuese si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni po bëhet që Europa të interesohet më shumë për Ballkanin. Kjo po bëhet në mënyrë të qëllimshme që Europa të ndihmojë demokracitë e reja, të cilët nuk po e gjejnë me sa duket rrugën e demokracisë së vërtetë

TENSIONET MES GREKËVE DHE SHQIPTARËVE

Fatos Klosi ka deklaruar se Athina kurrë nuk ka qenë dashamirëse ndaj shqiptarëve dhe mediat greke sigurisht që do të shkruajnë kundër shqiptarëve. "Grekët nuk janë dashamirës me shqiptarët, për shkak të problemit çam. Mediat greke nuk i konsideroj të jenë objektive në këtë problem. Mediat greke e përkeqësojnë problemin me çamët, me vorio-epirin. Unë i quaj se nuk bëjnë pjesë në palën dashamirëse për shqiptarët. Ato do vazhdojnë avazin e tyre", u shpreh Klosi. Ish-kreu i SHISH thotë se maqedonasit nuk lejojnë që shqiptarët të jenë komb shtetformues, por shqiptarët nuk mund të konsiderohen thjesht një pakicë në Maqedoni, pasi përbëjnë 25 për qind të popullsisë, që nuk është pak.

integrimi i tyre në BE të jetë sa më i shpejtë. "Europa nuk mund të pranojë një herë për një herë vende që nuk kanë zgjidhur problemet e tyre. Kosova kërkon heqjen e vizave. Ata nuk e kanë në dorë këtë dhe krijojnë sebepe. Europa nuk po na lut neve, ne po i lutemi Europës që të na integrojë në BE. Por Europa nuk mund të pranojë vende që ende kanë nevojë për ndihmë. Janë bërë shumë protesta nga vendet e BE, se përse janë integruar vende që akoma nuk kanë zgjidhur problemet e tyre", u shpreh Klosi. Ai thotë se vendet e Ballkanit ende nuk janë në gjendje që të jenë të zotët e vetes, dhe kërkojnë ndihmë nga Europa dhe SHBA. "Ne nuk e zgjidhim problemin duke gjetur



SHKUPI S'BËN DOT PA SHQIPTARËT

Ish-kreu i SHISH, Fatos Klosi, ka theksuar më herët se dy partitë e mëdha maqedonase, nuk bëjnë dot pa shqiptarët. Ai tha se këtë herë shqiptarët po kërkojnë më shumë për të drejtat e tyre, dhe ka ardhur koha që të zbatohet Marrëveshja e Ohrit. "Shqiptarët kanë qenë në qeveri, kanë pasur poste ministrash,

armiq. Nëse i vendosim gishtin rusëve se e kanë fajin ata, nuk është ky problemi. Problemi është çfarë do bëjmë? Presioni që po bëhet në Shqipëri, unë e quaj pozitiv. Maqedonia përveç problemeve të mirëfillta që ka Shqipëria, ka edhe probleme etnike. Kosova ka problemin e kufijve. Edhe në Maqedoni duket se amerikanët kanë vënë dorë; edhe në Shqipëri

ministri i Brendshëm ka qenë shqiptar. Bëhet fjalë për ngritjen e statusit të popullit. Këtë radhë shqiptarët po kërkojnë pak më shumë, dhe mirë bëjnë. Po kërkojnë të paktën të zbatohet Marrëveshja e Ohrit. Të dyja partitë e mëdha maqedonase nuk bëjnë dot pa shqiptarët", u shpreh Klosi.

uroj që të vënë. Ne akoma kemi nevojë për një tutor, situata këtë tregon. Europa dhe Amerika duhet ta pranojnë se ne nuk jemi akoma të zotët vetë. Politikanët janë të udhëhequr më shumë ndaj interesave të tyre se sa të vendit. Kështu që unë do ta quaja një sebepe të gjithë këtë situatë të krijuar, që ndihma të jetë më e madhe", u shpreh Klosi.

Gjoshja: Ndhima e BE krijoi modele suksesi në familje

Ministrja e Integritimit Europian, Klajda Gjoshja, mori pjesë në Panairin për Programet e financuara nga Bashkimi Europian, i organizuar nga EU Info Center, në kuadër të javës së Europës. "Unë nuk do ndalem gjatë në shifra, por vlen të theksoj se asistencë e BE-së për Shqipërinë ka qenë e konsiderueshme me një total fondesh prej 595 milionë euro, për IPA I, e me një trend të dukshëm rritës për IPA II me një total prej 650 milionë euro", tha ministrja Gjoshja. Ministrja shprehu vlerësime për punën dhe kontributin e çmuar të të gjithë aktorëve të përfshirë. "Mbetemi të përkushtuar që të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjitha institucionet anëmbanë vendit, shoqërisë civile dhe organeve evropiane për të mirën e Shqipërisë dhe të axhendës së saj europiane", u shpreh ministrja. Ministrja Gjoshja theksoi se falë kësaj ndihme, shumë gra dhe vajza, të rinj e familje shqiptare janë bërë pjesë e projekteve duke parë jo vetëm një mundësi të re për një jetë më të mirë.

Totozani: Policia të marrë pjesë në zgjedhje

Avokati i Popullit, Iglitotozani, kërkoj të merren masat e nevojshme tekniko - organizative me qëllim zbatimin me korrektesë të detyrave ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe Udhëzimet e KQZ-së nga Policia e Shtetit gjatë procesit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë. "Të vazhdoj trajnimin me të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit që dot të marrin pjesë në shërbimet që do të organizohen në kuadrin e procesit zgjedhor me qëllim njohjen e tyre me detyrat dhe rolin e Policisë së Shtetit në këtë proces", është rekomandimi i dërguar nga Totozani, Drejtorit të Policisë së Shtetit, Haki Çako, për zbatimin me korrektesë të detyrave ligjore nga Policia e Shtetit gjatë procesit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë. Avokati i Popullit ndër të tjera rekomandon marrjen e masave të nevojshme tekniko - organizative me qëllim zbatimin me korrektesë të detyrave ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

politike

www.sot.com.al

Qeveria u hap rrugë privatëve, ja procedurat e reja për ngritjen e universiteteve

Qeveria ka përcaktuar procedurat dhe kriteret që duhet të përmbushë një subjekt juridik për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë, duke u hapur më tepër rrugë privatëve. Në bazë të ligjit "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", qeveria ka vendosur që subjekte juridike, vendase ose të huaja, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, duhet të depozitojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë ose degë të një institucioni ekzistues. Afati fundor i depozitimit është data 15 maj, për vitin e dytë pasardhës akademik. Por ky subjekt duhet të

përmbushë disa standarde, si: Standardet e organizimit të IAL-së; organi më i lartë akademik i IAL-së është Senati Akademik; organi më i lartë administrativ i IAL-së është Bordi i Administrimit; autoriteti më i lartë akademik i IAL-së është Rektori. Rektori është personel akademik me kohë të plotë; autoriteti më i lartë administrativ i IAL-së është administratori i saj; autoriteti më i lartë akademik i njësish kryesore është Dekani. Dekani është personel akademik me kohë të plotë; autoriteti më i lartë administrativ i njësish kryesore është administratori i saj; autoriteti më i lartë akademik i njësish bazë është drejtuesi i saj. Në vendimin e qeverisë thuhet se, një institucion i

arsimit të lartë organizohet në njësi përbërëse kryesore dhe bazë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë, duke respektuar llojin e institucionit. Ndërkohë, çdo njësi kryesore duhet të ketë, të paktën, tre njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respektive; njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik. Ndërsa një institucion i huaj i arsimit të lartë apo degë e tij, që zotëron një formë akreditimi në një shtet tjetër, mund të ketë organizim tjetër strukturor, në varësi

të formës në shtetin e origjinës. Subjekti i huaj duhet të plotësojë standardet për personelin akademik të IAL-së; standardin e raportit personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, është sipas shkronjës "A", të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi. Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi. Ndërkohë, standardet ndërtimore të IAL-ve duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për institucionet arsimore dhe ato të jenë të vendosura larg varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara, sipas standardeve përkatëse, etj.

Qeveria miraton vendimin për rritjen e numrit të policisë bashkiake

Vendimi i qeverisë, rritet numri i punonjësve të policisë bashkiake, numri më i lartë në Bashkinë e Tiranës

Eneida JAJAJ

Bashkitë në të gjithë vendin do të pësojnë ndryshime në strukturën organike të tyre. Kështu, numri i punonjësve të policisë bashkiake do të rritet. Në çdo bashki të vendit do ketë rritje të numrit të punonjësve të policisë bashkiake, që do t'i vijë në ndihmë shërbimit të pushtetit vendor. Qeveria miratoi dje vendimin "Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës", të ndryshuar. Numrin më të lartë të punonjësve të policisë bashkiake, do ta ketë Bashkia e Tiranës. Nga 300 punonjës të policisë bashkiake që ishin vitin e kaluar, Bashkisë së Tiranës do t'i shtohen edhe 73, pra numri në total do të shkojë 373 veta. Ndërsa numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave nga 1150 që ishte, do të bëhet 1 200 vetë, pra do të shtohet me 50 vetë. "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave vendosi: Në pikën 19, të kreut XXXIV, të lidhjes bashkëlidhur vendimit nr.313, datë 1.7.2002, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime: 1. Numri maksimal i punonjësve të policisë bashkiake, për Bashkinë e Tiranës, të bëhet 373 (treqind e shtatëdhjetë e tre) veta. 2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1 200 (një mijë e dyqind) veta. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare", thuhet në vendimin e qeverisë.

Ja si është ritur numri i punonjësve ndër vite

Vitin e kaluar numri i punonjësve të policisë bashkiake u bë 300 nga 240, që ka qenë më parë. Në strukturën e policisë bashkiake, sipas organigramës nuk përfshiheshin punonjësit e policisë ndërtimore, strukturë edhe kjo në varësi të pushtetit vendor. "Në mbështetje të nenit

RRITJA E NUMRIT TË PUNONJËSVE NGA VITI NË VIT

- Nga 300 punonjës të policisë bashkiake një vit më parë në Bashkinë e Tiranës, numri shkon në 373 veta.
- Nga 250 punonjës në Bashkinë e Tiranës në 2015, në 2016 shkoi në 300 numri i punonjësve.
- Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave nga 1150 që ishte, shkon në 1 200 vetë.
- Nga 1100 numri i punonjësve në bashkitë e vendit dhe komunave, shkoi në 1150.

Në çdo bashki dhe komunë të vendit do ketë rritje të numrit të punonjësve të policisë bashkiake, që do t'i vijë në ndihmë shërbimit të pushtetit vendor. Qeveria miratoi dje vendimin "Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës", të ndryshuar...



'Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës', i ndryshuar, Këshilli i Ministrave vendosi: Numri maksimal i punonjësve të policisë bashkiake, për Bashkinë e Tiranës, të bëhet 300 persona. Ndërsa numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1150 veta", thuhet në vendimin e miratuar nga Këshilli i Ministrave, një vit më parë. Para dy viteve, numri i punonjësve të policisë bashkiake ka qenë 200, nga të cilët 1 kryeinspektor, 26 inspektorë dhe 173 policë. Ndërsa vitin e kaluar, numri i stafit të

Punësimet ndër vite në Bashkinë e Tiranës

Në 2012-n, administrata bashkiake kishte 2893 punonjës në total, ndërsa në 2013-n, numri i punonjësve arrin në 3364. Pra një rritje me 471 persona, të cilët i kushtonin buxhetit të bashkisë, qytetarit të Tiranës rreth 3.7 milionë dollarë. "Kjo fryrje artificiale e administratës, qartazi është për

efekt elektoral, dhe e gjitha në shpinë të qytetarëve të Tiranës. Haptazi ju nuk mund të siguroni një shërbim më të mirë për qytetarët e Tiranës, kjo tashmë është e dukshme, madje e dokumentuar edhe në buxhetin që keni sjellë për miratim", sqaronin aso kohe këshilltarët opozitarë.

policisë bashkiake ishte 250 në total, nga të cilët 1 kryeinspektor, 30 inspektorë dhe 219 policë. Pra, vjet numri i punonjësve të policisë bashkiake u rrit me rreth 60

persona më shumë. Pra me kalimin e viteve kemi një rritje të vogël të numrit të punonjësve të policisë bashkiake në mbarë vendin.

Qeveria jep fonde për projektet e reja për rajonet

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për rishpërndarjen e fondeve, nga Ministria e Zhvillimit Urban në disa njësi të qeverisjes qendrore për financimin e projekteve të reja, të komitetit për zhvillimin e rajoneve. "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave vendosi: Fondet buxhetore, miratuar në buxhetin e vitit 2017 për Ministrinë e Zhvillimit Urban, në programin "Infrastruktura vendore dhe rajonale", rishpërndahen në disa institucione qendrore për financimin e projekteve të reja, të miratuara me vendimin nr.19, datë 12.4.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e financimit për fond për përgatitje projektsh (projektim), thirrja I për vitin 2017, të grantit 'Infrastruktura vendore dhe rajonale', Programi i Zhvillimit të Infrastruktura Vendore dhe Rajonale, shtylla I", sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij", thotë vendimi.

FA marrin pjesë në një mision trajnues në Afrikë

Forcat e Armatosura do marrin pjesë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian, me mision trajnues, në Republikën e Malit, në Afrikë. "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.103/2012, "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për krijimin e kuadrit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian", të nenit 7, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurave të vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", qeveria vendosi: 1. Në vendimin nr.400, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime: a) Në shkronjën "b", të pikës 1, data "1 qershor 2017" ndryshohet dhe bëhet "30 qershor 2018". b) Në pikën 3, data "1 qershor 2017" ndryshohet dhe bëhet "30 qershor 2018". 2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi", thuhet në vendim.

ekonomi

■ Ligji njih të drejtën për të dalë në pension para kohe, naftëtarëve të papunë të drejtën për punësim

Miratoohen rregullat për përfitimin e statusit të naftëtarit, ja si do të aplikojnë 5 mijë naftëtarët përfitues

Këshilli i Ministrave miratoi dhe procedurat që duhet të ndiqen nga afro 5 mijë naftëtarë që do të pajisen me statusin e naftëtarit. Me datë 2 shkurt 2017, Kuvendi miratoi ligjin "Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit", i cili ka hyrë në fuqi më datë 9 mars 2017. Sipas këtij ligji, qeveria kishte detyrimin që brenda 3 muajve të nxirrte aktet nënligjore që sigurojnë zbatimin faktik të tij. Konform ligjit për Statusin e Naftëtarit, qeveria miratoi dhe vendimin që përcakton rregullat se si do të përfitohet konkretisht ky status, se si do të vepohet për pajisjen e çdo naftëtarit ose ish naftëtarit me dëshminë përkatëse të qenies naftëtar.

Çfarë parashikon statusi

Ligji për Statusin e Naftëtarit është një ligj nga i cili përfitojnë rreth 5 mijë naftëtarë në të gjithë vendin. Statusi nuk ka në përmbajtje vetëm parashikimin për të drejtën e pensionit të par-

akohshëm të pleqërisë, por një sërë parashikimesh që shkojnë drejtpërdrejtë si përfitime në pagë, në pensione, në trajtimin e atyre që janë të papunë, në të drejtën për ripunësim, në të drejtën për kurim, si dhe në të drejtat mbi privatizimet dhe koncesionet. Ligji për Statusin e Naftëtarit u njih përfitime naftëtarëve që janë aktualisht në punë përse i takon të drejtës për të dalë në pension para kohe, naftëtarëve që janë të papunë, të cilëve u njihet përparësi në punësim dhe nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligj, edhe një pagesë sa 80% e pagës minimale në shkallë vendi. Ligji u njih përfitim edhe të gjithë atyre që kanë dalë në pension. Sipas viteve të vjetërsisë në punë, ata do të përfitojnë 1% deri në 40% shtesë në masën e pensionit që marrin aktualisht.

Aplikimi për statusin

Vendimi i qeverisë parashikon që të gjithë naftëtarët dhe ish naftëtarët për pajisjen me dëshmi zyrtare identifikuese

duhet t'i drejtohen me kërkesën përkatëse, ndërmarrjes ose institucionit ku kanë punuar, përkundrejt paraqitjes së dokumentit të njësuar të librezës së punës. Do jetë ndërmarrja, ajo që do të pajisë naftëtarin ose ish naftëtarin me vërtetimin e posaçëm zyrtar, në të cilin do të përcaktohen punët ose profesionet e kryera dhe kohëzgjatja e tyre. Vërtetimi i posaçëm do të dorëzohet në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, pranë një komisioni të përbërë nga përfaqësues të kësaj ministrie, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe Ministrisë së Financave. Komisioni, i cili do të bëjë edhe konfirmimin përfundimtar të statusit. Ndërkohë, ish naftëtarët që kanë dalë në pension, për të njëjtin qëllim do të duhet t'i drejtohen Degëve Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shëndetësore, ku është depozituar librezja e tyre e punës. Në rast se ndërmarrja ose institucioni nuk ekzistojnë më si institucione



për arsye të ndryshme, dëshmia do të lëshohet nga institucioni që mban arkivin me dokumentacionin përkatës. Vendimi i djeshëm i Këshillit të Ministrave bën dhe rregullime të tjera të rëndësishme lidhur me sqarimin e mëtejshëm të termave të përdorur në ligj, si,

për shembull, cili do të konsiderohet personeli teknik, apo si do të trajtohen punonjësit (naftëtarë ose ish naftëtarë) në marrëdhënie pune në shtete të tjera, kuptohet ato shtete me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje në fushën e mbrojtjes shoqërore.

Të gjithë naftëtarët dhe ish naftëtarët për pajisjen me dëshmi zyrtare identifikuese duhet t'i drejtohen me kërkesën përkatëse, ndërmarrjes ose institucionit ku kanë punuar, përkundrejt paraqitjes së dokumentit të njësuar të librezës së punës...

BERZH nuk e ndryshon parashikimin për ekonominë shqiptare në 2017

Ekonomia shqiptare do të rritet me rreth 3.5% në vitin 2017. Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim publikoi prospektin rajonal të ekonomisë për vendet ku operon. Sipas raportit, vendet e rajonit të Europës Juglindore gjatë vitit 2016 kanë pasur performanca të ndryshme ekonomike. Më e ndryshueshme ka qenë situata në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku Shqipëria dhe Kosova kanë pasur rritjen më të fortë dhe më të qëndrueshme, ndërsa me ritme të ulëta ka performuar ekonomia në Bosnje-Hercegovinë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Të gjitha ekonomitë e rajonit parashikohet të rriten në periudhën 2017-2018, por pasiguritë kryesore do të vazhdojnë të jenë prezente, të shoqëruara nga probleme të brendshme politike. Performanca ekonomike u përmirësua gjatë vitit 2016. Rritja ishte rreth 3.5% nga 2.6% që ishte në vitin 2015, duke u ndikuar nga konsumi privat dhe investimet. Shpenzimet publike u rritën në mënyrë të moderuar pas një tkurrjeje të ndjeshme në vitin paraardhës. Vlera neto



e eksporteve gjithashtu pati një kontribut pozitiv edhe pse të vogël veçanërisht në shërbime dhe turizëm. Investime të ndryshme në sektorin e energjisë janë duke u zbatuar, gjë e cila ndikon në rritjen ekonomike të vendit. Kompanitë shtetërore të sektorit të energjisë si KESH dhe OSHEE janë duke u nënshtruar reformës, gjë që do të garantojë rritjen e këtij sektori në terma afatgjatë. Politika fiskale e ndjekur nga qeveria ka qenë e kujdesshme, ndërsa në shkurt të këtij viti u mbyll edhe programi trevjeçar i FMN-së. Norma e inflacionit

ishte 1.3% në vitin 2016 nën targetin e Bankës së Shqipërisë që kuotohet në 3%. Politika monetare është e qëndrueshme dhe norma bazë është në nivelin më të ulët historik në 1.25% që nga maji 2016. Parashikimi në terma afatmesëm është pozitiv, por rreziqet e brendshme janë domethënëse. Rritja ekonomike parashikohet të jetë në 3.5% në vitin 2017, me rritje në 3.7% në 2018-n kjo për shkak të rritjes së kërkesës së brendshme dhe investimeve të huaja, kryesisht nga ndërtimi i gazsjellësit Trans-Adriatic Pipeline (TAP).

Skemat e mbështetjes në bujqësi 2017

APLIKO TANI!
Afatet e aplikimeve 02 - 31 Maj 2017

- Mbështetje për përmirësimin e teknologjisë së kultivimit dhe mbrojtjes së bimëve.
- Mbarështrim i blegtorisë, bletarisë dhe akuakulturës.
- Furnizim i qëndrueshëm i tregut dhe rritja e të ardhurave financiare për familjet e zonave rurale.
- Nxitja e investimeve në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, shpendëve, bletarisë, akuakulturës dhe bimëve medicinale.

Për informacione të mëtejshme AZHBR:
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", Nr. 56, Tiranë.
Tel: +355 422283 18, Website: www.azhbr.gov.al
ose pranë Drejtorive të Bujqësisë në Qarqe

VETËVENDOSJA PËRSHËNDET RRËZIMIN E QEVERISË: PO VJEN NDRYSHIMI

Partia opozitare që ka protestuar me më shumë zë kundër politikave të qeverisë së rrëzuar të Kosovës, Vetëvendosje tha dje se mirëpret ndryshimin në politikën e vendit. "Nuk dot të na marra malli për qeverinë e rrëzuar. Tashmë është koha e ndryshimit dhe e pushtetit të Vetëvendosjes. Ne kemi kryer kontakte me shumë subjekte politike dhe po shqyrtojmë se cilët mund të jenë partnerët tanë. Po të vazhdonim me këtë përbërje qeveria do të rritej kostoja politike e PDK për zgjedhjet e ardhshme. AAK dhe NISMA paraqitën mocionin e mosbesimit kur kuptuan se kishin numrat për ta fituar dhe ne e mbështetën mocionin. Do të ishte hipokrite të mos mbështetjet rrëzimin e qeverisë së Isa Mustafës. Kjo ishte në interes të të gjithë qytetarëve", tha kreu i grupit parlamentar, Glauk Konjufca.



HARADINAJ: QEVERIA E RE DO NDRYSHOJË VERSIONIN E DEMARKACIONIT

Udhëheqësi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, tha dje në një konferencë për shtyp pas humbjes së mocionit nga qeveria, se qytetarët duhet t'i gjykojnë me votë kandidatët e qeverisë së rrëzuar, për dështimet e tyre. Ai tha se ndihet mirë që ka pasur një reflektim të deputetëve në pushtet për rrëzimin e qeverisë PDK dhe LDK, dhe shtoi se për koalicionin e ardhshme, partia e tij do të caktojë "vija të kuqe" për lidhjet me dy forcat kryesore të kabinetit të fundit. "Nëse në pushtet vjen qeveria e opozitës AAK do të caktojme linja të qarta për bashkëpunim me PDK dhe LDK. Një prej tyre është rrëzimi i versionit aktual të Demarkacionit kufitar me Malin e Zi, dhe sjellja e versionit të drejtë", tha Haradinaj.



■ BE keqardhje me rrëzimin e qeverisë, opozita dhe PDK mirëpresin mundësinë e re

Kosova në zgjedhje të parakohshme, parlamenti rrëzon qeverinë e Isa Mustafës

Andi LAMKO

Deputetët e Kosovës votuan dje rrëzimin e qeverisë së kryeministrit Isa Mustafa në mocionin e mosbesimit të opozitës, duke çuar vendin në zgjedhje të parakohshme muajin që vjen. Shtatëdhjetë deputetë të parlamentit 120-vendësh votuan për rrëzimin e kabinetit, të cilin opozita prej kohësh akuzon për dështim në premtimet e fushatës dhe rritje të mosbesimit publik. 34 deputetë votuan kundër dhe 3 abstenuan. Pas votës, presidenti Hashim Thaçi shpërndau parlamentin, dhe sipas kushtetutës zgjedhjet e reja duhet të mbahen brenda 45 ditëve. Valdeta Bajrami, e partisë opozitare NISMA, e cila qe iniciatore e mocionit tha se vendi ka nevojë për një drejtim të ri. Megjithë presionin e ushtruar nga BE dhe SHBA për miratimin e shpejtë të ligjit të demarkacionit kufitar me Malin e Zi, situata e re do të vonojë edhe më shumë kalimin e kushtit të rëndësishëm për heqjen e regjimit të vizave të qytetarëve të Kosovës.

BE e zhgënjyer

Zhvillimi gjithashtu pezullon përkohësisht procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë të sponsorizuar nga BE, një tjetër kusht i rëndësishëm për avancimin e procesit të integritetit të dy vendeve në Bashkimin Evropian. "Shohim me keqardhje votën e mosbesimit në parlamentin e Kosovës. Liderët politikë nuk duhet të humbasin vëmendjen ndaj sfidave të mëdha me të cilat vendi përballet", ishte komenti i komisionarit evropian të zgjerimit Johannes Hahn. Para votës kryeminis-



tri Mustafa tha se në qeverinë e tij nuk kishte të korruptuar, ndërsa mocionin e opozitës e quajti një pamflet politik i pabazuar në argumenta. "Kjo mund të ketë pasoja të rënda në destabilizimin e vendit, me anë të rritjes së mosbesimit të institucionet dhe të vakumit politik", tha kryeministri i LDK.

Prishja e koalicionit

Por megjithë paralajmërimin e tij vota e djeshme solli prishjen e koalicionit afro 3-vjeçar me ish-partinë e Thaçit, PDK, tashmë e drejtuar nga kreu i parlamentit Kadri Veseli. Mocioni i djeshëm i dha fund qeverisë së krijuar si rezultat i krizës pas zgjedhore të vitit 2014, pas 6 muajve

bllokimi institucional. LDK dhe PDK, për herë të dytë qeverisën normalisht së bashku Kosovën e pasluftës deri në vitin 2016, kur Thaçi u zgjodh president. Me ardhjen e Kadri Veselit në krye të PDK-së, situata ndryshoi teksa gjithnjë e më shumë përvijojë rruga drejt zgjedhjeve të parakohshme, pas krizave institucionale dhe kritikave të opozitës. Në 18 muajt e fundit, puna e parlamentit u ndërpre disa herë nga incidente si trazira me demonstruesit, deputetë opozitarë që lëshojnë gaz lotsjellës në sallë dhe atentat me granatë ndaj ndërtesës së ligjvënies. Lidhja Demokratike e Kosovës e kryeministrit Isa Mustafa,

Veseli: Është koha për një udhëheqje të re

Kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, pas rrëzimit të Qeverisë u është drejtuar qytetarëve për të treguar arsyet e prishjes së koalicionit me LDK dhe rrëzimin e kryeministrit Isa Mustafa. Ai theksoi se LDK dhe qytetarët e Kosovës kanë humbur besimin në udhëheqjen e Isa Mustafës dhe kjo është arsyeja pse vendi po shkon në zgjedhje të reja. "Kjo qeveri nuk e ka çuar vendin tonë në ritmin e duhur. Zhvillimi ekonomik ka ngecur, krijimi i vendeve të punës ka ngecur. Si partner i koalicionit për të këto vite jam përpjekur t'i jap përkrahje të plotë kryeministrit Isa Mustafa për të lëvizur axhendën e integritetit euroatlantik, por kjo nuk ka ndodhur. Ka njerëz që padyshim nuk mund të ndërtojnë një Kosovë të re, sepse u mungon guximi për të marrë vendime dhe u mungon ndjenja e përgjegjësisë shtetërore, por ka edhe nga që duan ta shembin Kosovën që e kemi ndërtuar së bashku me shumë mund e sakrificë, të cilët nuk duhet t'i lejojmë kurrë të fitojnë", tha Veseli.

ishte partia e dytë në parlament, dhe qeveria me Partinë Demokratike të Kadri Veselit u formua në orët e fundit të krizës qeveritare pas zgjedhjeve të 2014. PDK ka numrin më të madh të deputetëve, dhe kreu Veseli u shpreh dje se zgjedhjet e reja do të jenë një fillim i ri për Kosovën. "Ndërimi i qeverisë hap kapituj të rinj emocionues për historinë e vendit tonë", tha ai.

Gjermania u jep azil politik ushtarakëve turq

Disa ushtarakë turq dhe familjet e tyre, të stacionuar me njësitë e NATO-s në Gjermani, kanë fituar azil politik, njoftonin mediat gjermane, në lajmin që thuhet se është konfirmuar dhe nga ministria e mbrojtjes. Ushtarakët e lartë turq raportohet të zotërojnë pasaporta diplomatike dhe kanë kërkuar azil prej fushatës së shtypjes pas grushtit të dështuar të shtetit. Ministria gjermane e mbrojtjes ka thënë se 262 aplikime kanë ardhur nga zotërues të pasaportave diplomatike.

Presidenti i ri i Koresë së Jugut: Dialog me Veriun

Presidenti i ri i Koresë së Jugut, Moon Jae-in bëri dje betimin duke u zotuar të trajtojë problemet ekonomike dhe marrëdhëniet me Korenë e Veriut, dhe pranoi se mund të vizitojë Penianin nën rrethanat e duhura. Ish-avokati i të drejtave të njeriut dhe bir i refugjatëve nga Korea e Veriut, njihet për pikëpamjet e tij liberale. "Do të bëj çdo gjë të mundur për të sjellë paqen në gadishullin e Koresë. Do të fluturoj menjëherë drejt Washington-it, e më pas drejt Pekinit, Tokios dhe gjithashtu në Penianin nën rrethanat e duhura", tha ai.

Turqia: Armatosja e kurdëve nga SHBA, me pasoja

Kryeministri turk Binali Yildirim tha dje se vendimi i Shteteve të Bashkuara për armatosjen e militantëve kurdë YPG që luftojnë Shtetin Islamik mund të ketë pasoja negative për vetë Washington-in. "Administrata e SHBA i ka shanset të mendojë për opinionin e Turqisë në lidhje me Partinë Punëtorë Kurde (PKK). Nëse dot të ketë tjetër vendim, kjo sigurisht do të ketë pasoja negative për vetë SHBA", tha Yildirim. PKK konsiderohet si grup terrorist nga SHBA, Turqia dhe BE.

Rrëzimi i qeverisë, ambasada SHBA: Kuvendi tha fjalën e vet

Pas rrëzimit të qeverisë së Kosovës ka reaguar Ambasada Amerikane në Prishtinë, duke thënë se të zgjedhurit e popullit thanë fjalën e tyre. "Kuvendi e tha fjalën e vet. Përdërisa vazhdon procesi i tranzicionit dhe vendi lëviz në drejtim të zgjedhjeve të parakohshme, ftojme të gjithë zyrtarët e mbetur në Qeveri që të zotohen përsëri në shërbim të punëdhënësve të tyre, gjegjësisht të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim", thuhet në reagimin e Ambasadës Amerikane, e cila gjithsesi vazhdon-

te me mbështetjen e saj për Kosovën, edhe pas tentativave të shumta një ditë më parë, për kalimin e ligjit të Demarkacionit me Malin e Zi para votimit të mocionit të opozitës. "Ne vazhdojmë të jemi të palëkundur në mbështetjen tonë për Kosovën, qytetarët e saj dhe rrugëtimin të saj drejt integritetit të plotë Euro-Atlantik", përfundon reagimi. Të martën ambasadori amerikan Greg Delawie ishte takuar me të gjithë liderët politikë të Kosovës për t'i bindur në kalimin e shpejtë të Demarkacionit.

Donald Trump shkarkon shefin e FBI, James Comey

Presidenti amerikan Donald Trump ka shkarkuar dje nga detyra kreun e FBI në lidhje me hetimet mbi email-et demokratike Hillary Clinton, njoftoi administrata. Shtëpia e Bardhë tha se Comey ishte shkarkuar nga posti për keqmenaxhim të hetimeve, ndërsa nga kampi demokrat pretendonin se shkarkimi i tij erdhi sepse hetimet kishin zbuluar lidhje mes fushatës republikane të Trump dhe Rusisë. Lëvizja vjen pas zbulimeve se deklarata e Comey javën e kaluar në komi-

sionin e hetimeve të Kongresit mbi shkeljet e protokollit të Hillary Clinton, kishte pasaktësi. Administrata tha se kërkimi për pasuesin e Comey do të nisë menjëherë, ndërsa Trump komentoi dje se ai do të zëvendësohej nga "dikush që do të bëjë një punë shumë më të mirë, dhe që do të risjellë në vend prestigjin e humbur të FBI". Shumë shprehën habi me shkarkimin e Comey për hetimet mbi email-et e Clinton, duke marrë parasysh se më parë Trump e ka vlerësuar më parë punën e kreut të FBI.

Itali, prokuroria heton grupet mesdhetare të ndihmave

Një prokuror italian tha dje se po kryhen hetime mbi grupet që po ndihmojnë në shpëtimin e emigrantëve dhe kalimin e tyre në Itali nga Libia, në lidhje me asistimin e emigracionit të paligjshëm. Prokurori i Trapani, Ambrogio Cartosio tha se nuk po hetoheshin grupet e ndihmës, por individët të caktuar që punonin për to, për lidhje me trafikantët libianë. Dëshmia e tij në komitetin e mbrojtjes së Senatit të Italisë ishte dëshmia e fundit për dyshimet se grupet e bamirësisë

në Mesdhe po ndihmojnë trafikantët libianë me kalimin e barkave të tejmbushura të emigrantëve të Mesdheut drejt Italisë. Grupet kanë mohuar akuzat dhe kritikojnë prokurorët për përhapjen e fjalëve pa prova. Cartosio tha se emigrantët e ardhur në Trapani raportuan se roja bregdetare e Libisë kishte kërkuar rryshfet nga trafikantët për vazhdimin e lundrimit të tyre drejt veriut. Roja bregdetare libiane kohët e fundit është përfshirë në taks-force-n e BE për reduktimin e fluksit të trafikut.

kronikë

Altin Kodra humbi jetën pas përlëshjes me thikë me Vladimir Lulin

Sherr mes të rinjve në Kamëz, 28-vjeçari vret me thikë bashkëmoshatarin

Ermal VIJA

Një 27-vjeçar u vra me thikë nga një bashkëmoshatari i tij në fshatin Çekrezë të Kamzës, pas një konflikti për motive të dobëta. Burime zyrtare policore njoftuan ditën e djeshme se Altin Kodra, 27 vjeç, banues në fshatin Çekrezë, u përlësh fillimisht fizikisht me 28-vjeçarin Vladimir Luli dhe më pas ky i fundit e qëlloi disa herë me thikë në bark, duke e lënë të plagosur rëndë. Të njëjtat burime konfirmojnë se nga ky konflikt mbeti po ashtu i plagosur edhe 28-vjeçari Luli, pasi mori disa goditje me sende të forta në trup. Të dy personat u dërguan me urgjencë në ambientet e Spitalit të Traumës në Tiranë, për ndihmë mjekësore, por Kodra nuk mundi të mbi- jetonte dot plagëve të marra pasi humbi jetën. Mësohet se, ngjarja e rëndë ndodhi kur Vladimir Luli ishte duke rregulluar një tub uji, pranë banesës së tij në fshat, ndërsa është konfliktuar me të vrarin Kodra. Ende nuk dihet motivi i krimit, por burime pranë uniformave blu të kryeqytetit bëjnë me dije se dyshohet që shkak për grindjen është bërë një konflikt i vjetër që ka qenë mes palëve për motive ende të panjohura. Pas veprimeve të para, policia arrestoi në flagrancë Vladimir Lulin, të dyshuar si autor të krimit. Ai akuzohet për vrasje me dashje, ndërsa arma e krimit u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Ndërkohë është shoqëruar dhe është marrë në pyetje kryeplaku i fshatit Çekrezë, dëshmia e të cilit pritet të zbardhë arsyet e konfliktit mes të rinjve që përfundoi me një të vrarë. Janë të njëjtat burime që bëjnë me dije se, janë shoqëruar dhe po merren në pyetje edhe të afërm të peronave të përshtirë në konflikt për të sqaruar nëse kanë patur dijeni për konfliktin mes dy të rinjve. Sakaq materialet e



mblendhura në ngarkim të të arrestuarit i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për veprime të mëtejshme. Tashmë mbi 27-vjeçarin rëndon akuza për veprën penale "Vrasje me dashje".

Policia

Policia e Tiranës nëpërmjet një njoftimi për shtyp bëri me dije se, ditën e djeshme 27-vjeçari Altin kodra u vra me thikë pas një përlëshjeje që ndodhi në fshatin Çekrezë të Kamzës, pas një konflikti për motive të dobëta me një 28-vjeçar. Menjëherë pas ngjarjes, autori u shoqëruar në spital për të marrë ndihmën e parë mjekësore pasi ngeli i plagosur nga konflikti dhe më pas u arrestua nga policia. "Më datë 10.05.2017, rreth orës 11:55 minuta, në Çekrezë, ka patur një konflikt midis dy shtetasve, ku për pasojë ka mbetur i plagosur shtetasi Altin Kodra, 27 vjeç, në pjesën e barkut dhe u dërgua në spitalin e Traumës në kryeqytet, për ndihmë mjekësore, por ka gjetur vdekjen si pasojë e plagëve të marra. Pas marrjes së këtij informacioni, shërbimet e poli-

Ngjarja e rëndë ndodhi kur Vladimir Luli ishte duke rregulluar një tub uji, pranë banesës së tij në fshat, ndërsa është konfliktuar me të vrarin Kodra. Ende nuk dihet motivi i krimit, por burime pranë uniformave blu të kryeqytetit bëjnë me dije se dyshohet që shkak për grindjen është bërë një konflikt i vjetër që ka qenë mes palëve...

cisë së komisariatit të policisë Nr 5, kanë bërë të mundur kapjen në flagrancë të shtetasit Vladimir Luli. Specialistët e krimeve ndaj jetës në Drejtorinë Vendore Tiranë, po punojnë ende për sqarimin e

plotë të rrethanave të kësaj ngjarje. Në vendin e ngjarjes është gjendur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, një mjet prerës thikë, e përdorur nga autori", mbyllet njoftimi i policisë.

Shtyhet gjyqi ndaj Shullazit, seanca më 23 maj

Gjykata e Krimeve të Rënda ka shtyrë për në 23 maj seancën e ardhshme për Emiljano Shullazin, pasi avokati mbrojtës i Galmando Danit kërkoi të njihet me provat e prokurorisë. Gjykata e Krimeve të Rënda kërkoi që aktet t'i vihen në dispozicion avokatit të Blerim Shullazit. Emiljano Shullazi ka dalë dje para togave të zeza ku nisi dhe seancën e parë gjyqësore ndaj tij, ndërsa akuzohet si kreu i një grupi kriminal për gjobëvënie. Pas shumë mungesash në sallat e gjyqit edhe kur ishin seancat ballafaqese me biznesmenin Ylvi Beqaj, me pretendimin se ishte i sëmurë, Shullazi është paraqitur në seancën. Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endri Qyqja, Endri Zela dhe Blerim Shullazi ishin të pranishëm në seancën e parë gjyqësore. Prokuroria e Krimeve të Rënda i akuzon ata për kanosje për shkak të detyrës kundër pedagogëve Dhori Kule dhe Mynyr Koni, gjobëvënie në tre episode, ndërkohë që Emiljano Shullazi shikohet nga akuza si njeriu që formoi grupin dhe ndau rolet në atë që Krimet e Rënda e konsiderojnë si grup kriminal.

Kapen me 19 kg kanabis, 2 të arrestuar në Korçë

Policia e Korçës ka sekuestruar një sasi prej 19 kilogramë kanabis sativa, ndërsa në pranga janë vënë dy persona pasi sasi e kanabisit është gjetur pranë banesave të këtyre të fundit. Burime zyrtare policore njoftuan ditën e djeshme se, lënda narkotike u gjet pas kontrollit të ushtruar në afërsi të banesave të Elidon Zeqos, 24 vjeç dhe Alban Manes, 36 vjeç të dy banues në Korçë. Janë të njëjtat burime që konfirmojnë se, pas kontrollit të ushtruar në afërsi të shtëpive të tyre nga ana e specialistëve të anti-drogës në drejtorinë vendorë të policisë Korçë, në lagjen numër 6 të qytetit juglindor, 36-vjeçarit Mane iu gjetën 16.7 kilogramë kanabis, ndërsa sasia tjetër prej 2.2 kilogramë kanabis iu gjet 24-vjeçarit Zeqo. Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për veprime të mëtejshme. Tashmë mbi të arrestuarit rëndon akuza për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Përlëshje me armë në Shkozë, plagose 31 vjeçari

Dy persona janë përlëshur me armë dhe sende të forte në Shkozë të Tiranës, ku për pasojë një 31-vjeçar ka mbetur i plagosur dhe një tjetër është arrestuar. Sipas policisë, Pal Prenga, 27 vjeç, banues në Tiranë u arrestua, ndërsa është vënë nën hetim shtetasi me inicialet D.M., 31 vjeç, banues në Tiranë. Ata akuzohen se pasditën e së martës, tek banesat sociale, në Shkozë, gjatë një konflikti, janë goditur fizikisht me njëri-tjetrin, ku Pal Prenga e ka kanosur për jetën me të bërtitura dhe një armë tip "Shotgun". Ndërkohë 31-vjeçari me inicialet D.M., i është kundërpërgjigjur me një levë hekuri në dorë. Paraprakisht dyshohet se gjithçka ka nisur pas një debati me fjalë për motive të dobëta, ndërkohë që për të zbardhur më shumë rreth ngjarjes hetimet janë në vijim. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan arma, pesë fishekë dhe leva e hekurit. Në lidhje me këtë rast materialet e mblendhura iu kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për veprime të mëtejshme.

Vrau gruan me çifte në Shkodër, 74-vjeçari mohon akuzat, gjykata e lë në burg

Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë masën e sigurisë "Arrest me burg" për Beqir Xhilaj, i cili tre ditë më parë vrau bashkëshorten e tij. Ditën e djeshme përballë togave të zeza, Xhilaj ka pretenduar se nuk është ai autori i vrasjes së bashkëshortes së tij 47-vjeçare. I moshuari mohoi krimin dhe deklaroi se është me një dorë dhe se nuk e kryente dot vrasjen me çifte. Ndër të tjera ka deklaruar se, në momentin kur dëgjoji të shtënat ishte në banesë bashkë me djalin e viktimës. Por pavarësisht këtyre pretendimeve ndaj tij u caktua masa e sigurisë "arrest me burg" deri në përfundim të hetimeve për vrasjen e Lumturie Xhilajt, 3 ditë më parë në

Shkodër. "E nderuar gjyqtare, unë jam me një krah më mungon dora e djathtë dhe të doja s'e vrisja dot me çifte gruan. Ajo vrau veten dhe në këtë moment unë po pija kafe me djalin e bashkëshortes i cili është fryt i një martesë e mëparshme. Më pas njoftova menjëherë policinë për ngjarjen e rëndë", u shpreh përballë gjykatës 74-vjeçari. Më tej ai sqaroi se gjithçka ka nisur teksa bashkëshortja i ka bërë gati kafetë që pinin çdo mëngjes dhe në ato momente ata kanë shkëmbyer një debat mes tyre. Sipas 74-vjeçari, bashkëshortja pas sherrit që ka pasur me të ka marrë armën dhe e ka shprehur ndaj vetes. 74-vjeçari akuzohet për vrasjen e bashkëshortes, Lumturie Xhilaj

45-vjeçe. Xhilaj u arrestua më 8 Maj nga policia e Shkodrës ku pas një telefonate në polici ai njoftoi se e shoqja kish vrarë veten. Për të provuar vrasjen nga Beqir Xhilaj prokurori Behar Dibra ka kërkuar kryerjen e dy akt ekspertimeve një për aftësinë mendore të 74-vjeçarit dhe një për aftësitë e qitjes me dorën e majtë nga Beqir Xhilaj. Nga ana tjetër sipas prokurorisë, i moshuari është autor i vrasjes së Lumturie Xhilajt me të cilën kishte 10 vite martesë. Shkak për krimin dyshohet se janë bërë konfliktet e vazhdueshme që ata kishin me njëri-tjetrin. 74-vjeçari ka qenë i dyshuar edhe për vrasjen e gruas së tij të dytë pasi gjithsej është martuar tre herë.



kronikë

www.sot.com.al

■ Gjykata dënon me shërbim prove policët privatë

Lirohen 6 policët privatë që shoqëronin 3.2 milionë USD që u grabitën në Qafë-Kashar

Ermal VIJA

Gjykata e Tiranës vendosi para ditën e së mërkurës lirimin e të gjithë policëve privatë të arrestuar pas grabitjes së mbi 3.2 milionë dollarëve në rrugën Qafë-Kashar-Rinas, më 9 shkurt të këtij viti. Gjykata e Tiranës ka dhënë dënimin me shërbim prove për gjashtë policët privatë të cilët shoqëronin paratë e një banke të nivelit të dytë. Ditën e djeshme Fatmir Gabi, përgjegjësi i grupit të shoqërimit të parave, u dënua me 2 vite burg, Xhelil Metaj me 10 muaj burg, Dashamir Balla me një vit, Endrit Doçi me 1 vit burg, Përparim Logu me 8 muaj burg dhe Gentian Deda me një vit burg. Por trupa gjyquese e kryesuar nga gjyqtari Ardian Kalia vendosi që të pezullonte vuajtjen e dënimit me burgim, duke vendosur liri me kusht dhe mbajtje e kontakteve me shërbimin e provës për 6 të pandehurit. Më datë 9 shkurt rreth orës 12:00, dy automjete të blinduara të Sh. P.S.F "Jaguar" security u nisën nga Tirana së bashku me punonjësit e policisë private, për në drejtim të aeroportit të Rinasit. Makinat e blinduara, pasi kanë dalë nga qyteti, janë futur në rrugën e Rinasit. Në mes të makinave të blinduara, është futur një mjet fuoristradë, e cila fillimisht i ka bllokuar rrugën makinës shoqëruese dhe më pas ka dalë pas saj. Në këtë moment, nga një rrugë dytësore, ka dalë një tjetër mjet tip fuoristradë që ka goditur makinën e blinduar, duke e ndaluar atë, ku më tej ka ndodhur grabitja. Autorët morën 3.2 milionë dollarë, përveç 6 punonjësve të policisë private, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka të arrestuar edhe 8 persona të tjerë të dyshuar si autorë të grabitjes.

Hetimet

Në sajë të hetimeve të prokurorisë ka rezultuar se grabitësit vepronin si një grup i strukturuar kriminal dhe për



këtë, çështja i ka kaluar Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Më herët, Prokuroria e Tiranës ka treguar rrugën që iu desh të ndiqte për identifikimin e grabitjes së parave të bankave dhe arrestimin e 8 personave. Gjithçka nisi në dhjetor të 2015, ku në bazë të një hetimi të nisur, janë krijuar dyshimet se Fatjon Xhyliu, Ditjon Memlika, Neim Avdyli, Ernest Kupa, Admir Çerpja, Dash Kupa, Aleksandër Murataj dhe Dritan Sinani kanë lidhje me vjedhjen me armë të një shume të konsiderueshme parash të një banke të nivelit, të cilat po transportoheshin nëpërmjet automjeteve të një kompanie private për në aeroportin e Rinasit. Kjo ngjarje ka ndodhur në datë 03.12.2015. Në sajë të një informacioni të siguruar nga policia në vjeshtën e vitit 2016, Fatjon Xhyliu, ish-punonjës i kompanisë "Rogat Security" kishte marrë përsipër transportin e parave që u vodhën në Dhjetor 2015. Ai kishte shpenzuar shuma të konsiderueshme parash, për të

Ditën e djeshme, Fatmir Gabi, përgjegjësi i grupit të shoqërimit të parave, u dënua me 2 vite burg, Xhelil Metaj me 10 muaj burg, Dashamir Balla me një vit, Endrit Doçi me 1 vit burg, Përparim Logu me 8 muaj burg dhe Gentian Deda me një vit burg. Por trupa gjyquese e kryesuar nga gjyqtari Ardian Kalia vendosi që të pezullonte vuajtjen e dënimit me burgim....

cilat nuk kishte mundësi reale për t'i krijuar nga burime të ligjshme, dhe për këtë nisi një hetim. Më 12 shkurt të këtij viti, prokuroria urdhëroi ndalimin e tij, si person nën hetim për veprimet penale të "Vjedhjes me armë" për ngjar-

jen e vitit 2015. Pas ndalimit të tij, në bazë të hetimeve të kryera, janë identifikuar edhe disa persona të tjerë, të cilët mund të jenë përfshirë në vjedhjen me armë të vitit 2015 dhe atë të 9 shkurtit ku u morën 3.2 milionë dollarë.

Durrës, vetëvritet me armën e shërbimit policia 23 vjeçare

Një inspektore policie i ka dhënë fund jetës saj me armën e shërbimit. Ngjarja e rëndë ka ndodhur paraditen e djeshme në banesën e saj që ndodhet në Katund Sukth, ku shtetasja P. Shahini, 23 vjeçe, është gjetur e pajetë nga të afërmit. Ditën e djeshme policia njoftoi zyrtarisht se, 23-vjeçarja Shahini ka vrarë veten me armën e shërbimit. Mësohet se, ngjarja ka ndodhur në katund Sukth, ndërsa policia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe ka nisur hetimet. Kanë qenë familjarët që kanë rëndur drejt katit të dytë të banesës pasi kanë dëgjuar të shtënat dhe vajzën e kanë gjetur ende gjallë por pavarësisht përpjekjeve për ta mbajtur në jetë nuk ia kanë dalë. Në lidhje me këtë rast, grupi hetimor i ngritur në vendngjarje nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës po kryen veprimet e mëtejshme procedurale për sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe shkaqet që e detyruan të renë të ndërmarrë këtë akt fatal për jetën.

Zetori përplasjet me mortin në Lushnjë, vdes 34-vjeçari

Një person humbi jetën, ndërsa një tjetër ka mbetur i plagosur në një aksident rrugor që u regjistrua rreth orës 17:10 të pasdites së djeshme në Lushnjë. Burime zyrtare policore njoftuan ditën e djeshme se, ngjarja ka ndodhur në aksin rrugor Divjakë-Çermë, në fshatin Shën e Premte, ku një mjet zetor është përplasur me një motor. Si pasojë e përplasjes janë plagosur të dy drejtuesit e mjeteve. Ata janë dërguar me urgjencë në spitalin e Leshnjës për mjekim por si pasojë e plagëve të marra drejtuesi i mjetit zetor, shtetasi me inicialet A. A., 34 vjeç, banues në fshatin Çermë, ka ndërruar jetë në orën 18:55 në reanimacionin e spitalit Lushnjë. Janë të njëjtat burime që konfirmojnë se, drejtuesi i mjetit motor, shtetasi me inicialet I. T., 31 vjeç, banues në fshatin Shën e Premte, ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve, por fatmirësisht jashtë rrezikut për jetën. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e shkakut të aksidentit.

Kapen me 9 kg kanabis në Gjermani, arrestohen 7 shqiptarë

Policia gjermane ka vënë në pranga shtatë shqiptarë pasi janë kapur me një sasi prej 9 kilogramë kanabis sativa. Sipas mediave gjermane mësohet se, pas hetimeve një muajore, policia gjermane ka çuar në pranga shtatë anëtarë të një grupit që merrej me trafikun e drogës, të gjithë shqiptarë, por identiteti i tyre nuk bëhet ende i ditur nga autoritetet. Janë të njëjtat burime që konfirmojnë se, kreu i dyshuar i grupit është raportuar se kishte qëndruar në një strehë azili në qytetin Oedheim, ndërsa të tjerë ishin regjistruar si të pastrehë në Heilbron dhe Karlsruhe. Arrestimet janë kryer në fillim të prill, ndërsa vendimi u publikua ditën e djeshme nga mediat vendase. Gjatë arrestimit, shqiptarët u kapën me 9 kg kanabis sativa. Prokuroria ka lëshuar urdhër arrestet ndaj të 7 personave, ndërsa të arrestuarit në ditë në vijim pritet të dalin përballë gjykatës për tu njohur me masën e sigurisë.

Pranga mësuesit të shkollës 9-vjeçare në Kashar, abuzoi seksualisht me nxënësen

Mësuesi i shkollës 9-vjeçare Mustafa Lleshi në Kashar, Hasan Martani ka përfunduar në prangat e Policisë së Tiranës, pasi dyshohet se ka abuzuar seksualisht me një nxënëse të klasës së shtatë. Sipas policisë mësohet se kanë qenë prindërit e vajzës të cilët kanë denoncuar fillimisht në polici mësuesin e matematikës, pasi dyshohet se i ka bërë presion vajzës dhe e ka prekur në vend intime. Burime pranë uniformave blu bëjnë me dije se, 64-vjeçari Hasani gjatë marrjes në pyetje ka hedhur poshtë akuzat, ndërsa në dëshminë e saj vajza e mitur ka treguar mënyrën se si abuzonte ky i fundit, por blutë nuk kanë

dhënë më shumë detaje. Mësohet se, ngacmimi dyshohet se ka ndodhur në ambientet e shkollës dhe më tej ka vijuar në rrjetet sociale. Vetë vajza ka pohuar abuzimin e mësuesit, në praninë e psikologut. Për këtë rast do të kryhen verifikime nëse mësuesi ka shkuar përtej ngacmimeve seksuale. Nga ana tjetër kanë qenë prindërit e vajzës së mitur që kanë treguar se si e zbuluan që mësuesi i matematikës i bënte presion vajzës. "Në momentin që vajza i ka thënë që prindërit nuk dyshojnë që më ke ngacmuar, nuk u kam treguar ai u ka thënë që më hoqe një hall të madh, më shpëtove, më qetësove, nusja këtë kishte pritur, ta kapte me

një fakt", është shprehur babai i vajzës. Ndërkohë nëna e të miturës ka treguar se disponojnë prova dhe fakte që mësuesi e ka ngacmuar seksualisht vajzën dhe të gjitha këto i kanë dorëzuar në polici. "Presion ka ushtuar gjatë gjithë kohës, gjatë orëve të mësimi që vajza mos tregonte për ngacmimet. Bisedat i kemi fotografuar dhe i kemi çuar në Polici. Tani ai do ta mohojë, por cili prind do ta donte diçka të tillë për fëmijën", tha mamaja e vajzës. Ndërkohë drejtoresha e shkollës ka pezulluar mësuesin Hasan Martani. Në lidhje me këtë rast materialet e mbledhura në ngarkim të të arrestuarit iu kaluan prokurorisë për veprime të mëtejshme.



k o m e n t e & a n a l i z e

Budallait dhe të çmendurit i hapet rrugë!

Nga Pandeli **BARDHI**

...Kjo është rruga më e mundshme për këta personazhe të cilëve u ka rënë në pjesë kjo fatkeqësi pa dëshirën e tyre. Por, "paramilitarët" e Bashës, "çmendurinë" e tyre e kanë nga qejfi, e kanë nga etja për pushtet, e kanë nga ajo që nuk mund të rrinë pa bërë shkatërrime, pa ushtruar dhunë siç kanë bërë qysh në fillimet e demokracisë e nuk kanë të ndalur. Dhuna, ka qënë gjithmonë në karakterin e "saliistëve" dhe "bashistëve" megjithëse kot e morën në qafë Bashën që i varën këtë "këmborë" si kryetarin e dhunuesve, të cilën po e tund në çadër! Jo vetëm që nuk ka dhënë një fije kontribut Basha në interes të forcimit të demokracisë, por përkundrazi, ka bërë vetëm shkatërrime, ka nxitur vetëm urrejtje, ka nxjerrë vetëm pengesa në rrugën e demokracisë. E tërheqin për hunde disa që nuk e duan Shqipërinë dhe e përdorin si "mburojë" disa të tjerë, për t'u fshehur prapa tij në qëllimet e tyre djallëzore. Basha dhe "bashistët" janë një fatkeqësi kombëtare! "Bashat" nuk kanë të ardhme, nuk mund të pengojnë shtetin ligjor. Kushdo e kupton sot qëllimin e tyre. Bashat dhe "Salinjët" janë ata që nxisin dhunë e terror. Këtë e kanë vërtetuar me vepra. Në Kavajë, nuk ka faj "Basha" i vogël që shprehet se "shtë koha e dajakut"! "Dajaku", dhuna, shkatërrimet, urrejtja kanë qënë dhe janë në programin e tyre. Në zgjedhjet lokale që do të bëheshin në Kavajë, "Bashat" kishin parashikuar një "21 Janar" të dytë, kishin parashikuar një "Gërdec" të dytë, kishin parashikuar një "Shtator" të dytë, por nuk u eci. Me veprimin që bëri Rama, për tërheqjen e kandidatit të tij, ju pre hovi që kishin marrë për dhunë, për djegjen e bashkisë, siç kanë bërë dikur para njëzet e shtatë viteve. Në këtë kuptim, veprimi i Ramës ishte një veprim i drejtë, i pjekur, ishte një sakrificë nga pushteti i tij, për të ndërtuar shtet, atë shtet që "Bashistët" nuk e duan. Rama u hapi rrugë, atyre që ishin mprehur për terror. Këtë Basha e quajti një "fitore" një tërheqje prej frikacaku! Por, t'i hapësh rrugë kokave të çmendura, është pjekuri, është maturi. E bëri këtë Rama, nga vetja apo me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve, kjo nuk ka rëndësi, rëndësi ka që u shmang një dhunë e organizuar nga "bashistët"! Basha e quan këtë "fitore" por "paramilitarët" e tij në KQZ e gjetkë, nuk mendojnë kështu. Ata janë të "pakënaqur" me këtë veprim sepse nuk u realizuan dëshirat e tyre. E komentojnë këtë veprim të Ramës në mënyra të ndryshme, politikanë dhe të ashtuquajtur analistë të "Cimpekëzuar" e disa "kakërdhi" e "mbetje" të së kaluarës. Të mendosh kështu, do të thotë të jesh Shkullak nga mendtë, të jesh Lubonjë, apo ku ta di unë.

Dëgjojmë ditë e natë nëpër kanalet televizive vetëm broçkulla politikanësh dhe sekserëve të tyre të ashtuquajtur analistë. Edhe televizionet mbushin programet e tyre, edhe krimi e korrupsioni vazhdojnë "të qetë" rrugën e tyre. E pse të mos vazhdojnë përderisa drejtësia fle, përderisa Shteti është i "përgjumur" dhe nuk i del zot vendit megjithëse ka marrë një milion "armë"! Vetëm për propagandë e për t'u mburrur i përdori Shteti këto "armë" që i "dorëzoi" popullit dhe jo për të luftuar të keqen që ka hedhur rrënjë. Vetëm me një "armë" të marrë borxh nga kundërshtarët e tij, mburrej Saliu dhe nuk e luante as "topi" nga karrigia e tij e pushtetit, kurse Rama me shokë, as një milion të tilla, nuk i përdorën për të bërë Shtet e për të mos lejuar "kecër" si Basha të bëjnë trimin sikur kanë popullin me vete. Kanë të drejtë të



kërcënojnë "Bashat", të shprehen për mosbindje civile, për të rrëmbyer armët për mbrojtjen e pronave të tyre, siç thotë babagjyshi i krimi, i anarshisë, i antiligjit!

Berisha dhe "berishistët" këta banditë, nuk i ndahen këtij populli. Zanafillën e kanë qysh mbas shpalljes së Pavarësisë, qysh atëherë kur Esad Pasha i shprehej Medi Frashërit në Paris, që "Kur të kthehem në Tiranë, Qeverinë tuaj do ta var në litar"! Kështu kërcënon edhe pasardhësi i tij Berisha për rrëzimin një orë e më parë të "Qeverisë së krimi", për "tërheqjen zvarrë të kryeministrit, për hedhjen e tij në Lanë"! Esad Pasha i dorëzoi Shkodrën malazezëve, të njëjtën gjë bënte edhe Basha and Co për dorëzimin e pasurisë kombëtare tek grekët. "Karavidhet" e të gjitha llojeve që punojnë në dem të interesave të popullit, mbeten të njëjtë qysh nga fillimet e shekullit pavarësisht se ku futen e ku qëndrojnë, në mal, në "shportë" apo në çadër. Historia përsëritet, tradhëtarët kanë të njëjtën gjuhë. A i hyri "gjembe" në këmbë Bashës, me kërcënimet e tij për "tërheqje zvarrë", për "thyerje xhamash" e "shpim gomash"? Po aq sa i ka hyrë "gjembe" Saliu! Shumë kallzime penale janë bërë por Basha dhe Saliu qeshin, qeshin sepse e dinë që nuk ka drejtësi, e dinë që ka vetëm Llalla, që "përtypen" të përgjumur e marrin nën mbrojtje hajdutët e të korruptuarit sepse janë vetë të tillë. E pse të mos kërcënojnë edhe "Bashat" e vegjël? Çfarë do t'i gjejë? Asgjë. Asgjë nuk e ka gjetur cilindo nga "kampi i çadrës" për gjithçka kanë bërë për të marrë apo për të mbajtur pushtetin me dhunë e kërcënime! Basha dhe Saliu protestojnë për votën e lirë e të ndershme. Por askush nuk e beson që mbrojtës të votës së lirë, duan të bëhen ata që janë autorët e vjedhjes dhe shpërdorimit të kësaj të drejte të popullit për të vendosur për fatet e tij. E tek e mendon këtë, është pak që të qeshësh për këta "çadristë" që protestojnë në çadër, për votën e lirë të qytetarëve! Basha dhe "salinjët" e dinë më mirë se kushdo që zgjedhjet në Kavajë, do të shënonin humbjen e tyre të katërt dhe pastaj, ç'kuptim do të kishte për të qëndruar akoma në çadër? Për këtë ata ngritën në këmbë falangat e krimi të tyre, atje ku e kanë mbështetjen, atje ku kanë të vetmen shpresë për të fituar. Por, a do të jenë në gjendje "paramilitarët" e Bashës të pengojnë gjithë popullin për të votuar i lirë më 18 Qershor? Vështirë e ka Basha. Atje do të flasi populli, atje do të vërtetohet nëse Rama është "frikacak" apo është vizionar! Hapin e parë të "fitores", atë të shtyrjes së vetingut e arritën, por a do të mundin ta heqin fare nga "defteri"? Këtë nuk do të mund ta bëjnë kurrë sepse një ditë, ata dhe kushdo që ka bërë zullume, një

ditë do të japi llogari. Më shumë se kushdo, zullume kanë bërë Salinjët e Bashat, prandaj edhe janë tërbuar duke mos gjetur rrugë tjetër shpëtimi përveç asaj të qëndrimit në çadër, ku dërdëllisin gjithë ditën.

Basha nuk del nga çadra, Basha, është i humbur dhe këtë ai e kupton mirë. Nesër, do të dali apo do ta nxjerrin nga çadra. Sido që të jetë, Basha do të thotë: "Humba sepse dola nga çadra, dhe jo se hyra dhe i humba zgjedhjet". Basha i ngjan atij keci të tërbuar të mbyllur në kotec që sulmon me brirë gardhin në pamundësi për të dalë jashtë. Kujton se u bën dem të tjerëve, por ata qeshin. I dëmtuar, është vetë "keci" Bashë që po thyen "brirët" e vet dhe po shtyp disa "kakërdhi" rreth e rrotull, që gjoja i ka aleatë, por në të vërtetë, edhe ata qeshin me "hazdisjet" e këtij "keci"!

Po kështu, duhet të pranojmë që nuk është zgjedhja e duhur në krye të Shtetit e njeriut më të përfolur për vjedhje e korrupsion, pavarësisht buzëqeshjeve të tij "me qetësi e dashuri"! Ilir Meta, nuk e ka dashur reformën në drejtësi, sepse është edhe vetë objekt i hetimit. Këtë zgjedhje, populli nuk do ta bënte kurrë. Kjo është një zgjedhje e të dy partive për të vazhduar në rrugën e dallaveve në kurriz të popullit. Edhe PD-ja, edhe PS-ja e dinë më mirë se kushdo që Ilir Meta për këto parti është njeriu më i përshtatshëm sepse ai gjatë tërë kohës në politikë, njërës palë i ka "shkelur syrin" kurse palës tjetër i ka "buzëqeshur" dhe mirë ka bërë përderisa e lejojnë të luajë me "dy porta". Nuk është kjo shenjë e aftësisë së Metës, por është "shtrati" që i kanë krijuar të dyja këto parti për interesat e tyre të ngushta. Prandaj, edhe qytetarët kanë të drejtë të zhgënjehen, kanë të drejtë të humbasin besimin tek demokracia, tek shteti ligjor që pretendojnë politikanët tanë! A nuk janë vallë aktuale, fjalët e Faik Konicës kur ai shkruante qysh në vitin 1922: "Populli shqiptar, ka veti shumë të mira, por një bandë maskarenjsh, rryshfetçinjsh hafijesh dhe dallaveraxhinj kanë zënë të gjitha pozitat kyçe në politikën e vendit dhe është fare e pamundur t'i shkullësh". Hallet e popullit janë të shumta, por askush nuk merret me to. Shteti nuk merret për të luftuar të keqen, politikanët merren me "gërrvërre" dhe bandat vazhdojnë në rrugën e tyre, trafikantët nuk ndalen në trafikun e jash-tëligjshëm, dhe vjedhësit vazhdojnë të vjedhin edhe atë ç'ka ka mbetur! E tërë barra bie mbi qytetarët e ndershëm që vazhdojnë të shpresojnë se diçka do të bëhet por siç duken "bathët". Janë fshirë me kohë nga fjalori fjalët tolerancë, bashkëpunim, marrëveshje për interesat e vendit, dashuri, kompromis... Këto janë zëvendësuar me fjalët e "kohës" me urrejtjen, egërsinë, dhunën, hakmarrjen, tërheqjen zvarrë. Deri kur kështu...?

Dëgjojmë ditë e natë nëpër kanalet televizive vetëm broçkulla politikanësh dhe sekserëve të tyre të ashtuquajtur analistë. Edhe televizionet mbushin programet e tyre, edhe krimi e korrupsioni vazhdojnë "të qetë" rrugën e tyre. E pse të mos vazhdojnë përderisa drejtësia fle, përderisa Shteti është i "përgjumur" dhe nuk i del zot vendit megjithëse ka marrë një milion "armë"! Vetëm për propagandë e për t'u mburrur i përdori Shteti këto "armë" që i "dorëzoi" popullit dhe jo për të luftuar të keqen që ka hedhur rrënjë. Vetëm me një "armë" të marrë borxh nga kundërshtarët e tij, mburrej Saliu dhe nuk e luante as "topi" nga karrigia e tij e pushtetit, kurse Rama me shokë, as një milion të tilla, nuk i përdorën për të bërë Shtet e për të mos lejuar "kecër" si Basha të bëjnë trimin sikur kanë popullin me vete...

k o m e n t e & a n a l i z e

www.sot.com.al

Nga Riza HOXHA

Në Shqipëri ka nisur të gumëzhijë fushata elektorale. Paçka se çadra vazhdon të rënkojë nga zërat e mekur të 100 a 200 banorëve të saj. Dy herë në 24 orë mbledhen për të duartrokatur edhe rreth 100 vetë. Duartrokasit të ushqyer me bindjen se, fushata elektorale nuk do të nisë pa u dhënë lejen ata.



Për çudi askush nuk ua vuri veshin edhe pse vazhdojnë të mos e luajnë as njërin vesh aty në çadër. Dhe e nisin fushatën secili sipas dëshirës së vet. Duke i çuditur shqiptarët e shkretët, të cilëve nisën t'ua kërkonin votën me ngulm. Kërkonin me ngulm votën edhe pse shqiptarëve të shkretët secili u dukej njëllor. Njëllor me Suden e dikurshme që i mashtronte shqiptarët duke i plaçkitur me lezet.

Njëra parti si PAD nuk u premtoi gjë shqiptarëve, po u prezantoi gjithë farefisim familjar të kryetarit si kandidatë për deputet. Qesharake ishte edhe prezantimi i MAGA-s, ku të gjithë kandidatët për deputetë janë me një mbiemër.

Është stërthënë fakti se në Shqipëri është instaluar një pushtet i ndyrë familjar, i cili u ka garantuar shqiptarëve vetëm rritjen monotone të varfërisë. PAD është kthyer aq qesharake sa edhe pse vetë në qendër është radhitur krahu së majtës, në

Premtimet e fushatës që na kujtojnë Suden

ndonjë zonë rurale drejtuesit lokalë vazhdojnë t'i qëndrojnë besnikë së djathtës. Kush mund të më thotë: çfarë monstrash janë parti të tilla, që tashmë nuk janë të pakta në Shqipëri?

Sa keq për ne shqiptarët në ç'duar kemi mbetur. Edhe pse është vetëm fillimi, secila parti ashtu si Sudja, nxjerr në treg malin e vet të premtimeve. I kanë aq të shumta premtimet sa ne shqiptarët çuditemi se pse jemi të mbytur nga varfëria dhe në të gjitha tubimet vetë 3m I duartrokasim premtimet frenetike të tyre.

Jemi në ditët e para të fushatës, por PS po i kënaq dëgjuesit e saj. U ka premtuar 220 mijë vende të reja pune. U ka premtuar edhe uljen e borxhit publik nën 60 për qind, por edhe largimin e gjykatësve të korruptuar (sa shumë gjykatës të korruptuar kanë mbirë në këtë vend?!).

Nuk thonë kot: ëmbëlsira për në fund. Edhe pse në 3 vitet e para të qeverisjes së parë të PS-së paga nuk u rrit asnjë qindarkë, bile nuk u rrit as për të vlerësuar inflacionin, tani u premtohet shqiptarëve rritja e pagës me 40 për qind.

Premtimet nuk i ka lënë jashtë vëmendjes edhe PD që nga çadra e saj. Kryepremtimi i saj është ngritja e Republikës së Re. Një premtim ekzemplar. Ngritja e republikës së Re pa nda treguar se kush do të punojë të shembë Republikën e vjetër. Në të vërtetë, kjo e vjetra, i ka tromaksur gjithë shqiptarët me pushtetin familjar që ka ngritur, me korrupsionin galopant, apo me Drejtësinë e mirëorganizuar nga plazhistët e Durrësit. Edhe pse janë mërzhitur me fushata zgjedhore, ndaj me 18 qershor kanë vendosur ta bëjnë pushim, premtojnë rritje të pensionit më të

vogël në 25 mijë lekë, shkolla publike me ushqim dhe studim të paguar brenda orarit zyrtar të punës së prindërve. Por edhe subvencion deri në 150 milionë euro për fermerët. Dhe PD vazhdon të premtojë. Premton edhe gjithë zinxhirin e koncesioneve në shëndetësi.

Vargani i premtimeve nuk ka të sosur nga të gjitha partitë. Bile edhe nga ato parti që listën e kandidatëve të vet e kanë mbushur plot me vëllezër, motra e kushërinj sa janë bërë qesharakë. Hajde besoj dhe jepi votën partive të tilla, që e dinë pushtetin se është pronë e familjes së tyre.

Nuk kanë të sosur premtimet. Kryetari i LIBRA-s, Ben Blushi ka një premtim që rrallë kujt i ka shkuar në mendje. "Nëse LIBRA vjen në pushtet do të paguajë 1000 euro çdo familje për lindjen e një bebeje", premtonte Blushi. Kur në shtetin tonë

ka prej vitesh që nuk i kanë marrë shpërblimet prej 5000 lekësh bebet që tashmë janë në shkollë. Premtimi synon të pengojë shpopullimin. Drastik që ka përfshirë Shqipërinë tonë. Po lindjen mund të vijë në rritje vetëm nëse ulet varfëria dhe pushteti nuk i lihet në dorë vetëm një grupi oligarkik.

Vargu i premtimeve është i pafund. Po ende asnjëherë prej partive nuk i shkon mendja të na tregojë se si do të mund t'i realizojë këto premtime. Si do të mund ta ngrëjë këtë Republikën e Re? Do të marrin pjesë edhe palopolitikanët e deritanishëm, apo kjo klasë politike do të shembet, pasi ajo është krijuesja dhe ideuesja e Republikës së vjetër që shqiptarëve u ka sjellë aq shumë fatkeqësi. Është bash kjo arsyeja që shqiptarët thonë: Këtë klasë politike duhet ta fusim në një thes, t'ia mbyllim grykën dhe thesin ta hedhim te trekëndëshi i Bermudës.

Kësisoj shqiptarët do të qetësohen dhe do të mund të ndërtojnë një kontratë të re me klasën e re politike. Vetëm atëherë mund të artikulojmë lindjen e republikës së Re. Do të jetë kjo klasë politike që do të vendosë qytetarin në qendër të vëmendjes dhe do t'i shërbejë atij me devotshmëri duke e trajtuar qytetarin si zot e jo si shërbëtor. Vetëm atëherë ne shqiptarët do ta ndëjmë veten se jemi sovran kur shkojmë pranë kutisë së votimit. Pasi deri tani gjithnjë e kemi ndërjet veten si shërbëtor të një klani oligarkik që ka mbërthyer për fyti gjithë sistemin e kësaj Republike që ende merr frymë.

“Fashistoidët” e qendrës së Tiranës në delir!

Nga Besi BEKTESHI

Tanimë kemi të bëjmë me një sulm të pashpresë kundër demokracisë në Shqipëri. Asaj pak demokracie që kemi dhe sigurisht ndaj institucioneve, të cilat janë akoma në këmbë, por dhe personave mbas tyre, të cilët ashtu sikundër kam paralajmëruar janë të huajt! Nuk është vetëm porosia për të kumtuar një vrasje në shkrim FB-ku - ku e keqja e vërtetë nuk është shkrimtaria delirante, por porosia keqane dhe paralajmëruese armiqësore për të huajt e BE-së?! Nuk është thjesht problemi për një person në krye të delegacionit dhe përfaqësisë së BE-së, se sa tashmë përpjekja për të bërë qëndresën e fundit me momente fashistizimi mediatic dhe moral, por dhe të një retorike pothuaj fashiste. Unë kam idenë se këto në qendër që delirojnë kështu nuk janë aftësisht fashistë! Sigurisht jo. Janë “fashistoidë” – ose karakterialisht ngjashëm të tillë, që mbajnë pothuaj të njëjtin qëndrim dhe kanë po të njëjtën retorikë në fjalime, por në mënyrë më ambigue apo tepër të përgjithshme e racionalisht jo kaq të qartë si



ideologji?! I ngjan profofashizmit të fillimit - mbas luftës së parë botërore dhe pastaj akoma më fort përgjatë kohës ku po përgatitej marshimi mbi Romë. E kam sqaruar dhe një herë tjetër në një shkrim përpara disa ditësh?! Por kësaj rradhe po teprohet jo vetëm me përgatitjet marshuese me njerëz të dyshimtë dhe skema rebelimi dhe provokimi, por dhe ngritjen akoma më shumë të toneve “fashistoidë” në qendrën e Tiranës?! Nuk kanë as zgjuarsinë dhe as qëllimin për tu “fashistizuar” plotësisht, sepse janë nomadë të leximit politik dhe historisë, por instiktivisht bëjnë një lloj përqasje të kobshme, duke kërcënuar tashmë haptas institucioneve dhe deri kush-tetutën?! Akoma më shumë - kanë bazament komunistë familjar dhe ju duhet vetëm një lëvizje shumë e vogël e aksit politik që nga komunistë të bëhen fashistë – por duke mos qenë në themel të tillë janë dhe ngajnë pikërisht si “fashistoidë”!

Imagjinoni kur kërcënohen dhe shahen institucionet e organizmave të huaja mike të BE-së dhe padyshim ambasadorët të huaj miq se janë bërë një me “mafien në pushtet” dhe në shkrimet e tyre nuk kanë kanabisin dhe regjistrimin në zgjedhje?! Sigurisht që tashmë lufta kryesore është ndaj tyre?! E kam thënë dhe stërthënë dhe janë lejuar si nga qeveria shqiptare dhe ato vetëm (të

huajt) që gjendja të degradojë deri në guximin e “fashistoidëve” në bulevard për të kërcënuar rendin kushtetues dhe përfaqësitë politike të huaja në Shqipëri?! Vetë lideri i tyre thotë se: ka vetëm dy rrugë ku kolegji zgjedhor do të “ballafaqohet” (përdoret termi ballafaqim jo kërkesë ligjore e PD-së) për të hedhur poshtë 18 qershorin dhe listat e paligjshme?! 18 qershori është dekretuar nga Presidenti dhe listat janë të partive dhe vulave të tyre dhe po kontrollohen nga organet e dekriminalizimit?! Këto thotë ai - duke i hedhur poshtë sipas ligjit të Republikës së Vjetër?! Pra futet nocioni i mos pranimit të ligjeve të Republikës së Shqipërisë që konsiderohet “Republikë e Vjetër”?! Nuk di në se ju kujtohet “Rendi i Ri” i kohës së nazizmit dhe ideologjia fashiste e tillë e viteve 1922 e më vonë?! “Fashistoidët” sot kërkojnë Republikën e Re si dikur Rendi e Ri” - fashistët dhe nazistët?! Po pra, lideri i “ri” i cili detyroi shumë parti të tjera të vonohen për të pritur regjistrimin e partisë së tij deri në ditë të fundit të ligjit, dhe tani me këtë gjë, do të prishë dhe kërcënojë Kolegjin Zgjedhor?! Ai thotë se: ligji i vjetër do të jap një shans republikës së vjetër, të përfundojë misionin e saj, përmes konsensusit dhe negociatave. E pastaj vazhdon duke kërcënuar tashmë vetë Kolegjin Zgjedhor – nëqoftëse me presione (vetë po bën

presion të hapur duke thënë pikërisht këtë) apo me zhake (kush ja ka mësuar këtë fjalë idiote nuk dihet) Kolegji Zgjedhor vendos t'ju thotë shqiptarëve se 17 plus 31 plus 2 bëjnë 49 dhe jo 50-të – atëherë Kolegji Zgjedhor, Ligji Zgjedhor dhe Kushtetuta e Republikës së vjetër, do të merren përpara nga Bashkimi i Shqiptarëve të Republikës së Re?! Merren përpara – çfarë do të thotë?! Si merren përpara, me çfarë merren përpara?!

Do të mjaftonte kjo gjë e thënë në çdo vend të qytetëruar dhe demokratik të botës, që njeriu që e kishte nxjerrë nga goja dhe e kishte elaburuar disa herë të mbante përgjegjësi penale dhe kushtetuese kur është një i zgjedhur, apo dhe me status të veçantë si person politik?! Në një vend demokratik ku elementë fashistoidë bëjnë kështu - ligji vepron menjëherë dhe nuk ka “profesorë” që mbrojnë delirantë të tillë politikë apo gazetareskë në delirin e anti kushtetutshmërisë më të keqpërdorur ndonjë herë në Shqipëri?! Nuk do të kishte Prokurori që ti mbronte dhe po të kishte qoftë një urdhër të tillë mbrojtës do të ishte ky segment që do të akuzohej për thyerje ligji?! Jo më që shoqëria dhe shumë pjesë të saj të praninon një delir të tillë pa reaguar dhe ashpër?!

Mbase është një mënyrë që “fashistoidë” të tillë - lejohen që të

bëjnë pikërisht atë efektin e kundër të propagandës së tyre famëkeqe dhe irracionale në përgjithësi?! Mund të jetë dhe kjo, por unë e kam problem-in me organet e drejtësisë që ka mbetur, apo të politikës së ditës që merren vetëm me barsoleta dhe lojra vizatimore në FB?! Ka një limit për “fashistoidët” në qendër të Tiranës?! E kjo është pikërisht qendra e Tiranës?! Ky model propagandistik dhe acarues politik, thyerjen e ligjeve dhe nxitës për thyerjen e kushtetutës, nuk po luhet në ndonjë periferi të cepave të Shqipërisë, por në qendër të saj?!

Kush ka një ide që mund të tolerohet një bastardim i tillë politik me pasojë të këqija në një pjesë të madhe të shoqërisë në këtë tymnajë politike që të merr frymën – a mund të ndalet në idenë aspak normale të tij?!

Tanimë kanë kaluar në delir – por po kalojnë në delirin e tolerancës dhe deri në frikacakllëk dhe ata që kanë në dorë të mbrojnë rendin dhe kushtetutën në Shqipëri?! Presin që ditën që vjen të derdhet gjak, apo të shkatërrohet diçka, apo ndodhë diçka që ka tmerr dhe rend të prishur?! Po të jetë kështu e kanë gabim – duhen ndalur, parandaluar, sepse në delirin që kanë marrë si yrysh ndonjë maskarallëk frikacakësh dhe poshtërsie, mund të ndodhë gjithçka dhe kjo është shumë keq.

kulture

■ Drejtori i QSA flet për problemet në punën studimore dhe shkencore në QSA

Marenglen Verli: Shteti në borxh me studiuesit, prej 10 vitesh nuk na paguan honoraret

Qendra e Studimeve Albanologjike vazhdon të vuajë buxhetet e pakta dhe mungesën e financimit të projekteve, kështu shprehët prof. dr. Marenglen Verli, drejtor i QSA. Në intervistën e tij dhënë për gazetën akademiku Verli flet për punën që bëhet për kërkimin shkencor në QSA, por dhe kushte munguara të punës. Sipas tij, jo vetëm që mungojnë financimet për projektet e ndryshme në fushën e albanologjisë, por dhe honoraret e punonjësve shkencorë prej vitesh nuk janë paguar për shkak të problemeve me legjislacionin. Akademiku Verli pohon se arritjet janë në radhë të parë në sajë të pasionit të studiuesve, pasi prej vitesh vëmendja nga shteti ka munguar për punën shkencore. Sipas tij, studimet në fushën e gjuhësisë, historisë etj, për specifikën e tyre domosdo duhet të jenë të financuara nga shteti për shkak të rëndësisë shumë të madhe që kanë.

- Prof. Verli, ju jeni në krye të Qendrës së Studimeve Albanologjike që nga shtatori i vitit që kaloi. Çfarë mund të na thoni mbi prioritetet e punës suaj gjatë kësaj kohe?

QSA startoi në vitin 2008 kur në të përfshinë 4 institucione shkencore të ish Akademisë së Shkencave përkatësisht Instituti i Historisë, i Gjuhës dhe Letërsisë, i Antropologjisë dhe i Arkeologjisë. Këto institucione të shkencave humane në kuadrin e ASH në vitin 1990, kanë pasur rreth 300 punonjës, në një raport gati në baraspeshë midis punonjësve shkencorë dhe forcave ndihmëse, të cilat me rastin e këtij riorganizimi patën një reduktim të dukshëm. Institutet e QSA në vitin 2008 numëronin gjithsej rreth 120 punonjës shumica e të cilëve pjesë e profesoriatit apo e studiuesve shkencorë. Pavarësisht nga riformatimet e herëpashershme, gjatë kësaj periudhe 27-vjeçare, duke filluar nga viti 1992-1993, tendenca në këtë sektor shumë të rëndësishëm të kërkimit shkencor, siç është albanologjia, ka qenë tkurrja e vazhdueshme numerike. Nënvizoj se është fjalë për ato degë të shkencës shqiptare të domosdoshme për identitetin dhe krenarinë tonë kombëtare, me impakt të padiskutueshëm moral ku ne jemi vërtetë origjinalë si studiues. Gjatë viteve 2009-2016 rreth 80 punonjës shkencorë të QSA kanë realizuar 152 botime monografike dhe të natyrës enciklopedike, rreth 2150 artikuj dhe kanë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme shkencore rreth 1150 referate e kumtesa.

- Ju u shprehët për reduktimin e punonjësve në vite, si ka ndikuar kjo në punën tuaj?

Edhe me numrin e pakësuar të studiuesve dhe personelin ndihmës të instituteve që u grupuan në QSA në vitin 2008, produktiviteti punës ka qenë mjaft i mirë. Por rezultat dot të kishin qenë më të mëdha nga një organizim dhe vëmendje më e mirë, që nga instancat vendimmarrëse shtetërore në varësi të të cilave ndodhet institucioni ynë. Sot që flasim bashkë, statusi i QSA është ende në diskutim, që do të thotë që institutet në vartësi dhe studi-

uesit kanë ende një pozicion të papërcaktuar. Në reformën në arsimin e lartë, me riorganizimin e fundit të universiteteve, QSA nuk u përfshi dhe ndonjëse ka kaluar gati një vit, akoma nuk është miratuar një draft përfundimtar për strategjinë e kërkimit shkencor, ku përfshihet dhe institucioni ynë.

- Ju si QSA, çfarë i keni propozuar MAS për strategjinë e kërkimit shkencor?

Natyrisht që ne i kemi ofruar MAS pikëpamjet tona që synojnë vendosjen në shina të shëndosha të kërkimit shkencor në sektorin e albanologjisë. Ne kemi sugjeruar që QSA në këtë kuadër të marrë një status special. Ndoshta një formë organizimi që do t'i jepte unitet, bashkëveprim dhe autonomi të gjerë instituteve të QSA, ose edhe ndonjë formë tjetër që do të llogariste një perspektivë optimale për kërkimin shkencor në të ardhmen. Problem kryesor përveç Statusit, mbetet financimi, drejtim në të cilin ne jemi shumë larg jo vetëm standardeve evropiane por edhe ballkanike. Shtete si Maqedonia dhe Kosova shpenzojnë tre katër herë më shumë se Shqipëria për financimin e kërkimit shkencor. Në kuadër të financimeve unë do të përfshija jo vetëm çështjen e pagave. Për sa u takon këtyre, përveç kësaj shtese të fundit që ishte e mirëseardhur për punonjësit tanë, duhet thënë se gjatë më shumë se dhjetë vjetëve që nga viti 2005 pagat kanë qenë të ngrira, që do të thotë se inflacioni i monedhës i ka zvogëluar ato gjatë gjithë kësaj kohe. Pjesë e financimeve është edhe mbështetja e projekteve, e cila ka qenë minimale gjatë gjithë kësaj periudhe. Janë me dhjetëra projekte që janë paraqitur dhe janë në pritje të financimit që të zhvillohen. Praktikisht punohet vetëm me projektet individuale të studiuesve apo të grupeve që finalizohen me monografi dhe studime të tjera, për të cilat financimi është vetëm paga e punonjësve. Kjo e ka bërë shumë të vështirë realizimin e projekteve në bashkëpunim përtej institucionit dhe përtej kufijve të Shqipërisë. Edhe kur arrihet një bashkëpunim i tillë për mungesë fondesh ne nuk jemi partnerë të barasvlershëm. Specifika e veçantë e instituteve albanologjike është e tillë që duke përjashtuar ndonjë drejtim të caktuar si fusha e arkeologjisë apo antropologjisë në drejtime të tjera të studimeve gjuhësore, të historisë etj., është e vështirë të sigurohet partneritet. (Duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë ekzistuese Instituti i Arkeologjisë në bashkëpunim me institute analoge nga Franca, Britania e Madhe, Gjermania, Italia, Zvicra, Polonia etj, realizon në territorin e Shqipërisë 32 projekte ndërkombëtare). Studimet në fushën e gjuhësisë, historisë etj, për specifikën e tyre domosdo, duhet të jenë të financuara nga shteti shqiptar për shkak të rëndësisë shumë të madhe që kanë. Ne kemi ende nevojë për evidentimin e identitetit tonë, pra duhet të punojmë në këtë drejtim, siç punojnë dhe fqinjët tanë ballkanas, por dhe shumë vendet tjera, madje vëmë re se atje puno-



het shumë intensivisht. Për të stimuluar studimet tona, së paku do të duhej të zbatohet legjislacioni në fuqi për shpërbllimin e studimeve të realizuara, sepse ka vite që një gjë e tillë mungon.

-Nuk zbatohet legjislacioni në fuqi për shpërbllimin e kërkimit shkencor, si ndikon kjo?

Në drejtim të stimulimit të studiuesve për të punuar sa më mirë dhe për të nxjerrë në sasi më të madhe produktin e tyre shkencor është caktuar në bazë të një VKM të vitit 1997 një skemë honorarësh për zëra të ndryshme pune. Por prej gati dhjetë vitesh ky legjislacion ka qenë jo funksional. Nga një llogaritje e jonë pa pretendime për saktësi absolute, vihet re se vetëm gjatë këtyre dhjetë viteve është krijuar një borxh i shtetit ndaj punonjësve tanë për afërsisht 40 milionë lekë të rinj. Duket shumë e madhe, por po të llogaritësh dhjetë vjet punë, mesatarja për një studiues është një shifër e papërfillshme. Gjithsesi, respektimi i ligjit të shtetit për shpërbllimin e punës së bërë, është respekt për punën e njerëzve të shkencës, për angazhimin dhe përkushtimin e tyre jo të zakonshëm.

-Pse kanë munguar honoraret për studiuesit?

Honoraret kanë munguar sepse financimi ynë, përveç pagave, në drejtime të tjera ka qenë i papërfillshëm. Në buxhetin që na akordohet vit pas viti me sa duket honoraret për punën e bërë nuk parashikohen. Nga ana tjetër do të shtoj se një kërkim shkencor bashkëkohor bën të nevojshme daljen e studiuesve tanë dhe përtej kufijve të Shqipërisë. Janë shumë të domosdoshme këto lëvizje për të siguruar material pune dhe shkëmbim eksperience. Natyrisht puna hulumtuese jashtë shtetit kërkon financim, gjithashtu

humbasin kohë të çmuar për shkak të shpërndarjes në dy godina që janë në distancë nga njëra tjetra, të zyrave, bibliotekave, arkivave etj. Natyrisht në këtë mënyrë vështirësohet puna, ka humbje kohë të çmuar, e cila reflektohet në rënie e rendimentit të punës. Problemet kanë qenë të njohura për MAS. Unë edhe një herë i ngrita problemet pas marrjes së detyrës, qoftë me titullarë të Ministrisë, qoftë në ndonjë Komision të Parlamentit që pati mirësinë të më dëgjojë. Jam i kënaqur për vëmendjen dhe dashamirësinë që është treguar në të gjitha këto takime për problemet e QSA dhe ne jemi në pritje të përmirësimit dhe zgjidhjes së problemeve tona.

-Në janarin e vitit që vjen është 550-vjetori i vdekjes së Skënderbeut. Çfarë keni menduar si drejtues i QSA?

Në kemi një projekt që lidhet në radhë të parë me një konferencë të madhe ndërkombëtare, produkti i së cilës do të jenë botimi në 2 vëllime i gati 1 mijë faqe në shqip dhe më pas 1 mijë në anglisht të akteve të konferencës, të cilat do të shënojnë arritjet më të fundit të shkencës për tematikën në fjalë. Duke e fokusuar konferencën jo thjesht tek Skënderbeu dhe veprimet e tij politike-ushtarake të momentit, por duke parë më gjerë periudhën që solli ato vite qëndrese me në krye Skënderbeun edhe në plane demografike, ekonomike, kulturore dhe fetare etj., ne shpresojmë se do të sillen risi për këtë problematikë dhe për gjithë atë periudhë mesjetare shumë të rëndësishme. Një konferencë e tillë kërkon dhe kohën e duhur, sepse do të duhen vendosur lidhje me studiuesit e huaj kudo në botë, specialistë për periudhën përkatëse. Përveç konferencës financim kërkon edhe botimi i 14-15 vëllimeve me tematikë për këtë periudhë mesjetare, që janë pjesë e angazhimit tonë në projektin e 550-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Këtë projekt e shoqërojnë edhe propozime që rekomandojnë veprimtari të ndryshme që do të duhej të ndërmerre MAS, Ministria e Kulturës, bashkitë etj., në këtë vit jubilar të Skënderbeut. Mund të ishte nevoja që një komision shtetëror të merrte përsipër organizimin e kësaj pune që del përtej spektrit të punës së instituteve të albanologjisë. Mendoj se një konferencë e madhe e shoqëruar me botimet e sipërpërmendura, më mirë se sa QSA, nuk mund ta organizojë dikush tjetër.

-Me gjithë këto që folët, në fund çfarë apeli keni për shtetin në drejtim të kërkimit shkencor?

Për kushtet që kemi po përpiqemi të bëjmë maksimumin, duke u mbështetur në pasionin tonë, duke pasur në plan të parë detyrën kombëtare. Ajo që kërkojmë, është një vëmendje dhe përkrahje morale dhe materiale më e madhe nga shteti. Kjo duhet të jetë jo me momente të caktuara por e vazhdueshme, afatgjatë, një bashkërendim i ndërsjellë në mënyrë që shteti të njohë mirë kapacitetet tona dhe të marrë pjesë bashkë me ne për caktimin e prioritetëve për albanologjinë.

Intervistoi: Julia VRAPI

kulture

www.sot.com.al

■ Regjisori Nikolin Gurakuqi: Nuk ia kam hequr karakterin mistik, por dhe të përrallës

Opera "Flauti Magjik" e Mozartit, 3 net në skenën e Akademisë së Arteve

Nga Julia VRAPI

Opera "Flauti Magjik" e Mozartit për tre mbrëmje me radhë do të vijë për publikun në skenën e Universitetit të Arteve. Tashmë me rikonstruksionin e Teatrit të Operës dhe Baletit shfaqjet po zhvillohen në mjedise dhe skena të ndryshme, këtë herë është skena e UA ajo që do të presë këtë kryevepër botërore me regji nga Nikolin Gurakuqi. "Flauti Magjik" opera e mbushur me mister, magjinë e përrallës mozartiane për skenën e ka zberthyer regjisori Nikolin Gurakuqi. Regjisori i cili gjatë kësaj kohe po zhvillon provat me artistët flet për punën që po bëhet për shfaqjen operistike që do të vijë në datat 15, 16, 17 maj, ora 19.00. Regjisori Gurakuqi tregon se e veçanta e "Flautit Magjik" është një përrallë e bërë opera. "Flauti Magjik" përrallor. Nuk ia kam hequr karakterin mistik, por dhe të përrallës, përkundrazi ia kam forcuar dhe më tepër sepse kjo është dhe veçantia e veprës së Mozartit, një përrallë e bërë opera", tregon regjisori Nikolin Gurakuqi, i cili ka një aktivitet të vlerësuar në jetën artistike. Për gjithë kontributin e tij në jetën artistike regjisori Nikolin Gurakuqi këtë vit iu akordua dhe titulli "Mjeshtër i madh". Por ndërsa puna për shfaqjen po vijon regjisori flet dhe për kostumografinë, që këtë herë është realizim nga Anila Zajmi Katanolli. "Ne skenografinë e shfaqjes e kemi nëpërmjet videoprojeksioni dhe elementeve të një platforme me tre dimensione dhe përmes simboleve, ku e gjithë kjo atmosferë e mistike jepet nëpërmjet një ndriçimi dritë-hije dhe shfaqje që nuk e kemi lënë me shumë ngjyra, por vërtitet rrotull të zezës, bardhës dhe grisë sa i takon elementeve skenikë, ndërsa kostumet janë të gjithë ngjyrat. Janë kostume të reja, por dhe 6 interpretues të rinj, që nuk kanë qenë në shfaqjet e mëparshme", vijon më tej regjisori Nikolin Gurakuqi. Por dhe për vetë institucionin e Teatrit të Operës dhe Baletit kjo është një shfaqje që publiku nuk duhet ta humbasë. "Nëse doni të dëgjoni një histori të vështirë dashurie, një fabul, apo një opera komike, të gjitha këto do t'i gjeni te "Flauti Magjik" në datat 15,16,17 maj/ora



19:00. Në sallën e Universitetit të Arteve. Mos mungoni", shkruan në faqen e tij TOB.

Opera në skenë

"Flauti Magjik" është kompozuar nga Wolfgang Amadeus Mozart dhe me Libret të Emanuel Schikaneder. Për herë të parë është vënë në skenë, në Vjenë më 30 shtator 1791. Zyrtarisht libreti i "Flauti Magjik" është shkruar nga Schikaneder, mason i Lozhës në Vjenë, por duhet pranuar me forcë influenca në çdo varg e letrarit dhe masonit Mozart. Ai donte që kjo vepër të ishte testamenti i tij shpirtëror. Shumë i gjetur është kuptimi simbolik i veprës për t'ia dedikuar këtë meritë vetëm Schikaneder, sigurisht njeri i teatrit dhe këngëtar i shkëlqyer, me të drejtë interpretues i personazhit të Papagenos dhe jo Taminos. Nga ana

tjetër Mozart në finalen e Rrëmbimit nga Saraji transformon historinë romantike në një parabolë të Lessingut mbi bujarinë dhe bashkëjetesën njerëzore. Mbi origjinën e "Flautit Magjik" ka shumë legjenda. "Flauti Magjik" është një opera e mbushur me mister, e mbështjellë me një pëllhurë përrallore dhe pranimi me këtë kusht, pa spekuluar shumë mbi këtë, është e vetmja rrugë për të hyrë brenda botës së veprës. Të gjitha ngjarjet skenike dhe muzikore që zhvillohen në "Flautin Magjik" ndjekin një dinamikë shumë të fortë teatrale, por e shkëputur nga një logjikë dramatike. Në operën "Flauti Magjik", gjen shprehjen e saj më të lartë, toni popullor dhe komik, sensualiteti dhe solemniteti i shenjtë ndodhin dhe alternohen vazhdimisht përballë vdekjes.

"Aulona Inter Folk Festival", 3 mbrëmje në qytetin bregdetar

Në qytetin e Vlorës starton sot edicioni IX i "Aulona Inter Folk Festival", që do të zhvillohet deri më datë 13 maj. Ky edicion nis në skenën e sheshit "Pavarësia" në Skelë dhe mbyllet ditën kur në qytet do të kulmojnë veprimtaritë e hapjes së sezonit turistik "Vlora 2017", organizuar nga Bashkia Vlorë. Për 3 mbrëmje me radhë, Vlora do të jetë nën mbretërinë e folkut europian, duke përcjellë këngët dhe vallet folklorike që vijnë nga Çekia, Bullgaria, Bjellorusia, Sri Lanka, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Shqipëria. Festivali organizohet nga Qendra Kulturore "Aulona" Vlorë, me mbështetjen kryesore të Bashkisë së qytetit të Vlorës si dhe Ministrisë së Kulturës e donatorë të tjerë. Festivali "Aulona Folk" vazhdon të mbetet një manifestim i jashtëzakonshëm i folkut europian e më gjerë si dhe një promovim i rrallë i hapjes zyrtare të sezonit turistik të Vlorës. Një gërshetim i bukur i turizmit kulturor me turizmin natyror të rërës e ujit të detit. Edicioni i parë i këtij festivali është mbajtur në vitin 2009, duke shënuar të parin festival ndërkombehtar folkun në hapësirën mbarëshqiptare.



Për nga standardet që realizon, gjeografinë dhe diversitetin e grupeve, nivelin e zhvillimit në të gjitha planet ky festival prej edicionit të dytë është kualifikuar nga CIOFF, duke u bërë pjesë e kalendarit botëror që ky institucion prestigjioz kulture organizon në çdo vit kalendarik. Në tetë edicionet e zhvilluara kanë marrë pjesë rreth 70 ansamble nga vende të ndryshme të Europës me mbi 2300 pjesëmarrës. Festivali ndan si trofe "Kupën e Festivalit", e cila deri tani ka shkuar në Sllovakia, Kroaci, Bullgari, Itali, Kosovë, Turqi, Poloni dhe në Tiranë kur fitues është shpallur Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore. Presidenti Nderi i edicionit të 9 të do të jetë akademiku Muzafër Korkuti, kryetar i Akademisë së Shkencave. Ky festival në çdo edicion të tij merr jo pak vëmendjen e publikut dhe të pranishmëve që janë në skenë. Një aktivitet, i cili që në edicionin e tij të parë që nisi në vitin 2009 premtosi se do të ishte një traditë, duke i paraprirë dhe sezonit turistik që nis në këtë qytet, i cili gjatë stinës së verës ka shumë vëmendje.

"Përjetësisht Fëmijë", në programet e 7 festivaleve

Filmi i metrazhit të shkurtër "Përjetësisht Fëmijë" me skenar e regji të Lorena Sopit, prodhim i AS Film Production dhe Fakultetit të Arteve, është përzgjedhur të jetë pjesë e programeve zyrtare të shtatë festivaleve të ndryshme ndërkombehtar. Gjatë muajit maj, filmi "Përjetësisht Fëmijë" do të jetë pjesë e festivalit të njohur Pune Short International Film Festival, i cili do të mbahet në Pune të Indisë, pastaj në Los Angeles Cine Fest, i cili mbahet në Los Angeles, për të vazhdu-

ar në Texas Short Film Festival, që do të mbahet në San Diego, në Eendy's Short Film Festival dhe në Roma Short Film Festival që do të mbahet në Romë të Italisë. Gjatë muajit qershor dhe korrik, filmi "Përjetësisht Fëmijë" do të jetë pjesë e programit zyrtar të festivalit të njohur Sunlight International Film Festival, i cili do të mbahet në Teatrin Olimpik në Moskë të Rusisë, për të vazhduar në festivalin prestigjioz Regina International Film Festival, i cili do të mbahet në Kanada.

Udhëtim në histori, për gjurmë shqiptare në Venecia

Në datën 6 maj 2017 grupi i shqiptarëve të Kroacisë nën organizimin e Këshillit të pakicës kombëtare të qytetit të Zagrebit u nis për Venecia në udhëtimin studimor me temë "Gjurmë shqiptare në Venecia". Grupi përbehej nga deputetja shqiptare në Parlamentin Kroat, Ermina Lekaj Perlaskaj, përfaqësues të Këshillit shqiptar të Zagrebit, luftëtar shqiptar të luftës atdhetare të Kroacisë, përfaqësues të shoqatave shqiptare të Kroacisë "Drita", "Mbretëre-

sha Teuta", "Mërgimtari", "Hasi", Këshilli i Mësuesve Shqiptarë të Kroacisë, mësues, intelektualë, të rinj shqiptarë, përfaqësues të pakicave italiane, polake, boshnjake, bullgare të Zagrebit, të shoqëruar edhe nga ekipi i televizionit kroat HRT. Ky udhëtim në historinë e shqiptarëve që migruan mbas vdekjes së Skënderbeut në Venedik për t'iu mos nënshtruar pushtuesit Osman, përkoji më 6 majin ditëlindjen e heroit tonë Gjergj Kastriot Skënderbeu.

"Mediterranea 18", Kumbaro: Shqipëria skenë e madhe

Në ceremoninë mbyllëse të Bienales së Artistëve të Rinj të Mesdheut "Mediterranea 18", e cila për herë të parë u zhvillua në Shqipëri, ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro vlerësoi këtë aktivitet. "Ja dolëm mbanë ta kthejmë Shqipërinë në skenën më të madhe artistike të Mesdheut", tha Kumbaro në ceremoninë e mbajtur në mjediset e Muzeut Arkeologjik të Durrësit. Ajo u shpreh se kjo ngjarje e madhe artistike tregon potencialin e mëdha që ka Shqipëria për një lloj të veçantë turizmi, që është

të ai kulturor. "Mediterranea 18" Young Artists Biennale u zhvillua nga datat 4-9 maj mes Tiranës dhe Durrësit me pjesëmarrjen e 230 artistëve të rinj nga Mesdheu, të cilët prezantuan artin etyre në 32 hapësira performimi. Kjo ngjarje e rëndësishme kulturore u organizua nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me BJCEM, Bashkinë e Tiranës, Durrësit, Rajonin e Puglia-s dhe mbështetjen institucionale të Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe partnerëve të tjerë.

Më në fund fiton Tirana, ngjallen shpresat për mbijetesë në Superiore

Pesë muaj pritje për një fitore në kampionat. Tiranë më të lodhur nuk ishte parë asnjëherë më parë në rrugëtimin afro 100-vjeçar të bardhebluve. Skuadra rrezikon seriozisht rënien nga kategoria, por një fitore dje me Korabin dhe një trespikësh me vlerë e kanë larguar disi hijen e rënies, duke i dhënë frymëmarrje Tiranës për të shpresuar mbijetesën në Kategorinë Superiore. Golat e Edeh dhe Takut i dhanë 3 pikët bardhebluve në "Selman Stërmasi", që fituan 2-0 këtë herë duke mos gabuar përballë Korabit të rrezuar siç bënë në fazën e 3-të duke shfrytëzuar asistencën e kalendarit për qëndrimin

në Superiore. Në fakt, miqtë pothuajse nuk u shfaqën asnjëherë të rrezikshëm përpara portës së Likës, ndërsa Tirana ishte e vendosur për të marrë rezultatin maksimal dhe që në fillim u tregua e rrezikshme me Takun dhe Edeh, ndërsa në minutën e 25-të pa t'i anulohet me të drejtë për pozicion jashtë loje dhe një gol i Edeh. Vuajtjet e Tiranës megjithatë morën fund në fillimin e pjesës së dytë kur Edeh gjeti golin e epërsisë duke shtyrë topin për në rrjetë. Sigurinë e 3 pikëve bardhebluve ja dha Taku që shënoi me një goditje të bukur në të 57-tën. Korabi mbeti dhe me 9 vetë pas daljes me të kuq të Jubanit në

të 62-tën dhe Mziut në të 73-tën por pavarësisht rasteve të shumta Tirana nuk shënoi më dhe pse ndonjëherë porta ishte pothuajse e boshatisur. Gjithsesi në këtë pikë të sezonit e me renditjen aktuale ai që ka më shumë rëndësi është rezultati, i cili më në fund erdhi për skuadrën e trajnerit Mirel Josa. Ky i fundit theksoi pas ndeshjes se dëshira e tij nuk ishte të fitonte Kupën e Shqipërisë se sa të siguronte më parë mbijetesën në Superiore, duke thënë se në këtë moment ekipit i duhet të bëjë më shumë për të fituar dhe qëndruar në kategori. "Fituam lojën, por jo se jam i kënaqur me lojën e zhvillu-

ar. 3 pikët na duheshin me patjetër. Më vjen turp që Tirana është në këtë pozitë. Fitorja ndaj Korabit nuk do të thotë që problemet te Tirana janë sheshuar. Kupa e Shqipërisë? Mua si Mirel s'më intereson. Më intereson mbijetesë në kampionat. Dua ta shoh skuadrën sa më lart në klasifikim dhe të shpëtuar", u shpreh Josa. Duhet thënë se pavarësisht se fitoi një ndeshje me rivalin më të dobët, Korabin e vendit të fundit në klasifikim, për Tiranën ka domethënie të madhe fakti se mori tri pikët e para pas pesë muajsh dhe me këtë trespikësh hedh një hap të mirë drejt mbijetesës.



Verilindorët mundën 1-0 ekipin vlonjat, duke thelluar rekordin e pathyeshmërisë në Superiore

Kukësi mund Flamurtarin dhe mban kreun, trajneri Duro akuzon gjyqtarët

Adriatik BALLA

Java e 33-të e Kategorisë Superiore nuk dhuroi surpriza në aspektin e rezultateve, përveçse Kukësi u konfirmua në krye të renditjes, duke hedhur një hap më tej drejt titullit kampion, ndërkohë që surprizë e vetme mund të konsiderohet fitorja e Tiranës përballë Korabit, një fitore që vjen pas afro pesë muajsh dhe që ka vlerë për objektivin e mbijetesës që kanë bardheblutë. Kryendeshje e kësaj jave konsiderohej ajo midis Kukësit dhe Flamurtarit, që u luajt në "Zeqir Ymeri" dhe fituar nga verilindorët 1-0 me golin e Pero Pejiç. Kjo ishte një fitore e rëndësishme, sepse kalendarit e favorizon Kukësin në rrugëtimin drejt titullit dhe fitorja e djeshme, edhe pse e kontestuar nga trajneri i Flamurtarit Shpëtim Duro për shkak të sjelljes së arbitrave, vetëm sa e afron Kukësin me trofeun. Ishte një fitore e vështirë, por që trajneri Ernest Gjoka e cilësoi si shumë të rëndësishme në rrugëtimin drejt titullit kampion. Sulmuesi kroat Pero Pejiç ishte dhe një herë tjetër hero i Kukësit në këtë ndeshje dhe në fitoren e skuadrës verilindore. Ndeshja nuk pati shumë histori sepse kroati e gjeti shpejt golin e fitores. Ishte goli i 23-të për kroatin në kampionat dhe falë tij Kukësi ruan kreun, duke bërë detyrën në një ndeshje ku Gjokës i vlente vetëm fitorja. Ndryshimet e paralajmëruara te Kukësi me Pashajin në vend të Shametit në mbrojtje dhe Dvornekoviç në vend të Kale u konfirmuan ndërsa Flamurtari e nisi në sulm me dyshen Bushiç-Alvesh. Një ndeshje absolutisht për t'u fituar për Gjokën, me vendasit që e fillojnë në sulm. Në minutën e 10-të Izair Emiri vallëzoi mes Jakov-



leviç e Leal dhe godet portën, duke bërë që trajneri Duro të shqetësohet me të drejtë për mbrojtësit. 5 minuta më pas është Kale që godet pas një kombinimi me Lenën me shënjestrën që mbetet për t'u rregulluar. Braziliiani tenton sërish 3 minuta më vonë dhe këtë herë duhet prekje e Halilajit për të shpëtuar portën. Në minutën e 19-të ishit të Kukësit i duhet të gjendet sërish gati në goditjen nga distanca të Eni Imamit. Natyrisht nuk i mjafton vetëm loja Gjokës që kërkon avantazhin dhe ka të drejtë, pasi Flamurtari është aty me Bushiç që dhuron kërcënimin e parë në portën e Koliçit në të 24'. Dhe si gjithmonë duhet ai, njeriu që zgjidh gjërat te Kukësi, Pero Pejiç, që çan murin në një goditje standarde për të zhblokuar rezultatin. Kukësi

në festë i falet heroit të tij, 23 gola për Pero Pejiç në këtë kampionat, ku ka shënuar më shumë ai se gjithë pjesa tjetër e ekipit. Avantazhi e bën Kukësin më të kujdesshëm dhe Flamurtarin më kërkues, por vlonjatët nuk krijojnë kushedi çfarë dhe pjesa e parë mbyllet 1-0. Pejiç sërish protagonist në rikthimin nga dhomat e zhveshjes me një rrëzim në zonë në të 54' pas një dueli me Leal, gjyqtari Hamiti vazhdon lojën dhe aksioni mbyllet me një goditje të rrezikshme të Eminit, që Halilaj i përgjigjet mbi vijën fatale. Flamurtari fiton terren dhe në të 58' është Jakovleviç që provon në kokë, ndërsa menjëherë më pas është Telushi që tenton me falco por pa arritur të mashtrëjë Koliçin. Goditje dënimi në

Ndeshjet, java 27	
Dje	
Vllaznia-Luftëtari	2-2
Tirana-Korabi	2-0
Kukësi-Flamurtari	1-0
Teuta-Skënderbeu	0-1
Sot	
Partizani-Laçi	
RENDITJA	
Kukësi	69
Skënderbeu	68
Partizani	66
Luftëtari	40
Vllaznia	39
Teuta	36
Tirana	35
Flamurtari	35
Laçi	32
Korabi	13

hyrje të zonës në minutën e 76-të për Kukësin, por këtë herë Pejiç kalon murin por jo Halilajin, ndërsa në minutën e 81-të gabon gjithçka në goditjen e tij Fazliu. Pa problem për Koliçin edhe qendrorja e Danilo Alvesh 3 minuta më vonë dhe Kukësi edhe pse me vështirësi menaxhon për një fitore thelbësore në luftën për titullin, Korabi, Skënderbeu dhe Luftëtari, tani janë 270 minuta larg titullit. Sot është radha e Partizanit të tregojë vlerat e tij përballë Laçit, në një ndeshje të quajtur nga të kuqtë "delikate". Synohet medoemos fitorja, sepse Kukësi e bëri detyrën e tij si duhet dje përballë vlonjatëve, në të kundërt Partizani humb ritmin dhe kjo gjë favorizon kundërshtarët e tij në këtë rrugëtim plot rivalitet drejt titullit kampion.

DUELI

Xhejms nderon Skënderbeun ndaj Teutës, korçarët vijnë marshimin

Skënderbeu ka marrë një tjetër trespikësh me vlerë në kuadër të javës së 33-të të Kategorisë Superiore, duke marrë përkohësisht vendin e dytë në kampionat, pas Kukësit. Korçarët morën një trespikësh me mjaft peshë në konkurrencën për titull, pikërisht në stadiumin "Niko Dovana" të Durrësit, duke mposhtur Teutën me rezultatin 1-0. Fatet e ndeshjes u vendosën që në minutën e 10-të, kur Xhejms realizoi golin e avantazhit për Skënderbeun, një gol që i dha fitoren ekipit të trajnerit Ilir Daja. Me këtë fitore Skënderbeu shkoi në 68 pikë, një më pak se Kukësi kryesues dhe dy më shumë se Partizani, i cili ka një ndeshje më pak dhe që do ta luajë sot përballë Laçit.

NDESHJA

Vllaznia zhgënjën sërish, barazim me Luftëtarin

Vllaznia ka probleme dhe në dy ndeshje radhazi, edhe pse kishte mundësinë të fitonte e tani të ishte e konsoliduar në vendin e katërt, mori vetëm një pikë e mbeti pas Luftëtarit në renditje. Dje shkodranët u përballën në "Loro Boriçi" pikërisht me skuadrën gjirokastrite, duke barazuar me vështirësi 2-2. Ky rezultat u dha skuadrave rivale për vendin e katërt nga një pikë, por dukshëm favorizoi gjirokastritët që ruajtën pozitën e katërt, tashmë në kuotën e 40 pikëve, duke lënë pas Vllazninë me 39 pikë dhe në vend të pestë. Gjithsesi, gara për vendin e katërt vazhdon deri në javën e fundit, sepse në lojë janë dhe tre ndeshje të tjera.

MESFUSHORI

Trashi: Partizani pa aleanca, do t'ia dalim edhe ndaj Laçit

Partizani do ta luajë sot duelin e saj me Laçin, një ndeshje që do të thotë shumë për objektivat e të kuqve në kampionat. Në fakt, edhe Laçi ka synime për të marrë pikë, sepse ndodhet në vend të parafundit dhe kërkon mbijetesën. Gjithsesi, Lorenç Trashi beson se Partizani, përkundër aleancave që ka në garë, do t'ia dalë edhe në këtë ndeshje. "Laçi do jetë një përballje e vështirë duke parë që ka mjaft nevojë për pikë, mendoj që ne nuk na lejohet asnjë hap fals, duhet të sigurojmë vetëm 3 pikët", tha ai. Mesfushori foli dhe për të ardhmen e tij te Partizani. "Unë jam në kontratë me klubin dhe jam totalisht i fokusuar të jap më të mirën. Nëse ka ofertë konkrete është presidenti që vendos", shtoi Trashi.

DEKLARATA/ Moxhi bën "të fortin" te Partizani: Torasa jo i aftë, të largohet

Ardhja e Luçiano Moxhit si këshilltar i Gaz Demit në krye të Partizanit duket se po turbullon ujërat në kampin e kuq. Ende pa mbushur muajin si këshilltar i presidentit Demi, Luçiano Moxhi ka filluar menjëherë nga puna te Partizani, por në një formë që i shkon për shtat italianit. "Big Luçiano" siç e njohin të gjithë ka dhënë direktivat e para se çfarë i mungon të kuqve për të dalë kampion. Sipas "Sport Ekspres", Moxhi ka bërë një analizë të shkurtër gjatë një darke me stafin teknik ku ka shprehur habinë e tij se si

lojtari më i paguar i Partizanit është Agustín Torasa, lojtar që sipas tij nuk shënon, nuk asiston dhe madje nuk godet as portën. Moxhi është shprehur se si mund të dilet kampion në një situatë të tillë, ku argentinasi është lojtari më i paguar. Ish-drejtori sportiv i Juventusit ka dhënë këshillat e tij edhe për pjesën tjetër të lojtarëve dhe ka treguar se do të sjellë në ekip ata elementë që i mungojnë Partizanit për të dalë kampion. "Si mund të dalësh kampion kur lojtari më i paguar në ekip, argentinasi Torasa, nuk shënon dhe nuk e godet portën kurrë?". Në tav-

olinë ka heshtje, por Moxhi ka arsytet e tij teknike për ta thënë këtë, duke futur në dilemë edhe vetë stafin. "Ai nuk është lojtari që ju mendoni. As nuk jep asiste dhe as nuk shënon gol. Do ju sjell një sulmues krahu dhe një sulmues kryesor, në këtë mënyrë dhe Ekuban do lirohet nga gjithë ajo përgjegjësi. Me një sulmues tjetër krahu, me Ekuban në njërin krah dhe me njërin që e shtyn topin në rrjetë, tani do e kishit fituar kampionatin. Çetkoviç është "OK", më pëlqen. Edhe Atanda duhet të luajë më shpesh", shtoi Moxhi.



Etrit Berisha entuziast për të ardhmen: Synoj të luaj në Europë

Lojtarët e përfaqësueses tonë po mbyllin një sezon mjaft pozitiv me skuadrat e tyre në Europë, duke dëshmuar rritje profesionale dhe natyrisht duke rritur kreditet e tyre në merkato, tashmë me një vlerë kartoni akoma më të madhe. Kupthohet, lojtarët që luajnë në ligat e forta marrin më shumë vëmendje dhe sidomos ata në Serie A janë gjithnjë në majë, nisur jo vetëm nga cilësia e kampionatit italian, por edhe emri i skuadrave. Hysaj, Memushaj, Strakosha Berisha, Basha, Ajeti etj, të gjithë po bëjnë një edicion pozitiv. Por nga të gjithë lojtarët, Elseid Hysaj dhe Etrit Berisha janë ata që kanë korrur më

shumë sukses këtë edicion, sepse kanë qenë titullarë të padiskutuar me ekipet e tyre dhe kanë kontribut të çmuar në lojën dhe rezultatet e skuadrave respektive, si Hysaj te Napoli, ashtu dhe Berisha te Atalanta. Ky i fundit po mbyll një edicion fantastik, madje si një idhull i tifozerisë bergamaske, por e ardhmja e tij është në pikëpyetje, sepse Lacio që ka kartonin e tij dhe Atalanta ku është huazuar nuk po merren vesh midis tyre. Sipas mediave italiane, gardiani i portës së Kombëtares së Shqipërisë e kaloi ndoshta sezonin më të mirë në karrierë. Kosovari kuqezi e gjeti formën ideale tek Atalanta këtë edicion,

por siç thamë i huazuar nga Lacio. Ai e fitoi vazhdimësinë, e cila i mungonte në kryeqytetin italian dhe demonstroi se është një portier i niveleve të larta. Prandaj, portieri prishtinas shpreson të vazhdojë të qëndrojë në ekipin nga Bergamo, ku po ia kalon për mrekulli. "Unë e kam thënë gjithmonë dhe vazhdoj të përsëris se këtu po ia kaloj mirë, më pëlqen si qyteti ashtu edhe klubi, kryesia më bën të ndihem i qetë. Do më pëlqente të qëndroj këtu. Në fund të sezonit, menaxheri im dhe Lacio do ta marrin vendimin më të mirë", ka thënë përfaqësuesi shqiptar për mediat italiane. Gjithashtu, ai i ka treguar edhe ob-

jektivat e këtij sezoni me Atalantën, me të cilën synon të kualifikohet në garat evropiane, respektivisht në Europa League. "Ndashja me Milanin do të jetë më e rëndësishmja, por edhe më e vështira. Vendi i katërt thuajse na ka ikur, objektivi është i pesti. Duam dhe dëshirojmë ta arrijmë këtë pozitë, edhe pse të shtunën do të jetë vështirë", ka përfunduar Berisha. Në ditët në vijim pritet të sqarohen shumë pikëpyetje rreth gardianit kuqezi, por vetë Berisha duket pak i preokupuar, sepse me sezonin mjaft pozitiv që ka bërë mund të gjejë një skuadër tjetër për të luajtur si titullar dhe ofertat për të nuk dotë mungojnë.



■ Klubi verilindor doli dje me një deklaratë, ku mohon të ketë joshur "dema të kuq" për rezultatin

Kukësi mohon përfshirjen në skandalin e tentativës së blerjeve te Partizani

Adriatik BALLA

Një video që qarkullon së fundmi ka futur në një siklet të madh jo vetëm klubin e Kukësit, por të gjithë futbollin shqiptar, sepse pretendohet se kryesuesit e Kategorisë Superiore kanë tentuar të joshin lojtarë të Partizanit për të manipuluar rezultatin e takimit kryesor të kësaj faze, ai i luajtur në kryeqytet midis Partizanit e Kukësit, ndeshje që ka përfunduar në barazim 1-1. Nga kjo video mësohet se menaxheri Drini Çausi, që menaxhon lojtarë të Kukësit të tillë si Albi Alla, Simon Rrumbullaku dhe Elton Kale, i ka ofruar para Emiliano Vilës dhe një futbollisti tjetër të Partizanit për të toleruar në ndeshjen kundër verilindorëve me të cilin menaxheri Çausi është i lidhur. Ndërkohë, siç bëhet e ditur edhe klubi i Partizanit ka dijeni të plotë për këtë çështje dhe po përgatitet të ndërmarë rugë ligjore. Në fakt, asgjë nuk është e qartë dhe palët po përpiqen që të distancohen nga veprime të tilla, por fakti është i tillë që ka një video të pretenduar nga të kuqtë, ku dëgjohet qartë zëri i menaxherit dhe që besohet se ai është përpjekur të tundojë nëpërmjet ofrimit të parave që lojtarët të caktuar (fjala është kryesisht për mesfushorin e njohur të Partizanit, Emiliano Vila) të tolerojnë në ndeshjen kundër Kukësit. Ndashja është mbyllur në barazim 1-1, por kjo ngjarje mund të shërbejë për të njollësuar edhe më tej këtë sezon. Kampionati po dominohet nga aleanca.

Reagon zyrtarisht Kukësi: S'kemi lidhje me këtë punë

Klubi i Kukësit ka reaguar dje në lidhje me videaskandalin që po qarkullon prej dy ditësh, ku një menax-



her i skuadrës kuksiane josh lojtarë të Partizanit që të tolerojnë në duelin që dy skuadrat patën në kryeqytet në javën e 32-të. Reagimi i klubit për akuzat Partizani-Kukësi: Klubi i Kukësit është shumë ishjetësuar me shkrimet e publikuar nga media të ndryshme që e lidhin skuadrën verilindore me çështje që nuk bëjnë pjesë në mentalitetin tonë. Duke u nisur nga shkrimi duhet të theksojmë se menaxheri Drini Çausi nuk është pjesë e Kukësit dhe klubi distancohet nga këto shkrime. Bëjmë të ditur se klubi i Kukësit bashkëpunon me shumë menaxherë dhe pjesa më e madhe e lojtarëve të skuadrës tonë kanë të tillë, por kjo s'do të thotë që ata janë pjesë e jona, apo veprojnë nën stemën e skuadrës e aq më pak të kenë detyra të tjera nga drejtuesit. Kërkojmë

që emri i klubit të Kukësit të mos ndotet nga shpifje të tilla. Në të njëjtën kohë tërheqim vëmendjen e mediave që të jenë më të kujdesshme në publikimin e shkrimeve që trazojnë opinionin sportiv, pasi veprimet personale të një menaxheri apo një tjetri, nuk mund të "vishen" me ngjyrat e klubit tonë. Ndashjet për ne luhen në fushë dhe jo jashtë saj", thuhet në njoftimin zyrtar të klubit të Kukësit për këtë çështje.

Gjici distancohet nga Çausi, mohon përfshirjen në skandal

Safet Gjici, president i skuadrës kuksiane, është distancuar nga lidhja e tij me menaxherin Drini Çausi, i cili përfillet se u ka ofruar rryshfet futbollistëve të Partizanit para ndeshjes direkte të dy skuadrave që luftojnë për kreun. Ai ka

"Qëndrimi zyrtar i Kukësit që distancohet nga kjo çështje dhe mohon akuzat, mund të nxisë Partizanin të thellohet në këtë çështje, për të pasur të paktën një "justifikim moral" para tifozëve të tij nëse titulli nuk do të përfundojë në kryeqytet, por në Kukës..."

mohuar përfshirjen e tij në këtë çështje, ndërsa ka bërë të qartë se Çausi nuk është i punësuar nga klubi dhe nuk është zyrtar i tij. "S'kam fare lidhje me këto budallallëqe dhe ai Drini Çausi nuk është fare menaxher te Kukësi", është shprehur shkurt dhe prerë Gjici, duke tentuar t'i verë kapak kësaj historie, por ka shumë zëra që flasin për aleanca dhe tentativa të kësaj natyre jo vetëm nga Kukësi, por edhe klube të tjera. Kjo kërkon ndërhyrjen e menjëhershme të Prokurorisë, si dhe një hetim të shpejtë nga ana e FSHF-së, e cila ende nuk ka reaguar zyrtarisht për këtë skandal. Qëndrimi zyrtar i Kukësit që distancohet nga kjo çështje dhe mohon akuzat, mund të nxisë Partizanin të thellohet në këtë çështje, për të pasur të paktën një "justifikim moral" para tifozëve të tij nëse titulli nuk do të përfundojë në kryeqytet, por në Kukës.

NJOFTIMI

FSHF zbulon çmimin e biletave për duelin me Izraelin

Kushdo që dëshiron të shohë duelin e radhës së përfaqësueses duhet të ndjekë procedurat që sqarohen nga faqja e Federatës Shqiptare të Futbollit, e cila njofton të gjithë të interesuarit se kanë dalë në shitje biletat e ndeshjes Izrael-Shqipëri. Kjo ndeshje do të zhvillohet në datën 11.06.2017 ora 20:45 në stadiumin "Sammy Ofer" te qytetit Haifa, Izrael. Biletat për tifozët e kombëtares do të jenë të kategorisë së dytë, një biletë do të kushtojë 21 euro. Pasi të kenë bërë rezervimin në këtë adresë e-maili, janë të lutur që pas datës 25 Maj 2017 të paraqiten pranë Federatës Shqiptare të Futbollit për të kryer pagesën dhe tërhequr biletat.

LËVIZJA

Nuk fitoi titullin, Shkëndija largon trajnerin Brdiç

Kampionati maqedonas njohu Vardarin si ekip më të mirë, por nuk ishte larg trofeut edhe ekipi shqiptar i Shkëndijës, por objektivi nuk u arrit. Mungesa e trofeut solli edhe largimin e stafit. Kështu, klubi i Shkëndijës njoftoi se Tomas Brdariç nuk është më trajner i skuadrës. Gjermani në mungesë të rezultateve ka ofruar dorëheqjen e tij, e cila është pranuar nga ana e kryesisë. Brdariç kishte premtuar titullin kampion por mosarritja e ambicieve të vendosura para vetes, falënderoi klubin për besimin e dhënë dhe vendosi të largohet. Besimin për të drejtuar skuadrën deri në fund të sezonit si dhe në finalen e Kupës së Maqedonisë e mori zv/trajneri, Erhan Selimi.

SURPRIZA

Ajaksi futet në garë për Milot Rashicën

Talenti me origjinë shqiptare vijon të jetë ende pjesë e Viteshes në kampionatin holandez, por ai ka shanse të lëvizë në merkaton e verës drejt një klubi më të madh brenda Holandës, ose në Serie A italiane. Sipas mediave të huaja futbolliste i përfaqësueses së Kosovës është pranë transferimit te klubi i Ajaksit. Këtë e konfirmoi edhe menaxheri i tij Altin Lala para disa ditëve, duke thënë se ka ofertë të rëndësishme nga Ajaksi. Rashica që ka kaluar një sezon fantastik në Viteshe është duke u kërkuar me ngulmë edhe nga klubet e Premier Ligës dhe e Napolit. Mbetet të shihet në ditët e para të merkatos verore se cili klub do të ofrojë më shumë, në të kundërt lojtari do të mbetet pjesë e Viteshes deri në vitin 2018.

Gazetarët italianë propozojnë De Biazin për trajner të Interit

Trajneri i përfaqësueses së Shqipërisë përfillet vazhdimisht në mediat italiane si kandidat për të marrë në verë drejtimin e ndonjë skuadre të Serisë A, por deri më tani një lëvizje e tillë ka dështuar. Gjithsesi, largimi i Stefano Piolit nga Interi, ndonjëse erdhi gjatë darkës në mënyrë të papritur, parashikohet prej kohësh, aq sa në mediat italiane prej rreth një muaji ka filluar diskutimi se cili është personi që mund të kthejë përsëri zikaltrit në

rrugën e duhur. Pikërisht sot, në ditën që trajneri u shkarkua, ish-futbollisti i Juventusit në vitet 80-të, Massimo Mauro, aktualisht gazetar sportiv në rrjetin "Sky" në Itali, u ka propozuar zikaltrëve që t'i besojnë një trajneri ekspert italian, duke i sugjeruar Xhani De Biazin. Në editorialin e tij për gazetën "La Repubblica", Mauro thekson se Interi ka nevojë për një njeri që duhet të rikrijë skuadrën nga e para. "Pioli na dha iluzionin se kishte rregulluar

gjërat pas dështimit të De Byr, por puna që bëri rezultoi sipërfaqësore. Ka shumë probleme, skuadra duhet bërë nga e para. Ka nevojë për investime të mëdha por edhe për ndërgjegjësim nga lojtarët në nivel ndërkombëtar për të mos gabuar blerjet. Analiza nuk duhet bërë vetëm në aspektin teknik, por edhe në atë njerëzor. Për rindërtimin duhet absolutisht një trajner italian, De Biazin për mua do të ishte njeriu i duhur", shkruhet në editorialin e tij.



kulture

Justin Timberlake dhe Jessica Biel sherr në rrugë pas drekës

Këngëtari Justin Timberlake dhe Jessica Biel duket se kanë kaluar një moment të keq, ditën e martë. Bukuroshja është parë tekta ecën para bashkëshortit të saj, pasi kanë drekuar në qytetin e New York-ut. Ndërkohë që ecte përpara, këngëtari i famshëm është parë ta thërrasë atë po ajo nuk është kthyer për t'ju përgjigjur. Asnjëri prej tyre nuk dukej në një gjendje të mirë shpirtërore, ndërkohë që janë parë të shoqëruar edhe nga 3 djem të tjerë. Nga mimika e gojës, është vënë re që Justin ishte duke i thënë diçka bashkëshortes së tij, por kjo e fundit ka qenë e vendosur të mos e kthejë

kokën, por të vazhdonte rrugën me kokën ulur. Këngëtari Justin Timberlake dhe bashkëshortja e tij Jessica Biel kanë mirëpritur ardhjen në jetë të fëmijës së tyre të parë, djalit të quajtur Silas Randall Timberlake në prill të vitit 2015. Justin Timberlake në vitin që lamë pas publikoi këngë të re, e cila u cilësua si hiti më i madh verës. Tre vite pas albumeve të suksesshme të këngëtarit Justin Timberlake ai vendosi të kthehej me një këngë të re. Kënga është pjesë e filmit të animuar "Trolls". Kënga ka titullin "Can't stop the feeling", ndërsa kjo nuk është kënga e vetme që Timberlake ka bërë për këtë film.



FJALEKRYQI SOT

1	2	3		4	5	6		7	8	9	10		11
12			13				14						
15		16				17					18		
	19				20					21			
22				23					24				
25				26				27					
28			29				30					31	
32		33					34					35	
	36						37				38		
39					40					41			

Horizontal

1- Këngëtari lirik Luan... 2- Ende, akoma. 3- Masë e vjetër peshë e barabartë me 1.250 kg. 4- I porsa dalë nga fabrika. 5- Dramaturgu norvegjez Ibsen. 8- Pjesa e poshtme e dritares. 10- Është lëndë djegëse. 11- ...Soza, ish futbollist uruguian ka luajtur me Lacion dhe Interin. 12- I papërdorur, i ri. 13- Masë gjatësie e barabartë me 91.44 cm. 14- Përemër vector. 15- Makinat e Lezhës. 16- Mikrob. 18- Ish futbollisti gjerman Rudi... 20- Njësi ushtarake turke pre njëmijë vetash. 21- Veshje e priftit. 23- Kujdestari e tepruar që ndrydh mendimin. 24... Peci botoi gazetën e parë shqip në Ame 25- Vrasës, barbar, njeri i pamëshirshëm. 26- Njëlloj si paradhënie. 28- Lopatat e lundëtarit. 29- Masa e belit për rrobaqepësit. 31- Janë litarë çeliku. 32- Perëndesha e dashurisë. 33- Vegël pune i punëtorit të krahut. 34- Përcakton normat e sjelljes. 36- Marçelo...ish trajner italian. 38- Aktori amerikan...Gibson. 39- Cohe për rroba pune. 40- Hyrja në Somali. 41- I thonë çajit italianët.

Vertikal

1- Goditje e shpejtë dhe e menjëhershme. 2- Dete që lag brigjet tona. 3- Shi i fortë dhe i pandërprerë. 4- Këngëtarja popullore... Rasha. 5- Ngastër e mbjellë. 6- Alibali i këngës në inic. 7- Pyll në dushk dhe drurë jo fort të lartë. 8- ...Bator. 9- Bën pjesë në formacionin orkestral popullor. 10- Ish Presidenti amerikan Truman në inic. 11- Lojë me top vezak. 13- Pagesë e borxhit pjesë-pjesë. 14- Ikle e shpejtë në rrëmujë të frikësuar. 16- Aktori Edmond... 17- Dete që lag brigjet e Italisë dhe Francës. 18- Fuçi druri për bulmet. 20- Moluske që formojnë shkëmbenj, pa fund. 21- Ujëvarë, katarakt. 22- Romani...i Debervilleve nga Carl Dickens. 23- I thonë plëncit të pulës. 24- Ai jeton në Manastir. 25- Emri i mëparshëm i Egjyptit. 26- Është kufi toke. 27- Ish futbollisti Panajot... 29- Një lagje e vjetër në Shkodër afër kalasë. 30- Shkenctarja franceze ... Kyri. 31- Shkojmë, me dialekt. 33- Feudal polak i paraluftës. 34- Hotel primitiv. 35- Bakër ose... 36- Çelik Ganez. 37- Disponon.

SUDOKU

		7		2			8	6					
					5								7
	3	6		1									2
7	9		1		8								
			7		3			2		9			
4				7		8	5						
5			8										
9	2			4		6							

			6			8							
8		9				1	7						
			8	7	5							4	
5	1							7					
2			5		6							3	
	3							4	2				
9			4	2	8								
			9			6	8						
								7					

4		6	9										2
													1
				7	2	1							8
	4	2				3							
	3	9						1	4				
				4					2	9			
	7		1	5	6								
	6												
5						2	6						4



Zëvendësuesja

Mësuesja pyet secilin prej nxënësve për punën, që zhvillon mamaja e tyre
 -Pierino mamaja juaj çfarë është duke bërë tani?
 Pierino e sheh në heshtje të plotë e më pas i përgjigjet:
 -Mësuese mamaja ime bën zëvendësuesen
 Në këtë kohë mësuesja e paqartë i kërkon hollësi të mëtejshme:
 - Po, si zëvendësuese shpjegoje më mirë Pierino
 Pierino, mendohet pak minuta dhe më pas i përgjigjet:
 -Po, jua shpjegoj më qartë mësuese. Sapo vjen një makinë ajo hipën dhe më pas zbret, dhe më pas hipën në një tjetër makinë e sërish del që andej. Këtë veprim e bën disa herë në ditë.
 Mësuesja e kundërshton:
 -Dëgjo, Pierino ajo nuk është një zëvendësuese, por një prostitutë
 I gatshëm me përgjigjen e tij ai thekson:
 -Por, jo mësuese ajo është puna e motrës sime. Vetëm se ajo tani është e sëmurë dhe po e zëvendëson mamaja, kështu që mamaja ime është zëvendësuesja.

Në kopshtin zoologjik

Fëmija i kërkon nënës së tij për ta çuar në kopshtin zoologjik, sepse kishte kohë pa vajtur dhe e kishte marrë malli.
 -Mama, mama... përse nuk më ke çuar më tek kopshti zoologjik? Më ka marrë malli
 Dhe nëna që i përgjigjet
 -O, i dashuri im... nëse duan të të shohin vijnë ata këtu.

Darka

Marsela është e shqetësuar se i ati nuk ka ardhur ende për të ngrënë darkë në shtëpi. Ndërsa ajo me të ëmën janë ulur përpara tavolinës dhe po shijojnë gatimin e darkës. Në këtë kohë Marsela e pyet nënë e saj:
 -Mama, por nuk do të presim edhe babin që të hamë, të gjithë së bashku darkë?
 Dhe mamaja që i përgjigjet menjëherë, sikur ta ketë pasur përgjigjen gati:
 -Nëse do të prisja babain tënd, ti ende nuk do të kishe lindur.

kulture

www.sot.com.al

Zelandë e Re, lind foshnja që peshon mbi 7 kg

Në Zelandë e Re ka lindur një fëmijë që peshon 7 kilogramë e 400 gramë dhe besohet të jetë bebjë më e rëndë, që ndonjëherë ka lindur në këtë vend. Siç raporton "Radio New Zealand", nëna e foshnjës identiteti i të cilës nuk është zbuluar, kishte lindur beben në spitalin Wellington, që peshon 7 kilogramë dhe 400 gramë. Raportohet se asnjëherë më parë nuk kishte lindur një bebe me këtë peshë trupore në Zelandën e Re dhe lindja është kryer përmes prerjes cezariene dhe operacioni ka zgjatur tri orë, kurse foshnja është e gjatë 57 centimetra dhe është dy herë më i shëndoshë sesa një fëmijë normal.



Përgjigjet e fjalëkryqit

M	I	T	S	A	B	A	T	O	
L	A	B	O	R	A	T	O	R	P
A	R	M	A	L	O	R	P	O	
B	I	K	K	O	M	M	I	Z	
N	A	T	E	N	B	A	R	I	
B	A	R	O	T	M	E	K	A	T
A	R	E	N	S	E	L	I	M	
R	E	M	13/B	A	K	N	I	S	
I	T	S	1/A	T	A	N	D	I	
L	P	O	10/L	I	T	I	K	A	N
A	M	A	2/O	R	L	O	T		

Vlera e tregut të Apple mbi 800 miliardë dollarë

Vlera në treg e kompanisë Apple ka arritur në mbi 800 miliardë dollarë dhe tashmë iu nevojiten "vetëm" edhe 200 miliardë dollarë për të arritur vlerën e përgjithshme prej një bilion dollarë. Çmimet e aksioneve të Apple kanë kaluar mbi 150 dollarë. Analisti nga Wall Street Drexel Hamilton thotë se vlera e aksioneve të Apple edhe më tej është e nënçmuar, pasi më herët kishte thënë se aksionet e kompanisë mund të arrijnë 185 dollarë. Edhe analisti i teknologjisë Brian White konsideron se aksionet e Apple janë ndër më të nënçmuarat në botë dhe se investuesit e kishin tepruar me reagime negative ndaj rënies së shitjes të vitit të kaluar të iPhone.

Fjalëkryq i shifruar

	3	11	3		11	13	3	4	9	11
12	8	7	1	5	13	7	11	6		7
3	6		5	8	7	11	3		12	14
4	5	13		3	8	5		8	3	2
	4	16	3	11	5		11	9	6	5
13	7	8	8	5		10	16	15	5	10
3	8	5	7		12	16	11	9	11	
10	5	2		4/L	3	4		6	3	1
3	3		15	3/A	6	3	10		6	7
8		4	3	15/B	9	8	3	6	9	8
5	15	7	8	5/I	10		2	5	8	



	1	2	3	4		5	
6							
7					8		
9				10			
			11				
12	13	14	15				
17					18		
19						21	
22			23			24	
		25				26	
27	28				29		
	30				31		
32					33		34
35							
37			38				39
		40				41	
42						43	

Horizontal

1-...Bize kompozitori autor i operas "Karmen". 6- Shkrimtari... Stermilli. 7- Tasë e volejbollit. 8- Kompozitori italian Papanini në inic. 9- Gazermat Amerikane. 10- Stacioni ndërplanar rus në hapësirë. 11- Shkrimtari Brahimi. 12- Llafja. 16- Vegël muzikore karakteristike greke. 17- Pagesa e borxhit me kiste. 18- Tregim i shkurtër me vargje a prozë që ka si personazhe kafshë, bimë a sende. 19- Organizatë terroriste në Irlandë. 20- Ato prodhojnë energji elektrike me lëndë djegëse. 22- Stadiumi i Durrësit Dovano në inic. 23- Ka për kryeqytet Estonia. 24- Ndajfolje sasiye. 25- Lloj peshku i ujrave të ëmbla me kokë të madhe. 26- Eshtë nënprodukt i qumështit. 27- Ai që flet e ligjëron bukur, cicëron. 29- Boksieri durrsak Kreshnik... 30- Lëng që të bije në vehte me raste asfoksije. 31- Fadi... specialist tek sigurimet shoqërore. 32- Zola i letërsisë franceze. 33- Vend i hapur me mure anash oxhakut për të vënë sende të vogla si aletet e kafes e rakisë. 35- Heroi i heshtur Pal... 36- Mjeshtra e klarinetës ...Bariu. 37- Organizatë Terroriste. 38- Vrasës njeri i pamëshirshëm. 39- Gëlltit ose... 40- Arkë e madhe ku mbante pajën nusja. 41- Sëbashku. 42- Burgim. 43- Eshtë vend i shenjtë në Arabinë Saudite.

Vertikal

1- Eshtë jorgani i tokës. 4- Vajzë nga një krahinë në jug të vendit. 7- Pajisje çeliku ku farkëtari rreh hekurin e skuqur. 12- Figurë tek gurët e shahut, pa fund. 13- Ish shoqëri karburantesh në vendin tonë. 14- Janë dy ato të globit. 15- Pjestarë. 17- Grup njerëzish me mendime dhe interesa të përbashkëta. 18- Kompozitori Kongoli në inic. 19- Ish mjeku apasionant Arqile... 20- Eshtë figurë gjeometrike. 21- Eshtë figurë gjeometrike. 22- Një lagje e vjetër në Shkodër afër Kalasë. 23- Pyll i vogël në Dushk e drurë jo të lartë. 24- Lum në veri. 25- Qendra. 26- I thuhet çallmës së hoxhës. 27- Pritë, kurth. 28- Ka qënë. 29- Gjigand. 30- Shkrimtari ... Gura-kuqi. 32- Pohojnë italianët. 33- Arma e piktorit. 34- Eshtë depo drithi. 36- Kocka e kofshës së këmbës. 37- Figurë tek letrat e bixhozit. 38- Viç motak mashkull i pa tredhur. 39- Një hotel luksoz në qendër të Tiranës. 40- Dëshirë e shfrenuar për të arrirë diku. 41- Barazim në shah.

HOROSKOPI Dashi 21 mars - 20 prill Vetëm nëse do dini të hiqni dorë nga sjellja juaj në lidhje me partnerin, jeta juaj sentimentale mund të vazhdojë të jetë e lumtur.	HOROSKOPI Demi 21 prill - 21 maj Keni të gjitha mundësinë për t'iu dedikuar vetes suaj. Nëse keni abuzuar me ushqimin, alkoolin ose duhanin duhet t'i nënshtroheni një diete.	HOROSKOPI Binjakët 22 maj - 21 qershor Fati është pranë jush. Edhe nëse në plan të parë të parashikimeve qëndron dashuria, nuk duhet të lini mënjatë punën.	HOROSKOPI Gaforrja 22 qershor - 22 korrik Sot jeni energjik, përfiton për të bërë diçka të rëndësishme. Edhe nëse jeni të bindur se dini gjithçka, çdo gjë ka një të fshehtë.	HOROSKOPI Luani 23 korrik - 22 gusht Ditë e favorshme nën të gjitha këndvështrimet: yjet, miqtë, do t'ju dhurojnë dëshirë për të jetuar dhe shumë persona do kërkojnë shoqërinë tuaj.	HOROSKOPI Virgjëresha 22 gusht - 22 shtator Jeni shenja më e favorizuar e ditës. Ekuilibri i mrekullueshëm midis arsyes dhe ndjenjës, ndihmon edhe personin më të mërzitur të shenjës.
HOROSKOPI Peshorja 23 shtator - 22 tetor Jeni tepër komunikues. Të gjitha aftësitë tuaja do t'ju ndihmojnë në iniciativat e reja që do të ndërmerri, kryesisht tek ato humane dhe sociale.	HOROSKOPI Akrepi 23 tetor - 21 nëntor Në të njëjtën kohë jeni edhe i nevrkosur, por edhe i lumtur. Eshtë magjia e Hënës që formon lidhje harmonike me planetët e shenjës suaj.	HOROSKOPI Shigjetari 22 nëntor - 21 dhjetor Eshtë e vërtetë që sot çështjet që i përkasin karrierës dhe punës lihen mënjatë, por kur jeni ju përkrahin atëherë duhet të prisni paratë që do të mbërrijnë.	HOROSKOPI Bricjapi 22 dhjetor - 21 janar Nëse keni probleme, duhet që të realizoni disa ushtrime joge për të qetësuar trupin dhe mendjen. Duhet të kujdeseni më tepër për shëndetin.	HOROSKOPI Ujori 22 janar - 19 shkurt Do të gjeni qetësinë e munguar tek miqësia juaj e cila nuk ju kërkon asgjë si këmbim. Edhe ju jeni të gatshëm për të bërë të njëjtën gjë.	HOROSKOPI Peshqit 20 shkurt - 20 mars Për të shijuar këtë ditë në maksimum, yjet ju dhurojnë qetësi dhe hapësirë për ndjenjat. Jeni të besueshëm për të gjitha shenjat e tjera.

Reali kalon Atletikon, gjen Juventus në finalen e Champions League

"Los Blancos" humbën ndeshjen e kthimit ndaj Atletikos me rezultatin 2-1, por i nderoi fitorja e duelit të parë 3-0. Në finale gjejnë "Zonjën e Vjetër"

Adriatik BALLA

Një ndeshje spektakolare u zhvillua mbrëmë në "Vincente Calderon" të Madridit, midis Atletikos dhe Realit, në kuadër të sfidës së kthimit gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Atletiko fitoi me shifrat 2-1, por vendimtare për kualifikimin e Realit të Madridit në finalen e madhe të Kardifit ishte fitorja e gjysmëfinale të parë me shifrat 3-0. Atletiko humbi, por largohet krenare nga ky aktivitet, madje me një fitore të merituar kundër rivalit të një qyteti, një fitore natyrisht jo e mjaftueshme për më shumë. Ndeshja nisi mjaft mirë për Atletikon, e cila ushtroi presion të madh gjatë pjesës së parë dhe ia doli në fakt brenda 20 minutave të para të shënojë dy gola, duke vënë në rrezik objektivat e Realit. Presioni i madh në sulm bëri që Atletiko të shënojë shpejt, fillimisht me anë të Saul Niguez, i cili shënoi në minutën e 12-të. 4 minuta më pas Varane shkaktonte penallti në zonë,



duke detyruar gjyqtarin turk Çakir të bëjë me shenjë pikën e bardhë të penalltisë. Nga 11-metërshi nuk fal Antuan Griezman, i cili dyfishon shifrat. Kur kishin kaluar vetëm 20 minuta lojë, Atletiko ishte ende në sulm në kërkim të golit të tretë. Por një rënie fizike me kalimin e minutave dhe natyrisht një tërheqje prapa, bëri që Realit të fitojë terren dhe të mendojë për vepërime racionale në kundërsulm.

Megjithatë, Atletiko mbrohet mirë deri në minutën e 42-të. Në një aksion pa pretendime, pikërisht në këtë minutë, Benzema kalon tre mbrojtës në vijën fundore dhe jep asist në zonë, ku shmangies së parë që bëri portieri Oblak, iu përgjigj Isko i pambuluar që e dërgon topin në rrjetë. Ky gol i vrau shpresat e Atletikos për përmbysje, sepse goli në fushë kundërshtarë merr vlera dyfishe në duele të tilla. Nervoziteti është i madh dhe këtë e shpreh më mirë përplasja e sulmuesve Fernando Torres e Cristiano Ronaldo, ku u desh ndërhyrja e gjyqtarit për ta shuar. Në pjesën e dytë Atletiko nuk e pati freskinë dhe entuziazmin e pjesës së parë, duke mos dalë në lojën e saj dhe duke mos arritur të rrezikonte sa duhet për të thelluar avantazhin. Madje Realit mund ta kishte goditur në kundërsulm në më shumë se një rast, pasi Ronaldo, Benzema dhe në fund edhe Lukas Vaskez patën raste të mira shënimi, por Oblak nga njëra anë dhe fati nga ana tjetër ishin në pjesën e dytë me skuadrën e trajnerit Diego Simeone. Në fraksionin e dytë të lojës nuk pati ndryshim rezultati, kështu që ndeshja u fitua nga Realit i Madridit me rezultatin 2-1, në një ndeshje ku "Los Blancos" humbën, por arritën të kalonin në finalen e madhe të Kardifit. Në finalen e 3 qershorit do të gjejnë përballë "Zonjën e Vjetër" italiane, Juventusin në një duel që pritet të marrë vëmendjen e sportdashësve në mbarë botën.

PROPOZIMI/ Bajerni duhet të zgjedhë Sanchez në vend të Roben

Kur duhen pak ndeshje që të mbyllën sezonet futbollistike në Europë, klubet e mëdha kanë nisur të shpalosin objektivat e tyre për merkaton e verës. Disa propozime janë hedhur dhe për Bajernin e Mynihut, i cili ka në gjirin e vet lojtarë mjaft cilësorë si Arien Roben dhe Frenk Riberi, por që konsiderohen tashmë të plakur dhe duhen zëvendësuar. Dietmar Haman beson se koha e Frank Riberi dhe Arien Roben është në përfundim dhe ka këshilluar Bajernin që të mendojë për zëvendësimin e tyre, duke sugjeruar Aleksis Sanchez si zgjedhje të mirë. E ardhmja e Sanchezit tek Arsenalit nuk është e sigurt dhe kiliani mund të largohet në merkaton e verës. "Pozicionet e gjera janë ato ku Bajerni duhet të veprojë më së shumti. Robeni dhe Riberi janë ende të klasisit botëror, por performancat e tyre janë në rënie", deklaroi Haman për "AZ". "Ata thjeshtë po plakohen, dhe Bajernit i duhen alternativa, lojtarë që mund të shkojnë në aksion një kundër një, ky ishte edhe sukcesi te Bajerni, Roben dhe Riberi e kanë bërë diferencën. Nuk ka shumë lojtarë që mund ta bëjnë diferencën në këtë nivel, por Aleksis Sanchez mund të jetë një nga opsionet", është shprehur ai. Në fakt, ka dhe specialistë të tjerë që besojnë se Bajerni duhet të bëjë ndryshime për sezonin e ri.



BOTËTORI 2026

FIFA zbulon formatin e ri me 48 ekipe



Përfaqësueset e vendeve të vogla kanë një shans më shumë që të kualifikohen në finalen e Kupës së Botës pas vitit 2026. Kjo pasi FIFA jo vetëm ka zyrtarizuar një Botëtor me 48 ekipe, por ka përcaktuar edhe formatin se kush do të përfaqësohet më shumë në këtë aktivitet. Kështu, FIFA miratoi përfundimisht formatin e ri në Kongresin e mbajtur në Manama të Bahreinit, formulën e re më të zgjedhur të ekipeve pjesëmarrëse në Botëtor, duke ndarë edhe numrin e

skuadrave pjesëmarrëse të çdo kontinenti. Padyshim që në këtë pikë, "pjesën e luanit" e mban Europa, për të cilën janë rezervuar 16 vende, një rritje më dy vende krahasuar me skemën e mëparshme, por gjithsesi një rritje - edhe pse minimale, - e mundësive për vendet më të vogla, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Kontinenti afrikan është ai që ka përfituar më shumë, pasi kaloi nga 5 në 9 vende. Për "CONCACAF"-in, që përfshin Amerikën e Veriut dhe atë Qendrore,

janë rezervuar 6 vende, ashtu sikurse edhe për kontinentin e Amerikës së Jugut, ndërsa Azia ka të konfirmuara 8 vende. Përsa u përket dy vendeve të fundit, FIFA bëri të ditur se do të përcaktohen pas një minutuarie ndërkontinental, që do të zhvillohet në vitin 2025, në vendin që do të organizojë Botëtorin e 2026-s, që do të përcaktohet në Kongresin e ardhshëm të FIFA-s. Ky është një revolucion në aktivitetin futbollistik më të rëndësishëm ndërkombëtar.

MERKATO

Ozil: Vendos në verë, por Arsenali, zgjedhje e parë

Mesfushori Mesut Ozil është lidhur me një largim nga Londra në fund të këtij sezoni, pasi ende nuk ka nënshkruar kontratën e re me Arsenalin, ndërsa aktualja i skadon në fund të sezonit të ardhshëm. Fenerbahçe është në mesin e klubeve të interesuara, por Ozil thotë se i pëlqen të qëndrojë në "Emirates". "Arsenalit është njëri prej klubeve më të mira në botë dhe Londra është vend i mirë, një qytet i mirë për të jetuar. Siç kam thënë më parë, jam rehat këtu. Në verë do të flasim, por tani për tani Arsenalit ka përparësi. Pas këtij sezoni ne do të



flasim dhe do të marrim një vendim", u shpreh Ozil për "Sky Sports". Mediat angleze thonë se Ozil ka kërkuar rritje page, por klubi nuk po nxitohet.

TRAJNERI

Alegri: Po festojmë para kohe, rëndësi ka finalja

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, beson se ekipi i tij ka shanse shumë të mira që të fitojë trofeun e Ligës së Kampionëve. Juve eliminoi Monakon në gjysmëfinale duke e mposhtur me rezultat të përgjithshëm 4-1 për të siguruar finalen në Kardif. "Jam i lumtur për lojtarët, arritën finalen, por që nga nesër duhet të fokusohemi sepse s'kemi fituar akoma asgjë", u shpreh ai për "Mediaset Premium". Juventusit ka bërë një sezon fantastik në Champions, por do t'i duhet shumë punë në finale që të fitojë trofeun, prandaj dhe Ale-



gri kërkon që ekipi të ulet me këmbë në tokë dhe të punojë më fort për objektivin. Gjithsesi, "Zonja e Vjetër" ka mahnitur me performancën e saj.

LËVIZJA

Napoli nxiton t'i zgjasë kontratën Mertens

Në Serie A italiane, pas Juventusit Napoli është skuadra që ka bindur më shumë gjatë viteve të fundit. Në gjirin e vet Napoli ka shumë lojtarë të talentuar dhe shpreson të ketë më shumë sukses në sezonet e ardhshme. Ndërkohë, presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentis, pret që e ardhmja e Dries Mertens të mësohet brenda kësaj jave. Mertens është një nga lojtarët më në formë të Napolit gjatë këtij sezoni, duke realizuar 30 gola në 43 ndeshje. Belgu ka kontratë deri në vitin 2022, por klubi dëshiron të shmangë interesimin e Mançes-



ster Junajtidi për të. "Besoj se jemi afër dhe nënshkrimi do të arrihet, në fund kësaj jave do të konfirmojmë atë që po them tani", tha De Laurentis.

STAFI

DREJTOR/ Arjan PRODANI. KRYEREDAKTORE/ Anila DODAJ. Marketing: Cel 06 720 50 425 email: marketingsotnews@gmail.com

KULTURË/ Julia VRAPI SPORT/ Adriatik BALLA ZV/KRYEREDAKTOR Shëf politike Kliti TOPALLI Menaxher Shitje / Shpëtim CACO